



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/03-10049 dt. 18/03 2026

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit

th e r r e t

mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal, e cila do të mbahet më datë: 30.03.2026 dhe do të fillojë në orën 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës Drenasit.

Për mbledhje propozohet ky:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt.26.02.2026.
2. Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për pasqyrat financiare për vitin 2024.
3. Propozim Rregullore për menaxhimin e dokumenteve zyrtare dhe arkivore.
4. Propozim vendim për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPL "EKO-Drenasi" Sha.A Glllogoc.
5. Propozim vendim për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike.
6. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-70315035-00848-0, në Krajkovë, me sipërfaqe 130000 m², kapaciteti 9.99 MW, vlera investive 5.800.000,00 €;
7. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-70315035-00913-0, në Krajkovë me sipërfaqe 92000 m², kapaciteti 5.70 MW vlera investive 3.300.000,00 €.
8. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-703150053-00539-0, në Negroc, me sipërfaqe 109084 m², kapaciteti 5.90 MW vlera investive 5.800.000,00 €;
9. Propozim vendim për emërimin e përfaqësuesve të Kuvendit Komunal në Asociacionin e Komunave të Kosovës
10. Të ndryshme

Drenas, 18.03.2026



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Burim Bujupi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-10030 dt. 18/03/2026

PROCESVERBALI

I mbledhjes së rregullt të **Kuvendit Komunal të Drenasit**, mbajtur më **26.02.2026**, e cila filloi në orën **10:00**.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal, **Burim Bujupi**, i cili deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin **27 anëtarë**.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Burim Bujupi, Ekrem Elshani, Naim Gjeli, Anjeza Kurtaj, Selman Qallapeku, Valdet Curri, Qendresë Xhema, Gani Krasniqi, Edon Nishori, Erblinë Morina, Fitore Morina-Iloxha, Driton Ajazi, Arigon Sinani, Jahir Hajdari, Zeqir Hasi, Mërgim Pirraku, Muhamet Xhemajlaj, Artian Krasniqi, Tringa Bujupi, Pajtime Berisha, Luljeta Elshani, Egzona Tërdevci, Xhavit Drenori, Arbër Halilaj, Mehedin Salihu, Egzon Qorri dhe Liman Krasniqi.

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës së Drenasit, **Ramiz Lladrovci**, nënkryetari **Arben Shala**, përfaqësuesit e **OSBE-së** dhe **KFOR-it**, stafi i zyrës së kryetarit dhe mediat. Mbledhja do të ketë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal mbajtur me 30.01.2026;
2. Plani i punës së KKSB-së (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi) për vitin 2026;
3. Propozim-vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2025–2029.
4. Propozim-vendim për miratimin e Planit Lokal për Strategjinë e Cilësisë së Ajrit, Komuna e Drenasit 2025–2029;
5. Miratimi i raportit përfundimtar të komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;

6. Propozim-vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për omërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit;
7. Propozim-vendim për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Drenasit (Glogocit) në shfrytëzim afatgjatë personave fizik - juridik (deri në 99 vite);
8. Të ndryshme.

Mbledhjen e hapí dhe e kryesoi **Burim Bujupi**, kryesues i Kuvendit, i cili hapí diskutimin rreth pikave të rendit të ditës. Pas miratimit të procedurave fillestare, fjalën e merr **Egzona Tërdevci**.

Egzona Tërdevci, faleminderit shumë, kryesues. E kam përmendur edhe në komitetin çështjen e raportit për pikën e pestë. Miratimi i raportit përfundimtar të komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Nuk e kemi pasur këtë raport në komitet, e kemi marrë me vonesë para dy-tri ditësh, por prapë nuk është raporti i plotë. Si asambliste, meqë votojmë për një raport që ka shuma të mëdha financiare, do të duhej të ishim më transparentë dhe ta kishim raportin e plotë se kujt dhe si i janë vlerësuar dëmet. Unë nuk jam për ta penguar këtë proces, nuk jam për ta shtyrë, sepse ne vetë si asamble i kemi vizituar edhe ekonomitë familjare dhe bizneset, jemi të vetëdijshëm për dëmet që janë shkaktuar. Megjithatë, nuk mund të sillni vendime të tilla pa e sjellë raportin e plotë, sepse nuk ka transparencë këtu. Ne po votojmë mbi një milion euro dëme për biznese, pa e ditur se kush dhe për çfarë po kompensohet.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ju përsëhendes të gjithëve. I nderuar kryesues, nënkryetar, asamblistë. I nderuar komandant i stacionit policor në Drenas, përfaqësues të OSBE-së, të nderuar qytetarë të Komunës së Drenasit që po na ndiqni drejtpërdrejt në këtë mbledhje të rëndësishme. Znj. Egzona, besoj që e keni marrë përgjigjen prej komisionit përkatës. Lista është saktësisht me shumën të cilat i ka vlerësuar komisioni, as t'i, as unë nuk marrim përgjegjësi për shumën, sepse edhe një komision qeveritar e mbikëqyr. Nuk jua kanë sjellë, me sa kam unë informacione, ose nuk ua kanë dhënë nga rreziku se asamblistët mund ta publikojnë listën. Lista ka të dhëna personale dhe të dhëna të tjera, të cilat ne nuk kemi të drejtë t'i publikojmë. Nëse doni ta keni listën, besoj që komisioni edhe pse si listë është shumë e gjatë besoj që jua përgatit listën, por përgjegjësinë e mbani ju pastaj nëse publikohet lista me emra, me shifra, me numra, me të gjitha.

Egzona Tërdevci, faleminderit shumë për përgjigjen. Unë në fakt nuk kam marrë përgjigje prej komisionit, sepse kam kërkuar prej kryesuesit. Kryesuesi më ka thënë që do të flasë me ta dhe s'kam marrë përgjigje prej tij. Nuk kam asgjë kundër raportit, thjesht kërkoj transparencë. Ka forma që mund të na i përcillojë raportet, duke i fshihur të dhënat personale, vetëm se ju del pak më shumë punë administratës, por nuk është ndonjë telashe e madhe.

Xhavit Drenori, faleminderit, kryesues. Përsëhendet kryetar, nënkryetar, ekzekutiv, anëtarë të Kuvendit dhe mysafirë, posaçërisht komandantin e policisë. Nuk është argument, z. kryetar, kur thuhet se nuk mundeni me na dhënë materialin sepse mund ta keqpërdorim, ndërsa për të njëjtin material ne duhet të votojmë, këto të dyja nuk shkojnë bashkë. Nëse është informacion i fshehtë, le të mbetet i fshehtë, por atëherë ne nuk e japim votën. Të votosh për një informacion që nuk e

di se çfarë është, nuk qëndron. Ju keni mundur shumë mirë që, kur e keni dërguar materialin, të shkruani një pas-skriptum ku thuhet se secili anëtar i Kuvendit mban përgjegjësi nëse të dhënat personale dalin në publik. Përndryshe, siç tha edhe kolegja, unë nuk po guxoj të kërkoj shtyrje sepse njerëzit po presin dhe i kanë sytë nga kompensimi i dëmeve që janë bërë. Por, të votojmë ne për një raport të tillë milionësh pa e ditur saktë se si qëndron puna, besoj se është një përgjegjësi e madhe. Unë për vete e kam të vështirë të votoj 'për' dhe do të abstenoj. Shpresoj që vota ime të mos jetë vendimtare në këtë rast, sepse kjo është tërësisht e papranueshme. Thjesht, më duhet informacioni përpara se të marr vendim.

Urdhëroni, po, kryesues. Ju e udhëhoqni Kuvendin Komunal, e keni rregulloren dhe ju e keni të drejtën të ma jepni fjalën apo të ma ndërprisni atë, jo dikush tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, falënderit z. Drenori, e kemi parasysh.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovi, unë thashë, më fal Xhavit, por jemi në rend të ditës, nuk ka debat, ka propozime. Unë jam kryetar i të gjithë qytetarëve, por edhe i asamblistëve që janë këtu pa dallim, më pranuat apo nuk më pranuat, unë kryetar i juaj jam. Z. Drenori, e kemi pyetur Agjencinë për Informim dhe Privatësi. Në listë ka numra bankarë, ka të dhëna, ka shënime, ka shuma. Asnjëri nuk keni qenë në komision që të vlerësonit shumat, kujt i është dhënë dhe sa i është dhënë. Realisht, komisioni e ka përcaktuar atë. Kanë qenë tri komisione që kanë punuar dhe i përgëzoj shumë për punën që kanë bërë. Ne nuk marrim përgjegjësi për publikimin e të dhënave, sepse Agjencia na ka thënë që nuk keni të drejtë t'i jepni këto. Është krejt në vullnetin tuaj të votoni 'për' ose 'kundër'.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, tha se me diskutimet që ishin, hodhim në votim këto pika të rendit të ditës. Të pranishëm janë 27 anëtarë.

Për votuan 25, kundër 0, abstenim 2.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, tha të vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës: (1). Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal të dt.30.01.2026. E hap për diskutim. Pasi nuk ka diskutim, atëherë e hedhim në votim.

Për votuan 27, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapim për diskutim pikën e dytë të rendit të ditës: (2). Plani i punës së KKS-së për vitin 2026.

Xhavit Drenori, unë në fakt, nuk kam shumë për të thënë rreth përmbajtjes së tij, sepse fundja as nuk jam pjesë e tij. Mirëpo, meqë ka ardhur në Kuvend dhe na duhet ta aprovojmë ose të marrim një vendim që të kalojë, po i përmend disa çështje që besoj se na përjasin secilit prej nesh si anëtarë të Kuvendit. Në këtë format diskutohen tema të rëndësishme, të cilat po i citoj që t'i dimë si anëtarë të Kuvendit, mija e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal ku jetojmë. Çfarë ka të keqe këtu. Anëtarët e Kuvendit duhet të informohen për këto çështje dhe të hapet debat edhe me ne. Në të kaluarën, në këtë Kuvend ka pasur raporte periodike çdo vit nga komandanti i policisë. Pse nuk ndodh më kjo tani. Pse të mos i kemi ne informacionet si anëtarë të Kuvendit. A janë të vërteta ato që përfliten, se në shkollat tona të mesme është rritur numri i të rinjve që përdorin droga. Pse të mos e marrim këtë informatë nga dora e parë, por të presim e të dëgjojmë

informacione nëpër kafe.

Në njëfarë mënyre, ne nuk mund t'i shmangemi detyrës dhe përgjegjësisë tonë si anëtarë të Kuvendit për të qenë të paktën të informuar, dhe atë nga dora e parë. Po, mund të thoni se mbledhjet e KKS-së (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi) janë të hapura për publikun. Është e vërtetë, keni të drejtë, ne jemi 'përtacë', c di.

Mund të kërkojmë edhe qasje në dokumente publike edhe këtë mund ta bëjmë. Por nuk ka asgjë të keqe nëse zbatohet praktika e komunave të tjera, ku komandanti i policisë vjen dhe prezanton raportin vjetor para asamblistëve për të hapur debat e diskutim.

Shpesh pyesim, Pse në Gjermani ka pastërti e rregull. Atje edhe qytetarët janë si policë.

Ne këtu presim vetëm të parkojmë veturën pa na parë policia, ose të hedhim mbeturina pa na parë policia. Ne kemi frikë nga policia, por duhet të kuptojmë një gjë, policia nuk mund ta ruajë e vetme sigurinë dhe ta rrisë cilësinë e jetës, sidomos kur bëhet fjalë për të rinjtë tanë.

Prandaj, kërkoj nga ju, z. Kryesues, dhe nga Kryetari, apo kushdo që ka përgjegjësinë, që të bëhet praktikë që në këtë Kuvend Komunal të kemi raporte të rregullta nga secili institucion.

Edhe pse realisht nuk kanë obligim ligjor t'i raportojnë Kuvendit, do të ishte mirë ta bënin.

Në Prishtinë e pamë që ishte komandanti i policisë, madje edhe institucione të tjera, sepse unë i përcjell pak edhe komunat e tjera se çfarë po bëjnë.

Prandaj, do të ishte mirë të vijnë: komandanti i policisë, komandanti i zjarrfikësve dhe të gjitha institucionet e tjera që u shërbejnë qytetarëve tanë, në mënyrë që të na informojnë dhe ne t'i kemi informatat nga dora e parë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës Laureta Thaqi, tha se lidhur me temën që ngrihti z. Drenori, kjo pikë është e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ për Këshillat Komunale. Bëhet fjalë për Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 të MPB-së dhe Nr. 03/2012 të MAPL-së. Neni 9, pika 1.7, përcakton që plani vjetor duhet të prezantohet për miratim në Kuvendin Komunal. Pyetët se a kemi anëtarë nga Kuvendi Komunal. Po, kemi.

Rregullorja e përcakton se duhet të jetë një anëtar nga Komiteti për Komunitete. Unë nuk e kam caktuar se kush do të jetë, kur është mbajtur takimi, vetë Komiteti për Komunitete e ka përcaktuar përfaqësuesin e tyre. Ai është kolegu juaj dhe ju mund t'i merrni nga ai të gjitha informatat e mjaftueshme lidhur me mënyrën e funksionimit të këtij Këshilli. Sa i përket objektivit që përmendët, rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, ky është një objektiv që nuk e kemi shpikur ne, por është i përcaktuar qartë me udhëzim administrativ.

Ne funksionojmë vetëm si organ këshillues. KKS-ja (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi), ku unë jam koordinator, nuk është organ vendimmarrës dhe nuk ka buxhet. Si organ këshillues, çdo temë që ngrihet dhe që ka të bëjë me çështje që cenojnë sigurinë në komunitet, ne ia adresojmë mbledhjeve të ekzekutivit, ku pastaj merren masa siç është organizimi i fushatave vetëdijesuese e kështu me radhë.

Nëse nuk keni informacione, pjesë e këtij Këshilli janë: FSK-ja, KFOR-i, organizata të ndryshme, KVRL-ja (Këshilli i Veprimt Rinor Lokal), EVSB-ja (Ekipet e Veprimt për Siguri në Bashkësi), njësia e zjarrfikësve apo emergjencës, si dhe Këshilli i Prindërve. Të gjithë këta përfaqësues diskutojnë çështje të ndryshme. Po ashtu, edhe Komandanti i Policisë është çdo herë prezent ku i ngre këto tema dhe i diskutojmë bashkërisht, ashtu siç bëjmë edhe me Zyrtarin për Barazi Gjinore.

Pra, ka pjesëmarrje nga Kuvendi. Rregullorja e përcakton se kush duhet të jetë pjesëmarrës nga Kuvendi, dhe ai është anëtar i Komitetit për Komunitete.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, komandanti i stacionit të policisë ka raportuar në fund të vitit dhe raporton çdo vit. Sa i përket raportit në nivel rajonal që u mbajt në Prishtinë edhe aty kam qenë i ftuar (pasi janë komunat e rajonit të Prishtinës, 01-shi), por nuk kam marrë pjesë. Megjithatë, edhe aty raportohet e njëjta gjë sa u përket problemeve, drogave dhe çështjeve të tjera.

Policia e Kosovës, përkatësisht stacioni i Drenasit, përgatit raporte ditore të cilat publikohen dhe ku mund të hyjë kushdo që dëshiron për t'i parë. Unë personalisht marr raport javor, sepse më intereson të kemi qetësi, rregull dhe rend.

Në këtë rast, e falënderoj komandantin e stacionit të policisë për punën e madhe që po bën, në mënyrë që siguria në Komunën tonë të jetë në nivelin më të mirë.

Xhavit Drenori, drejtoreshë, faleminderit shumë. Asgjë nga ato që keni thënë nuk e kontestova, ju falënderoj që na i përkujtuat. Unë nuk e kontestova dokumentin, por vetëm theksova se temat që diskutohen këtu janë tejet të rëndësishme për ne si anëtarë të Kuvendit, pasi jemi zgjedhur me votën e qytetarëve për t'i përfaqësuar interesat e tyre.

Nuk duhet t'i pengojë askujt që asamblistët të jenë të informuar. Unë kërkoja informacion nga dora e parë, e jo të detyrohemi të kalojmë përmes procedurave për qasje në dokumente publike. Nëse për Kryetarin këto tema nuk janë të rëndësishme, për mua janë shumë, sepse njerëzit po ankohen që ka rritje të krimeve nga të rinjtë. Ne duhet të diskutojmë dhe duhet të flasim për këto çështje.

Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës Laureta Thaqi, tha se edhe në mandatin e kaluar unë kam qenë koordinatorë. Kolegët të cilët kanë qenë anëtarë më herët e dinë që kam raportuar dy herë në vit, sepse ashtu na përcakton udhëzimi i MPB-së dhe i MAPL-së.

Po ashtu, ju jap edhe një informatë: nëse pyetni në MPB, komuna e Drenasit është e vetmja që mban gjashtë mbledhje në vit, ashtu siç e përcakton rregullorja. Anëtarët nuk paguhën asnjë cent për punën që bëjnë, por vijnë këtu dhe ngrenë tema të rëndësishme. Njëkohësisht, kemi marrë lëvdata për mënyrën se si i organizojmë mbledhjet dhe si bëhen ftesat. Komunat e tjera na telefonojnë vazhdimisht për të marrë modelin tonë, sepse KKSBJ-ja në Drenas është e vetmja që është plotësisht funksionale.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, procesverbali i çdo mbledhjeje të KKSBJ-së publikohet në ueb-faqen e Komunës dhe aty mund të shihet se çfarë është diskutuar.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e dytë: (2) Plani i punës së KKSBJ-së për vitin 2026. **Për votuan 27, kundër 0, abstenim 0.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën: (3). Propozim - vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimtari në Mjedis 2025-2029.

Egzona Terdevci, tha se këtë pikë e kemi diskutuar edhe në Komitet. MAPL-ja, përkatësisht MMPHI-ja, e ka kthyer këtë dokument si të paligjshëm për shkak se nuk janë plotësuar disa elemente. Në Komitet mora konfirmimin që do të merren parasysh, por vendimi ka ardhur prapë i njëjtë. Në këtë dokument prapë mungon harta topografike. Të pjesa e financave, në faqen 66, nuk është bërë përshkrimi i duhur. Po ashtu, t plani i aktiviteteve dhe i veprimeve në faqen 60, nuk janë caktuar saktë afatet kohore.

Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Petrit Gashi, përshëndetje për të gjithë. Dokumenti nuk është kthyer si i paligjshëm, por si i papërfunduar. Kjo ka ndodhur sepse, siç është kërkuar edhe herëve të kaluara, ne i kemi dërguar këto dokumente vetëm si raporte domethënë, hartimin e Planit Lokal për Strategjinë e Cilësisë së Ajrit.

Gjithashtu, sa i përket Planit të Veprimit në Mjedis, ata kanë kërkuar një propozim-vendim dhe ndryshime të tjera në përshtatje me legjislacionin, qoftë atë vendor, qoftë me strategjitë e Bashkimit Evropian. Të gjitha këto tani janë të hartuara dhe të rregulluara.

Egzona Tërdevci, i nderuar drejtor, falënderit për përgjigjen. Megjithatë, ka mundësi që ne nuk e kemi të njëjtin material, sepse në raportin që kemi ne, këto ndryshime nuk figurojnë. A mundeni, ju lutem, të ma tregoni faqen për ta konfirmuar me raportin që kam. Në faqen 26 të raportit apo të materialit plotësues, pasi janë dy dokumente.

Xhavit Drenori, drejtor, po ta them paksa me shaka, si profesor universiteti, po të ma kishit sjellë këtë dokument, ndoshta do t'ju kisha vënë një gjashtë, sepse nuk ka qenë i formuluar mirë. Ju lutem, mos i bëni raportet që mbeten dokumente zyrtare vetëm sa për t'i bërë. Le t'i hartojë dikush që di t'i formulojë pak më mirë. Nuk duhet t'i përsërisni ato të dhëna në raport sikur me 'copy-paste'. Duhet të jeni pak më të kujdesshëm, sepse këto janë dokumente që mbeten.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e tretë të rendit të ditës. (3) Propozim-vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2025–2029.

Për votuan 25, kundër 0, abstenim 2.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e katërt (4).

Propozim-vendim për miratimin e Planit Lokal për Strategjinë e Cilësisë së Ajrit, Komuna e Drenasit 2025–2029. Pasi nuk pati diskutime për pikën e katërt, kryesuesi e hodhi në votim.

Për votuan 25, kundër 0, abstenim 2.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e pestë të rendit të ditës (5). Miratimi i raportit përfundimtar të Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, kisha kërkuar një sqarim nga zyrtari Bekim Dobra.

Bekim Dobra, i nderuar Kryetar, kryesues, të nderuar anëtarë të Kuvendit. Unë jam vetëm zyrtar për qasje në dokumente publike, por jam duke kryer një punë shtesë. Nuk jam hartues i raportit, por raportin e kam parë dhe kemi eliminuar në njëfarë forme një dënim që kemi mundur ta marrim si Komunë.

Nuk po i përmend dy komunitatet e tjera që janë dënuar, ato i kanë publikuar të njëjtat dokumente dhe kanë marrë dënim nga Agjencia. Kështu që, ne mund t'ju ofrojmë dokumentin juve, por përgjegjësinë e marrim ju.

Egzona Tërdevci, tha se unë përmenda edhe kur folë të pika e rendit të ditës, po e përmend prapë, ne nuk jemi duke e kontestuar raportin. Nuk kam problem me raportin dhe jam mirënjohëse për ata që kanë punuar natë e ditë për vlerësimin e këtyre dëmeve.

Mirëpo, ideja është kjo. Ne si Kuvend duhet të votojmë për një shumë mbi një milion e pesëqind mijë euro. Si mund të votoj unë pa e ditur se si është bërë ai vlerësim. Kujt dhe si i është vlerësuar dëmi. Pse të mos kemi transparencë ne si asamblistë dhe të mos e kemi raportin e plotë ku specifikohet se si janë llogaritur ato shuma.

Ka forma, e përmenda më herët dhe po e përsëris ka forma ku mund të hijezohen të dhënat personale siç janë, numri i llogaritur apo numri i llogaritë bankare. Ka mënyra, po të kishit dashur të ishit vërtet transparentë.

Ne mund të kërkojmë qasje në dokumente publike dhe e falënderoj Bekim Dobren, i cili si zyrtar është shumë i përgjegjshëm për secilën kërkesë që bëjmë. Mirëpo, ajo qasje sigurohet pasi ta

kemi votuar raportin. Pra, ne parimisht po votojmë për diçka që nuk e dimë saktë se si është bërë, e pastaj e marrim raportin. Për besë, kjo nuk ka logjikë.

Unë do të abstenoj, sepse nuk dua ta pengoj procesin, por nuk është korrekte nga ana juaj të na sillni raporte për t'i votuar 'blanko'. Nuk mund të shndërrohem në makineri votimi pa e ditur saktë se çfarë po votojmë.

Xhavit Drenori, tha që të mos përsëritëm, pasi i thashë edhe më herët, po bëj një propozim, ne nuk po e lëmë mbledhjen të papërfunduar sot, por po i kryejmë pikat e tjera të rendit të ditës. Ndërsa këtë pikë po e lëmë për nesër në orën dhjetë (10:00), e vazhdojmë mbledhjen vetëm për këtë çështje. Deri në atë kohë, secili prej nesh që dëshiron, sepse ndoshta ka dikush që nuk dëshiron t'i marrë ato materiale. I hijezuat apo jo, ju garantoj dhe nënshkruaj një dokument që nuk i publikoj, sepse unë nuk mund të votoj për një dokument pa e ditur se çfarë ka në brendësi të tij.

Më falni, por nuk mundem. Nuk mundem t'u dal më kundër qytetarëve që janë duke pritur dhe i kanë sytë nga Qeveria për t'ua kompensuar dëmin që u është shkaktuar. Ju na keni vendosur sot në një pozitë jashtëzakonisht të keqe. Z. Kryesues, merreni synimisht këtë shënim dhe është mirë ta hidhni në votim, le të shtyhet kjo pikë, nëse nuk ka pengesa me afatet kohore, të paktën për nesër. Nesër vijmë prapë, kjo nuk është çështje e parëndësishme, këtu bëhet fjalë për miliona euro.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, diçka që thotë Agjencia për Informim dhe Privatësi, nuk ke të drejtë me i dhënë, mos prit që do t'i jap. Nuk jam përgjegjës, as nuk marr pjesë në komisionin për vlerësimin e dëmeve. Ne kemi thënë edhe në komitet se si ta bëjmë sa më shpejt, që t'u dalim në ndihmë njerëzve. Ju asnjëri nuk keni qenë në komisione edhe pse ju kam thirrur të jeni pjesë e tyre. Edhe pse kam bërë thirrje publike që edhe zyrtarët e ministrive të na i sjellin në komisione, këtë e kam bërë me qëllimin më të mirë, që të mos vonohen përgjigjet dhe pagesat. Se a është shuma shumë e madhe apo shumë e vogël, unë mendoj që karshi dëmeve, ajo është shumë e vogël.

Xhavit Drenori, tha se unë nuk e paskam ditë që më paska ftuar dikush, as e-mail nuk më ka ardhë. Ndoshta e ke thënë publikisht, por nuk është diçka që bëhet ashtu, ajo punë bëhet nëse ftohen asamblistët.

A mendon që 27 vetë duhet të vijnë në komision, nuk vijnë. Edhe ai që s'ka ardhë në atë komision dhe s'e ka pa atë dokument, sot qysh mundet me votu. Në asnjë s'kemi qenë, s'dimë asgjë. O këtu është halli im, për krejt të tjerat pajtohem – ka emergjencë, ka shpejtësi, njerëzit kanë nevojë. E thashë: e falënderojmë punën e tre komisioneve, faleminderit që keni bërë punën tuaj, po s'po di për çka po votoj, e që kjo nuk është në natyrën time dhe as nuk jam që jam kundër, se si i pengoj njerëzit.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, e përgëzoi komisionin për punën që kanë bërë, ata mbajnë përgjegjësi për këtë raport. Ky raport ka për t'u shqyrtuar edhe një herë prej komisionit qeveritar, e pastaj do të vendoset, a të paguhet apo të mos paguhet. Nuk jeni duke e paguar ju, ju jeni duke e votuar një raport që e ka bërë komisioni. Kaq.

Driton Ajazi, përshëndetje për të gjithë. Shfrytëzoj rastin t'ua uroj detyrën drejtorëve të sapoemëruar. Para së të diskutojmë për pikën e rendit të ditës, Desha ta bëj një bashkëbisedim që kemi pasur me nënkryetarin Shala. Kryetar, keni qenë në Izrael muajin e kaluar dhe unë thashë.

Uroj që Kryetari të na ketë sjellë ndonjë praktikë të mirë prej Izraelit për t'i evituar vërshimet. Kam sjellë një dëshmi që desha t'ia jap nënkryetarit, për t'i vërtetuar njohuritë e mia gjeografike. **Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci**, Në pikën më të rëndësishme sot për sot për qytetarët e Drenasit, ai del dhe flet për diçka që kanë diskutuar e kanë debatuar në një mbledhje të kaluar të Asamblesë Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Burim Bujupi, ua tërhoqi vërejtjen. Ju lutem, koncentrohuni në pikat e rendit të ditës.

Driton Ajazi, unë kërkoja falje, por desha që para se të fillojmë me temën, t'i tregoja se mungesa e njohurive ka qenë të ai dhe të personi tjetër, por jo të unë.

Tani sa i përket pikës në fjalë, shikoni, pajtohem në parim me atë që thotë Egëzona. Kjo është një pikë shumë e ndjeshme që i ka prekur të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit. Me të vërtetë qytetarët janë dëmtuar shumë dhe ata presin ndihmë nga shteti sa më shpejt që është e mundur. Ne si asamble jemi këtu për ta kaluar këtë pikë, sepse ajo shkon direkt të qytetari. Në rast se ka diçka kontestuese sa i përket vlerësimit të dëmeve, atëherë përgjegjësia bie direkt mbi komisionin. Nëse ata kanë tentuar të fryjnë ndonjë vlerë, ose të fusin dikë në listë që nuk është vërshtuar, kjo është përgjegjësi e tyre.

Si parim, me vlerat dhe numrin e rasteve jemi në rregull, sepse i kemi parë me sytë tanë ato që kanë ndodhur. Unë personalisht jam që të kalojë kjo pikë, në mënyrë që të mos krijohen pengesa administrative. Shfrytëzoj rastin që Kryetari të bëjë presion të institucionet qendrore, të Qeveria e Republikës së Kosovës, që të bëhet kompensimi sa më parë i qytetarëve të komunës së Drenasit. Tani nuk ka më as pengesa buxhetore, pasi është aprovuar buxheti i Republikës së Kosovës, prandaj besoj që duhet ta shtyjmë përpara këtë pikë.

Egëzona Tërdevci, tha se nuk e di, ndoshta është mungesë e vëmendjes, por në asnjë moment nuk thashë që nuk duhet të kalojë ky propozim. Unë u qëndroja mbrapa fjalëve që kam thënë edhe më herët, ideja është votëm të transparenca. Përgjegjësinë e mban komisioni, por sa herë që një propozim vjen për t'u votuar të ne në Kuvendin Komunal edhe ne si asamblistë jemi bashkëpjesëmarrës qoftë për të mirë, qoftë për të keq, për secilin vendim që kalon këtu.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, z. Ajazi, ju e thatë që është përgjegjës komisioni. Askush nuk është përgjegjës për rritjen apo zvogëlimin e vlerave, sepse në qoftë se janë dy shtëpi ngjitë që kanë pasur të dyja dëme, njëra ka mundur t'i ketë pasur pajisjet më të mira e tjetra më të dobëta, sigurisht që komisioni nuk ua ka dhënë vlerën e njëjtë.

Pra, publikimi i listës hap debat dhe konflikte mes qytetarëve. Kjo është një procedurë se si do të votojmë, të cilën e ka kërkuar Qeveria. E kam thënë edhe më parë, nuk ka kuptim që kuvendet e komunave të votojnë raportet e komisioneve për dëmet apo për diçka tjetër.

Egëzona Tërdevci, nuk po më kujtohet ndonjë moment kur kam thënë që ideja ime është fikse më e mira dhe që duhet të pajtohen të gjithë. Unë e dhashë mendimin tim si asamblistë. Nuk kam për ta bllokuar këtë proces, por abstenoj, sepse besoj që nuk ka transparencë të mjaftueshme. Gjithashtu, do të kërkoj qasje në dokumente publike. Kaq Nuk e di pse po bëhet kaq shumë dramë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, jepjani raportin zonjës në fjalë. Publikisht po them, jepjani për transparencë. Unë as që i kam parë shumat, as nuk i verifikoj, as nuk i nënshkruaj, sepse nuk është çështje e imja. Ne i kemi formuar tri komisione që t'i kryejnë punët

sa më shpejt për t'u dalë në ndihmë qytetarëve, ta bëjnë raportin dhe këtë raport ta sjellin në mbledhje, e pastaj ta dërgojmë në Qeveri.

Mehedin Salihu, kërkoj nga kryesuesi ta shpërndajë debatin edhe të asamblistët e tjerë, sepse po dominojnë vetëm dy-tre veta. Ju lus që bisedat tona të regjistrohen mirë, sepse kemi shumë vështirësi me zërin që dëgjojmë. Domethënë, transmetimi nuk është origjinal dhe ndërprerjet po ia humbin kuptimin asaj që po themi ose asaj që duam të themi. Sa i përket pikës, nuk kemi pasur nevojë fare të debatujmë, fatmirësisht na ka ardhur mundësia t'u dalim njerëzve në ndihmë. Unë lutem që kjo të bëhet sa më shpejt dhe asnjë njeri të mos mbetet jashtë listës. Por, kam një pyetje në emrin tim personal, njerëzit që do të jenë të pakënaqur, ku duhet të drejtohen rreth vlerësimit të dëmeve.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, tha se fillimisht po të replikoj, që kur jam kryesues, kushdo që e ka kërkuar fjalën, ia kam dhënë. Sa i përket mikrofonave, madje gjatë seancës më erdhi e-maili dhe po ta lexoj për korrektësi. Po të informoj që ende jemi në pritje të përgjigjes nga prodhuesi, pasi mikrofonat janë prodhim i vjetër dhe i kanë mbajtur dhjetë vjet. Kështu që jemi interesuar edhe për këtë proces.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, sa u përket ankesave, ato nuk bëhen të ne. Ankesat bëhen në komisionin në Ministrinë përkatëse, në Qeverinë e Kosovës.

Bislime Dvorani, Kryesues e Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve, përshëndetje i nderuar Kryetar, Kryesues i Kuvendit dhe ju drejtorë të drejtorive, si dhe ju asamblistë. Pashë që u përmend disa herë transparenca në komisione. Egzon, desha të bëj me dije se komisioni ka punuar në mënyrë shumë transparente. Gjatë daljes në terren, kemi shkuar me një procesverbal dhe me një deklaratë nën botim, ku secili person i prekur e ka parë vlerësimin real që kemi bërë 'aty për aty', në bazë të gjendjes që kemi parë në terren. Kështu që, për këtë pjesë jemi shumë në rregull. Sa i përket asaj se pse nuk e kemi dërguar raportin në mënyrë më të detajuar, është për shkak se kemi dashur t'i largohemi asaj që të krijojmë pakënaqësi për shkak të dhënave personale. I kemi vlerësuar në mënyrë të paanshme për secilin qytetar, ku i kemi përpiluar edhe raportet individuale për secilin individ. Kështu që, lirisht e ke të drejtën e botës të shohësh secilin dosje të individit që ty të intereson.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e pestë të rendit të ditës: (5). Miratimi i raportit përfundimtar të komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. **Për votuan 25, kundër 0, abstenim 2.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e gjashtë: (6). Propozim-vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit. Siç jeni të njoftuar, ky komision përbëhet prej pesë anëtarëve dhe ka mandat katërvjeçar, d.m.th. me mbarimin e mandatit të këshilltarit komunal, mbaron edhe mandati i këtyre anëtarëve. Normalisht, unë besoj që dy anëtarë të komisionit t'i takojnë PDKRLL-së, dy anëtarë i takojnë PDK-së dhe një anëtar nga grupet e tjera. Shumica jeni nëpër komisione, kishte qenë mirë që ky komision të zgjidhet me asamblistë që me të vërtetë janë të përgjegjshëm dhe punojnë maksimalisht. Kemi pasur probleme prej vitit 2017, nuk e kemi bërë asnjë emërtim, kështu që, zotëri Krasniqi, keni ndonjë emër.

Gani Krasniqi, përshëndetje për të gjithë. Nga grupi PDKRLL, kemi dy propozime, kemi Ekrem Elshanin dhe Qëndresa Xhemën.

Zeqir Hasi, përshëndetje për të gjithë. Po, nga PDK-ja janë Artian Krasniqi dhe Luljeta Elshani. **Egzona Tërdevci**, tha se me mirëkuptim nga përfaqësuesit e tjerë, pasi jemi grupe më të vogla, unë do ta kisha propozuar kolegun Xhavit Drenori që të jetë pjesë e këtij komisioni. Natyrisht, nëse pajtohen edhe këta që janë nga një përfaqësues prej subjekteve, gjithashtu. Miqësisht ju kisha lutur që këtë punë ta merrni me përkushtim, sepse komisioni që ka qenë në mandatin e kaluar nuk e ka trajtuar asnjë kërkesë. Kam bërë vetë kërkesë personalisht për emërtimin e një rruge dhe e di që kurrë nuk është trajtuar. Kështu që, kushdo që zgjidheni, nëse votohet kjo përbërje, ju lutem merrni me përgjegjësi që të kryhen ato mbi dyqind kërkesa, sepse jam në dijeni për këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, tha se shefi i grupit të PDKRLL-së më herët më tha se, në qoftë se dëshiron edhe dikush të jetë pjesë shtesë e këtij komisioni, janë të gatshëm që dikush të tërhiqet. Këta e kanë shprehur dëshirën, në qoftë se doni, në rregull është.

Xhavit Drenori, po, ne e kemi marrë mbështetjen e qytetarëve për t'u shërbyer dhe s'ka asnjë temë prej së cilës ne duhet të ikim. As unë nuk iki, e di që është shumë punë e zorshme dhe punë e mundimshme, sepse kam përvojë, kam qenë në një komision të tillë kur kam qenë asamblist më herët. Po i përmend vetëm disa prej telefonatave që i kam marrë edhe pse s'ka qenë faji im, sepse në fund ju keni për të vendosur, pasi edhe unë jam pjesë e juaja. E mora Rakovicën, ta bjerë atë shenjë të shtëpia jote, atë shenjë dërgoja këtij, dërgoja atij, lloj-lloj kërcënimesh. Pavarësisht kush vendoset, nëse dikush prej kolegëve ka dëshirë, me shumë dëshirë ia delegoj, sepse e di që ai raport vjen prapë në Kuvend dhe ne e marrim vendimin final. Pra, unë mendoj që ky komision brenda një muaji duhet ta kryejë këtë punë. Katër vjet e ka mandatin, por për një muaj duhet të kryejë, në mbledhjen e radhës duhet të na vijë neve raporti. Sepse ky komision tashmë nuk di se sa janë kërkesat dhe ankesat e parashtruara, por do t'i marrë t'i shqyrtojë. Ne atë kohë e kemi kryer punën e madhe, sepse tashmë ka emërtim të rrugëve, por ka ndonjë pakënaqësi që do të zgjidhet. Unë e kam pyetur me qasje në dokumente publike Bekimin, të cilin e falënderoj sepse është korrekt në komunikim. A kemi ndonjë rregullore e cila na ndihmon pak se si t'i qasemi. Ka thënë. Jo, nuk ka, është vetëm ligji edhe udhëzimi. Atëherë neve si komision na mbetet në dorë shumë një barrë e rëndë. Prandaj unë ju lus që në këtë fazë të aktivizohet secili anëtar i Kuvendit dhe të na ndihmojë si komision, sepse për lokacionin e tyre secili e di. Sepse, në qoftë se ne atë punë e bëjmë për një muaj ditë dhe e sjellim në Kuvend, e ju na e hidhni krejt poshtë, atëherë sharja ka për të rënë mbi ne, nuk është në rregull. Këtë e them prej përvojës, sepse është punë e vështirë kjo. Prej fillimit, secili le të angazhohet, le të na ndihmojë, është punë e zorshme.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, theksoj që nuk mund të kryhen këto për një muaj, sepse kjo është legjislaturë tjetër. Nuk ka dokumente të gatshme, ato që janë dorëzuar duhet të rishikohen edhe një herë, duhet të dilet në terren, të shikohet çdo kërkesë a është në rregull, e pastaj të merren vendime e të sillen në Kuvend. Xhavit, po u kryen për gjashtë muaj ose për një vit, do të isha shumë i lumtur. Ti the ta bëjmë punën një muaj ditë dhe prapë të na shajnë, por qe nëntë vjet qytetarët më shajnë mua për emërtimin e rrugëve, që nuk është përgjegjësi e imja. Përgjegjësi e imja është t'i arkivoj ankesat ose kërkesat e tyre dhe t'ia dorëzoj komisionit përgjegjës. Njëjtë kërkojnë përgjegjësi, na sulmojnë e na shajnë edhe për kompaninë e mbeturinave kur nuk shkon t'u marrë bërllokun, edhe për ujësjellësin kur nuk kanë ujë.

Dua t'u them qytetarëve, përmes jush dhe mediave, se kryetari nuk është përgjegjës për këto çështje, për asnjërin prej tyre. Është përgjegjës të krijojë mundësi për t'i kryer detyrat në mënyrën më të mirë të mundshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, deri më tani, emrat e propozuar për lundimtarë janë: Ekrem Elshani dhe Qëndresa Xhema nga PDKRIJ-ja, Artian Krasniqi dhe Luljeta Elshani nga PDK-ja, si dhe Xhavit Drenori.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovi, nëse më lejohet, nëse nuk ka anëtarë prej ekzekutivit, kush ka për t'i përgatitur, kush ka për t'i hapur hartat, kush ka për t'i parë raportet, s'mundet komisioni i vetëm, përveç nëse unë jam gabim.

Xhavit Drenori, në komisionin ku kam qenë pjesë, kemi qenë vetëm tre anëtarë të Kuvendit; ka qenë dikush nga shoqatat e dala nga lufta kështu është paraparë atë kohë edhe nga ekzekutivi. Sepse, ne nuk mundemi pa qenë edhe dikush nga ekzekutivi, pasi na duhen hartat, na duhet emërtimi dhe të dimë deri ku është segmenti. Ne nuk e dimë prej ku e deri ku është ai segmenti që po kërkojnë banorët, pa Besartin ne nuk mundemi ta bëjmë atë punë, po ju flas prej përvojës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, z. Drenori, në vitet 2017-2021, pjesë e Kuvendit keni qenë edhe ju, kanë qenë pesë anëtarë prej Kuvendit.

Xhavit Drenori, tha se si e përcaktoni ju, unë nuk e di, por pa ekzekutiv nuk bën.

Mërgim Piraku, Me sa di unë, nuk bën të jetë numër çifil, domethënë duhet të jetë numër tek. Gjithashtu, numri mund të rritet, për shembull, prej pesë mund të bëhet shtatë ose nëntë. Nëse është kështu, atëherë kishte me qenë mirë të bëjmë një komision gjithëpërfshirës për të gjitha partitë që janë këtu në Kuvend. Tjetra, unë nuk kam marrë pjesë në këtë komision më herët, mirëpo unë konsideroj që nuk është punë shumë e vështirë, veçse duhet të krijohen kritere të qarta. Mos t'u jepet hapësirë njerëzve, për shembull.

Unë dua të bëj rrugën me emrin e gjyshit tim ose katragjyshit tim. Sigurisht që ai është i shenjtë për mua, mirëpo nuk ka nevojë komisioni të japë hapësirë ashtu siç u është dhënë në të kaluarën. Në e dimë që në shumë fshatra ka emra njerëzish që ndoshta janë njerëz që unë i respektoj jashtëzakonisht shumë, mirëpo duhet të bëhen kritere shumë të qarta.

Sepse që këtu nisin ato problemet, domethënë, ka qenë një rrugë mes dy familjeve dhe të dyja, për shembull, kanë pasur qejf t'ia ngjisin emrin e gjyshit ose katragjyshit të vet, dhe kjo ka sjellë probleme. Prandaj, komisioni le ta marrë për detyrë të bëjë kritere të qarta që në fillim dhe s'po besoj që duhet të jetë ai farë problemi.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovi, tha se ligji e përcakton për emërimet kujt i jep përparësi, nëse s'po gaboje, dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, martirëve kështu me radhë, edhe atyre kontributdhënësve.

Xhavit Drenori, për kolegun Piraku dhe për gjithë të tjerët, jo pa qëllim dola para foltores për t'ju drejtuar përballë. Ne mundohemi të bëjmë punë profesionale, vjen në Kuvend dhe dikush prej anëtarëve të Kuvendit e bënë një grup këtu po e them për ta shtyrë një çështje të caktuar dhe na ndryshon. Ky është ai halli im. Thashë, kyçuni prej fillimit që të mos vijë në Kuvend e të prishet puna. Asnjë emër të babagjyshërve në komision ne nuk kemi ngjitur, por në fund kemi përfunduar me shumë emra të babagjyshërve, sepse Kuvendi e ka prishur punën e komisionit, pasi s'ka rregullore. Parimi ka qenë, dëshmorë. Po e them, pa kritere normal që s'punojmë ne aty, veçse edhe pa i thirrur banorët, respektivisht pa i thirrur kryetarët e bashkësisve lokale ose

administratorët, unë këtë punë nuk e bëj, unë tërhiqem prej komisionit. Jo, jo, unë nuk marrë (përgjegjësi) të vendos për një fshat të thellë, për shembull për Likoshan, pse ma ka sjellë një banor një ankesë për t'ia ndërruar emrin, duke thënë se ky banor e paska arsyetuar.

Pak ndoshta e ka arsyetuar, ose edhe hiç, s'mundem unë ta bëj atë punë pa thirrur kryetarin e fshatit dhe përfaqësuesit e lagjeve, që të mund të hyjmë sa më thellë me transparencë. Sepse, përndryshe, kush jam unë që mund ta marr atë vendim. Askush.

Liman Krasniqi, përshëndetje për të gjithë. Unë, duke e pasur parasysh peshën edhe rëndësinë që ka ky komision edhe bashkëpunimin që duhet ta ketë patjetër me Drejtorinë e Urbanizmit, kisha propozuar që të jetë edhe një anëtar prej kësaj drejtorie. Ne kemi parë edhe në të kaluarën që shumë emra që kanë pasur peshë dhe kanë kontribuar, nuk janë caktuar në ato rrugë që kanë pasur një prioritet, por kanë shkuar në rrugë sekondare. Është mirë që edhe një anëtar të jetë prej Drejtorisë së Urbanizmit, që t'i ketë parasysh të gjitha ato elemente të infrastrukturës rrugore që janë nëpër harta dhe në plane rregulluese.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovi, tha se po më këshillojnë se ka mundësi që MAPJ-ja të na e kthejë, sepse ishte përcaktuar që anëtarë të jenë anëtarët e Kuvendit.

Kështu që ndihmën keni për ta pasur, Besartin, jo veç Besartin, por të gjithë zyrtarët e drejtorisë përkatëse i keni në dispozicion. Për aq sa ata dinë e për aq sa ata mund t'ju ndihmojnë, i keni në dispozicion.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e gjashtë (6): Propozim-vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit.

Për votuan 27, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e shtatë (7):

Propozim-vendim për miratimin paraprak të vendimit për dhënie e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizikë-juridikë (deri në 99 vite).

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovi, sikur çdo pronar toke që livadhin, arën apo malin përpiqet ta bëjë sa më të dobishëm për veten e familjen, sa më shumë investime në pronë, ta bëjë sa më atraktiv dhe sa më joshës për të interesuarit, ashtu edhe Komuna përpiqet që pronën publike ta bëjë sa më të vlefshme, sa më tërheqëse dhe sa më profitabile për qytetarët. Askush nuk mund ta ndalë zhvillimin e komunës, e as ata që pronën e konsiderojnë të vlefshme vetëm nëse ata vetë e qeverisin.

Qytetari ia dha besimin vizionit tonë për zhvillim, angazhim, për mirëqenie ekonomike dhe zbatim të ligjit, jo bllokuesve të iniciativave. Po e marr një shembull, çka ka ngjarë me ish-objektin e Komunës së vjetër. Kujt i bëri ai nder. Komuna e vjetër, po të ishte votuar para tri vitesh, sot do të ishin krijuar plus 300 vende të reja të punës, Komuna do të përfitonte 26% të ndërtimit me salla të kulturës, galeri arti, salla konferencash, zyra për partitë politike, shoqatat e komunës tonë dhe hapësira të tjera moderne, siç mund t'i shihni edhe në ekran. Komuna do të përfitonte tatim në pronë nga këto objekte me mijëra metra katrorë, dhe përfitime të tjera nga bizneset dhe krijimi. Kush përfitoi nga bllokada.

Askush nuk përfitoi nga bllokada. Ne nuk e morëm besimin të ndalemi, të stagnojmë, por të ecim bashkë përpara për të mirën e qytetarëve, komunës dhe shtetit tonë. Lista paraprake e pronave do të miratohet nëse duam zhvillim, sepse duam që të mos ikë rinia, sepse duam perspektivë në komunën tonë. Uroj të gjithë të pajtoheni, bashkë ta duam Drenasin më mirë. Pra, edhe një herë po jua shpjegoj se, për t'i kontribuar transparencës, unë do të kërkoj nga të gjitha grupet

pjesëmarrëse në kuvend të kenë nga një anëtar, dy grupet e mëdha nga dy anëtarë, që t'i shohin të gjitha pronat e listës paraprake të cilat mendojmë t'i zhvillojmë.

Pra, nuk marr asnjë vendim nëse nuk do të ketë një komision, i cili do t'i përcaktojë dhe do të diskutojë për pronat të cilat ne mund t'i çojmë në ankand publik, shpallje publike. Komisioni vlerësues, pas pranimit të ofertave, bën vlerësimin e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik për përzgjedhjen e ofertave në faqen zyrtare të komunës, si dhe të njëjtin ua dërgon palëve të përfshira në proces. Komisioni vlerësues, pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, e procedon në kuvendin e komunës për aprovim ofertën e përzgjedhur.

Kuvendi i komunës, me shumicën e votave të thjeshta prej 27 me 14 vota aprovim, vendos për ose kundër ofertës së përzgjedhur nga komisioni. Për zbatimin e vendimit të kuvendit të komunës, obligohet kryetari i komunës të nënshkruajë kontratë me fituesin, me anë të cilës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese. Ligji detyrimisht thotë se vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, paraprakisht ju kisha kërkuar ta shfrytëzoni minutazhin tuaj gjithsecili, edhe replikën.

Driton Ajazi, e dëgjova me vëmendje atë elaborat të kryetarit. Me të vërtetë, po ta dëgjonte dikush që nuk kupton rreth kësaj çështjeje, do të mendonte se përnjëmend ky qenka ai shpëtuesi i qytetarëve të komunës së Drenasit, ndërsa e keqja e faqja e zezë jemi ne. Por, fatkeqësisht apo fatmirësisht, është krejt e kundërta, sepse pikërisht të gjithë e kemi parë dhe i kemi dëgjuar. Sepse na ka krijuar këtë hallin tonë, kjo dhënia e pronave në shfrytëzim është nga praktika e kaluar. Ne të gjithë jemi dëshmitarë se dhënia e pronave në të kaluarën, çfarë procesi e ka përcjellë edhe çfarë investimesh janë kryer. Komuna e Drenasit është një territor jo shumë i madh. Shumica e pronave që janë dhënë në qeverisjen tënde, janë dhënë dhe janë hapur pompa derivatesh. Për më tepër, ka pasur aty njerëz të interesuar pikërisht për të hapur pompë derivatesh, i keni thënë se ato nuk bënë të ndërtohen pompa derivatesh, ndërsa dikujt tjetër ia keni dhënë pikërisht për pompë derivatesh. Ka qenë një pronë aty në Komoran që i ka skaduar afati, edhe ka pasur të punësuar aty edhe personi në fjalë ka kërkuar që t'i vazhdohet dhe sipas ligjit, të drejtën për t'i vazhduar në shfrytëzim asaj prone e ka ai që e ka pasur, domethënë duhet marrë parasysh sepse ai i ka bërë investimet.

Ndërsa, krejt në mënyrë arbitrare keni marrë vendim që atë pronë ta kaloni të Ministria e Punëve të Brendshme kur edhe ju e dini edhe të gjithë qytetarët e komunës së Drenasit, Ministria e Punëve të Brendshme e ka lokacionin në Komoran, e ka parcelën diku rreth 63 ari, që nëse kanë shprehur interes për të hapur stacion të ri policor, kanë mundur ta bëjnë aty. Kush e di, në Komoran përballë ambulancës, është edhe shkollës, domethënë krejt në mënyrë arbitrare e ke marrë dhe ia ke dhënë Ministrisë së Punëve të Brendshme. E përmend edhe objektin e vjetër të komunës. Unë sot këtu para jush e para gjithë qytetarëve të komunës së Drenasit, unë jam shumë krenar që ajo kauzë për të cilën kemi rezistuar nuk ka kaluar. Kryetar, del shpesh e shikon futboll, ku ka në botë një objekt banimi të përdoret si objekt institucional. Duhet me qenë pak korrekt, të flasim mbi bazë reale edhe ligjore. Ai projekt ka qenë puro për interesa personale të dikujt, me i marrë 56 ari, kur një ari këtu kushton 30-40 mijë euro, me i marrë 56 ari e me bërë investim aty, po, 27% komuna. Çka po bëjnë me ato prona. Qysh janë në shfrytëzim sot ato pronat që i kemi, prej objekteve që janë përballë komunës ose objekti ku ka qenë zyra e Partisë

Demokratike. Për çfarë shfrytëzohen ato. Këtu tjetër gjë thuhet, po tjetër gjë po veprohet në terren edhe në realitet. Ë për këtë arsye, unë këtu para jush dhe para gjithë qytetarëve të komunës së Drenasit e them me përgjegjësi të plotë morale edhe juridike, jam për ta mbështetur çdo iniciativë të mirë, çdo projekt zhvillimor që e rrit punësimin, që ia lehtëson jetën qytetarëve, por asesi nuk jam këtu për të shtyrë kauza personale, individuale e biznesore, kujt do qofshin ato. Sepse kemi përgjegjësi qytetare, por kemi përgjegjësi edhe për brezat që do të vijnë. Kryetar, po të drejtohem kështu, koni dhënë leje ndërtimore mbrapa ambulancës. Kryetar, me xhip del e vozitesh, a i ke rënë më frik asaj rruge, më frik asajde. Të jesh i bindur se kanë për të mallkuar qytetarët ty edhe ata që e kanë lëshuar atë leje ndërtimore; kur të vijnë për të banuar ata qytetarët aty, s'keni lënë as rrugë, as hapësirë. E kemi obligim për brezat e ardhshëm, nuk e kemi ne jetën veç këtu 30-40 vjet sa na kanë mbetur për të jetuar, e të mos mendojmë për brezat e ardhshëm. E kam një kërkesë në këtë rast për ju, kryetar, që e koni prurë si listë pronash, nëse e bëni një rivlerësim të kësaj çështjeje edhe largohen pronat që janë prona institucionale, edhe pronat në kuadër të planit urban, qoftë këtu në Drenas, edhe në Komoran, atëherë për prona nëpër fshatra, kushdo që ka interes për të bërë investim, atëherë edhe ne jemi për ta rritur atë vlerë dhe mos të mbeten djerrina ato hapësira. Po të jepet një pronë që është e dedikuar si institucionale edhe të shndërrohet në private personale për dikë, veç për të bërë biznes, kjo është e papranueshme. Edhe kërkesa jonë është që pronat që janë në zonën urbane në Drenas edhe Komoran të largohen, pastaj votën tonë do ta kenë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovi, z. Ajazi, paranojat dhe paragjykimet askujt nuk mundem t'ia heq. Pronat i jepni ju, 27 asamblistët e Kuvendit të Komunës, të zgjedhur me votën e lirë e demokratike të qytetarëve, dhe këto paranoja nuk mund t'i shëroj. Plani zhvillimor, harta zonale, investimet, afati i skadimit. Ju thatë e përmendët pronën që është në monitor, kjo pronë është dhënë për dhjetë vjet nga Kuvendi i Komunës. Dhe në këtë pronë, siç mund ta shihni në anën e majtë timen -sigurisht që duhet ta koni në anën e djathtë - kursorin po e shihni, janë më pak se 10 ari të cilët u shfrytëzuan ilegalisht. Mbrapa kësaj prone edhe në krah të pronës janë shfrytëzuar edhe 30 ari të tjerë ilegalisht, sepse prona i qe dhënë një të fuqishmi. Unë fillimisht ia kam larguar shfrytëzimin ilegal, pastaj ka provuar t'i ndryshojë afatet ligjore të pronës dhe në fund, me orë të tëra, unë edhe jurist jam, kemi diskutuar për mundësinë e vazhdimit sipas tij, të drejtës së vazhdimit të kontratës. Dhe i kam thënë. Krejt avokatët më të mirë të Kosovës m'i sill këtu që mund të gjejnë diku në ligjet e aplikueshme të Kosovës se komuna ka të drejtë t'ia vazhdojë pronën diku që ia ka dhënë për dhjetë vjet. Unë ta vazhdoj. Pra, edhe ty, edhe kujt do qoftë që i ka kaluar afati i pronës, komuna nuk ka të drejtë t'ia vazhdojë afatin, po ka të drejtë t'ia marrë objektin - e ka me detyrim - dhe pastaj ta lirojë objektin për të mundur ta qesë në shpallje publike.

A e merr i njëjti pronar, a nuk e merr, unë nuk vendos, sepse vendosin kriteret e komisionit dhe vendosin duart e asamblistëve. Komuna e vjetër, kushdo që provon ta mashtrojë publikun se në objektin e përcaktuar për qëllim të shfrytëzimit të komunës është në banim ndërtimi. Objekti, ose 27% e vlerës së pronës që e kanë ofruar ofertuesit, e vlerës së pronës, është e ndarë prej objektit hancor edhe biznesor. Dhe në këtë objekt kanë pasur të bëhen zyra, sallë kulturash, biblioteka, salla e mbledhjeve; komisionet e mia, kur folëm më herët, nuk kanë pasur salla ku t'i zhvillojnë takimet. Pra, në objektin e komunës ka veç dy salla, salla juaj, ku edhe të rinjtë që e bëjnë kurorëzimin nuk kanë ku ta bëjnë - nuk ke në objekt, nuk ke as zyra edhe zyra e bordit të drejtorëve. Pra, ky objekt ose kjo sallë duhet të shfrytëzohet për dhjetëra takime, për intervistime,

për kurorëzime, për komisione, sepse nuk kemi objekt. Prandaj, 5,600 metra objekt që do t'i fitonte komuna e Drenasit në një pronë prej 56 hektarësh, me një koeficient 3%, në krahasim me 5,536 metra objekt për nevojat e komunës dhe qytetarëve të Drenasit, e ndamë nga objekti tjetër. Nuk ka investitor në komunën e Drenasit që ka bërë marrëveshje, kontrata, leje, që ka marrë më shumë se 25%. Domethënë, në vendet më strategjike të komunës sonë kanë mbërritur t'i marrin me 25%, dhe ne e kemi pasur kushtin 27% - kush jep më shumë.

Pra, siç thashë, ky konsorcium ka pritur me muaj të tërë për një votë, për një votë, sepse unë nuk e kam lutur askënd. Hajde, votoni. Më thonë sot, a ka dikush që e kam lutur të vijë t'i votojë pronat. Jo, sepse është detyrim i juaji dhe është vendim i juaji, ju vendosni, nuk vendos unë. Sa i përket lejeve mbrapa QKMF-së, ose anash QKMF-së, është një zonë ndërtimore me harta zonale e përgatitur nga GIZ-i gjerman, bashkë me zyrtarët tanë, e votuar nga asamblistët. Besoj që Drenasi po lulëzon, sepse për pesë vjet rresht, të dashur qytetarë, jam akuzuar se nuk po jap leje ndërtimi, se po pres t'ua jap miqve të mi. E që, në fakt, me këto deklarata kanë provuar t'i fshehin veprimet dhe vendimet e kundërligjshme të tyre. Sepse në një zonë ndërtimi, ku koeficienti ka qenë 3.5, kundërligjshëm ka dërguar kryetari në kuvend, e ka votuar kuvendi një koeficient prej 6.8, që as në Prishtinë nuk ka koeficient të tillë. Kur ne po i bënim hartat zonale, planifikimin zhvillimor, koeficientin, GIZ-i gjerman më thotë mua: Nga ka dalë ky koeficient prej 6.8. Thotë: Ne e kemi bërë dhe ai është 3.5. Dhe unë e kam kthyer vendimin në kuvend, vendim nuk kam gjetur. I kam shkruar Ministrisë Pushtetit Lokal, a e di çka më ka thënë shefi i zyrës ligjore të pushtetit lokal Kryetar, Ministria e ka kthyer negativ, Ministria e Ambientit, po ne kemi harruar t'ua kthejmë në komunën e Drenasit dhe fillo ta zbatosh vendimin prej këtij momenti. Jo, i kam thënë, prej këtij momenti, unë kur më ka thënë GIZ-i, e kam marrë vendimin ta kthej koeficientin real që ka qenë ligjor.

Po prej këtij momenti po të bëj kallëzim penal. Dhe akoma është nën aktakuzë zyrtari ligjor i ministrisë së pushtetit lokal, pse nuk e ka kthyer vendimin negativ. Dhe për pesë vjet qytetarët tanë nuk ia kanë dhënë pronën investitorit, sepse në vend që, për shembull, për një 'x' pronë të mund t'i fitonte pronari i tokës dy banesa, ai me ligj e fitonte vetë një, ndërsa me atë ligjin që ishte në kundërshtim me të gjitha ligjet e zbatueshme në Kosovë, i fitonte dy ose tri banesa. Prandaj, nuk ka pasur për pesë vjet ndërtim në Drenas. Dhe kushdo që mendon që ia ka arritur t'i shesë shkeljet e veta, ose të miqve të vet, të ligjeve e t'i adresojë të unë, e ka pasur gabim. Ndërtesat mbrapa QKMF-së janë me plan, janë sipas standardeve dhe sipas hartës zonale. Më 2027-2028, nëse s'gabo, ne e kemi rishqyrtimin e hartës zonale dhe bashkë me ekspertët që do të na ofrojnë ekspertizën - qoftë gjermanë, britanikë apo këdo që të na caktojnë - ne do të punojmë bashkë për hartat e reja dhe se nga do të shkojë zhvillimi i Drenasit. I përmendën zyrat e PDK-së. Jo vetë zyrat e PDK-së, ish-zyrat, për të cilat ka paguar Kadri Veseli dëme të mëdha, sepse i ka shfrytëzuar partia ime në kundërshtim me ligjin. Dhe e kanë mashtuar edhe kryetarin.

Të thonë 'mos tani', se unë e kam çuar.

Unë po besoj që nuk kam bërë asnjë veprim deri sot për kauzë personale. Unë kam provuar t'u jap më të mirën qytetarëve të Drenasit dhe shumë herë ju kam lutur kur ka qenë interesi i Drenasit - siç thashë, për grantin e performancës, për me muajt me votë e të marrim të hyra. Sepse komuna jonë ka 6 milionë euro buxhet për investime kapitale, ndërsa Komuna e Shtimes, që është dy herë më e vogël se e jona, i ka mbi 10 milionë në buxhet të votuar, e mos të flasim edhe sa miliona të tjerë ia dërgon Qeveria, sepse qeveriset nga kryetari i cili i takon asaj partie. Ju folët për pronën që ia kam dhënë Policisë së Kosovës, jam tepër i lumtur që Kuvendi e ka votuar për t'ia dhënë Policisë së Kosovës. Nuk ia kam dhënë unë, por Kuvendi. Sepse unë e kam

pasur atë pronë edhe një herë në listë paraprake për ta nxjerrë në konkurrim, që të fitonte dikush, qoftë edhe personi që e ka pasur, për me mujt të përfitojmë për afat të gjatë.

Ai ka aplikuar pa asnjë dokument, pa asnjë garancion. Jemi e vetmja komunë, po besoj, në Kosovë që kur i ofrojmë operatorit apo kompanisë që do të investojë, ne e kemi një kusht, mos të na e nxënë pronën e të na e mbajë disa vjet ose ta stërshitë atë. Por, nëse prona e ka ofruar shumën e investimit për një pronë (të komuna e vjetër, nëse s'po gabojmë mos më merrni për gjuhe), diku 4 milionë investim, 1,200,000 euro kanë bërë garancion (30% të investimit). Në qoftë se ata tërhiqen, komuna t'i përfitojë ato.

Dhe a e dini sa muaj i keni mbajtur ata njerëz. Kanë paguar garancione, kanë harxhuar para të mëdha derisa vetë janë tërhequr, sepse s'kanë qenë të interesuar. Unë nuk lejoj asnjë asamblist të më blihet apo të më shitet për pronat publike. Kështu që, jeni munduar edhe me dhjetëra profile false të shpifni gjithëcka për mua, përveçse keni marrë dënim prej gjykatës, nuk keni marrë diçka tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, një minutë replikë z. Ajazi.

Driton Ajazi, kryetar, shumica e atyre që deklarove me të vërtetë janë të pavërteta dhe të paqëndrueshme. Këtu ne po themi prapë: të kishte qenë një person që na ka lënë një praktikë të mirë, që përmendim ka qenë konform interesit qytetar, zhvillimit ekonomik, konform rritjes së vlerës së pronës në të kaluarën - për besë, unë për herë të parë jam në asamble po dy duart i kisha çuar e kisha thënë. "Lum ne çfarë kryetari kemi!".

Po në praktikë, o kryetar, është krejt e kundërta. Edhe ne e dimë, edhe ti e di, ato audio-incizime që i përmendë vetë, ato e tregonin një logjikë tjetër tënden, një logjikë të pazareve. E para, kjo është skandalozë. Në asnjë ligj e që më profesionalisht është Limani sa i përket çështjeve, nuk të lejon ty të bësh mbindërtim. Unë nuk e di një ligj që të lejon ty të bësh mbindërtim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, koha përfundon për ju, z. Ajazi. Urdhëroni znj. Tërdevci, fjala për ju.

Egzona Tërdevci, faleminderit shumë, kryesues. Përsëritet për të gjithë. Filloj me leximin e një neni të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, përkatësisht nenit 14. Pika e parë thotë se kryetari i komunës i propozon Kuvendit të Komunës për miratim paraprak pronën e paluajtshme të komunës për dhënie në shfrytëzim, duke paraqitur arsyet dhe interesin publik.

Ju lutem, a mund t'i prezantoni arsyet dhe interesin publik për dhënie e këtyre 27 (tash 25 me vendimin e ri që e keni sjellë dje)? Sepse arsyetimi i dhënë në propozim-vendim është një arsyetim shabllon, ku nuk tregohen qartë arsyet e interesit publik për t'i dhënë këto prona. E kam thënë seancën e kaluar, e kam thënë në Komitet, po e them edhe këtu, cila është logjika që 25 prona, pavarësisht se janë të ndryshme, të gjitha të jepen për afat të gjatë deri në 99 vjet? Kanë qenë "për 99 vjet", por me insistimin tonë e keni ndërruar vendimin dhe e keni bërë "deri në 99 vjet".

Prapë është afatgjatë. Për ne është problem se cilat nga këto prona të planifikuara për shfrytëzim afatgjatë, por po ndalem specifikisht në disa prej tyre, parcela 13/0 në Gillobar. Nëse e shihni listën e pronave të veçanta, por edhe Gjeoportalin, e shihni se kjo parcelë është parkingu i pishave në Gillobar, po ashtu edhe një pjesë e rrugës që dergon të pishat. Ju lutem, a ka mundësi të shpjegoni logjikën pse duhet të jepet në shfrytëzim parkingu dhe rruga për te pishat.

E përsëritet heqjen e dy ngastrave kadastrale, asaj 265/2-4 dhe 2529/3 në Arllat, që i kam përmendur edhe në Komitet. E keni thënë në mbledhje të Komitetit që keni planifikuar një fushë

për Arllatin, edhe kryesuesi e ka konfirmuar të njëjtën, kështu që mirë që megjithatë për një pronë keni reflektuar. Trembëdhjetë nga këto prona janë të llojit shërbim tregtar-komercial. Pse duhet të jepen për afatgjatë këto prona. Në Komitet e keni përmendur, e përmendni edhe sot, se disa veçse janë në shfrytëzim. Jepini për afat të shkurtër, bre! Pse t'i bllokoni për 99 vjet. Por edhe mund të mos i jepni fare.

Ju paraqiteni si një sy i fortë e zbatues i ligjit, nëse vërtet jeni i tillë, nuk besoj që e keni problem t'i lironi këto prona. Katër nga këto prona janë zonë bujqësore. Cila, bre, është arsyeja që zona bujqësore duhet të jepet në përdorim për 99 vjet, për afat të gjatë? Të të nga këto prona janë për banim dhe banim të lartë. Kjo edhe mund të kishte logjikë që të jepet për afat të gjatë, por për pronat e tjera, për besë, është krejtësisht e paarsyeshme të jepen për afat të gjatë. Jemi dëshmitarë se sa është manipuluar me pronën publike përgjatë mandateve të Ramiz Lladrovci si kryetar komune. Me premtime për shumë vende pune, investime dhe për të hyra të mëdha komunale, ishin dhënë prona për shfrytëzim afatgjatë. Në mandatin e dytë, z. Lladrovci, nëse shikojmë të hyrat e marra nga raportet financiare, ato janë vlera të papërfillshme.

Në këtë kuvend, përveç një raportimi të thatë e formal, të cilin e kemi pasur në seancën e kaluar, asnjëherë nuk është raportuar siç duhet për pronat që aktualisht janë në shfrytëzim afatgjatë. A i kanë realizuar vërtet investimet e premtuara kompanitë dhe personat fizikë që kanë marrë në shfrytëzim pronat e komunës sonë. A ka ndikuar vërtet në zhvillimin ekonomik e në rritjen e punësimit në Drenas, apo kjo dhënie në shfrytëzim vetëm ua ka shtuar fitimet atyre.

Ne si Lëvizje Vetëvendosje e kemi kundërshtuar dhe do të vazhdojmë të kundërshtojmë dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Drenasit për shfrytëzim afatgjatë deri në 99 vjet, sa herë që nuk bëhet fjalë për interes publik. Ne nuk kemi qenë asnjëherë, e as nuk jemi, kundër zhvillimit ekonomik të komunës sonë, por dhënia e 25 pronave publike pa asnjë analizë të mirëfilltë për 99 vite nuk i kontribuon aspak zhvillimit ekonomik.

Sidomos pas asaj që kemi dëgjuar me veshët tanë për mënyrën se si ju keni tentuar ta ritni vlerën e pronës publike, të freskëta i kemi diskutimet tuaja milionëshe, ku si një kryetar që thirret në ligj, nuk e keni pasur problem - gjithë herë duke u thirrur në ritjen e interesit të pasurisë publike. Flisni edhe për mbindërtimet, që të gjithë e dimë se janë të jashtëligjshme. Nuk mundem pa e përmendur se sa jo profesionistë jeni si ekzekutiv, nuk keni qenë në gjendje që një propozim ta hartoni si duhet.

Propozimin fillestar na e keni dërguar për 99 vite. E keni ndërruar pas propozimit tonë, e keni bërë 'deri në 99 vite'. Në propozimin që na keni dërguar dje, nuk ka qenë e saktë paraqitja ortofoto për të gjitha pronat. Pasi dërgova e-mailin të të gjithë ju, të kryesuesi dhe të gjithë të tjerët, na është dërguar edhe një herë propozimi i ndarë në tri pjesë.

Të lista tabelare e sjellë nga Drejtoria për Gjeodezi, një parcelë ka numër ndryshe nga propozimi, e gjashtë parcela kanë sipërfaqe më pak sesa ajo që mund të jepet. I njëjti gabim është reflektuar edhe te paraqitja me ortofoto e dërguar dje të ne.

Aman, para se të bini propozime në Kuvend, shikoni edhe një herë. Nuk është marrë të konsultoheni me dikë kur nuk dini. Sillni vendime që janë të pakta në minimumin profesional. Edhe kur keni folur në mandatin e kaluar, edhe tash, asamblistët që nuk i kanë votuar pronat i keni quajtur bllokues. Ne si Lëvizje e kemi dëshmuar që nuk jemi bllokues; kemi votuar pronat për interes publik, kemi votuar për pronën që ka qenë për t'ia dhënë Policisë, kemi votuar edhe për pronat për zhvillim të energjisë, por jo për prona për interesa personale e për PDK-në.

Ama bre, mos na mbani moral. Deri dje ka qenë kryetar i partisë suaj, deri dje keni hashkëqeverisur me të, deri dje e mbani përgjegjësinë për secilin veprim të tij. Po për besë, e

dimë që edhe po të kishte fituar krahun tjetër i PDK-së, trajtimi i pronës publike nuk do të ndërronte fort. Çka më bind që do të ndërronte, janë grupet e interesave, sepse nuk i keni përkrahësit e njëjtë, ndoshta ata ia kishin dhënë diku tjetër. Për fund: më me qejf e mbaj tërë jetën opitetin e 'bllokuesos', sesa të bëhem argat në keqpërdorimin e pronës publike. Tash, po përmend disa të pavërteta që i thatë lidhur me objektin e pronës së komunës, që ka qenë pjesë e dhënies së pronave në mandatin e kaluar.

Ë para, mund ta kontrollosh njëherë listën e pronave të veçanta - lista e komunës. Pra, parcela ku është komuna e vjetër nuk është pjesë e listës së pronave të veçanta; mund ta verifikosh këtë çështje. Në sllajdin që u paraqit këtu në publik, sipërfaqja që do të përfitonte komuna ishte 5,536 metra katrorë. Tash është pak paradoksale, se në planin e biznesit që kemi marrë ne atëherë (i konfirmova edhe një herë dokumentet), janë 4,585 metra katrorë që përfiton komuna. Ndërsa në projektin ideor janë 5,600 metra që i përfiton komuna. Është shumë e çuditshme që për të njëjtën çështje t'i kesh tri sipërfaqe të ndryshme.

Pastaj, e patët gabim edhe te investitorët: nuk kanë qenë katër, kanë qenë pesë - mund ta konfirmoni edhe këtë me dokumentet që i keni. Po ashtu, u tha që ka qenë i ndarë objekti afarist dhe objekti banesor. Nëse e shihni edhe këtu te plani i biznesit, fillimisht është: objekt afarist, banesor dhe administratë.

Për besë, pajtohem në një pjesë me parafralësin se nuk ka logjikë që brenda objektit afarist-banesor të ketë edhe objekte publike. Si përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje, ke garancinë time që do ta kesh mbështetjen e plotë nëse kërkon ndërtimin e një ndërtese të tillë publike. Kam pasur për këtë çështje edhe zotimin e ministrit Çeku për një sallë të kulturës dhe me objektet e tjera përcjellëse, dhe do të kishit mbështetjen time të plotë, por jo për të bërë objekt afarist-banesor për interesa të kujtdo qoftë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, thatë se gjatë investimeve në kohën time, nga përfituesit e pronës publike, a janë bërë investimet për të cilat ka deklaruar investitori. Besoj që ato mund t'i siguronit lehtësisht, sepse ato janë dorëzuar të një komision, ose janë parë te një komision i komunës dhe duhet të jenë raportuar në ATK. Lehtë është. Jo, unë as nuk shkoj ta kontrolloj dikë se sa para i ke futur, as nga i ke futur, as si i ke marrë, as si i ke bërë. Është shumë e vërtetë që gabim teknik ka pasur në propozim-vendimin për 99 vjet, dhe ju e dini që në mbledhje të Komitetit edhe të kam vërtetuar që kam pas shkruar - para se t'i ta ngritesh si çështje, për ta përmirësuar një gabim teknik. Dhe të kam thënë. Fgzonë, ligji e përcakton, nuk mund të shkruaj ndryshe, sepse ligji e përcakton deri në 99 vjet. Thatë se pronat duhet t'i japim me më pak kohë. Me çfarë më pak kohë. Nxirreni Komoranin, Arllatin. edhe nja dy-tri prona në Komoran. Ajo tha që ia kam marrë e ia kam dhënë Policisë e që jam shumë i lumtur, bre, për atë punë. Nuk ia kam dhënë unë, Kuvendi e ka votuar.

Prona ku është stacioni i Policisë është bllokuar. Domethënë me ligj, kur investon në një pronë, qëllimi është t'ia rritësh vlerën pronës. Në kur kemi investuar, investitori ia ka aritur vlerën, por e ka marrë për 10 vjet; nuk e ka marrë për 30, as për 45. U mundua t'i falsifikojë dokumentet, t'i bëjë për 45 vjet, edhe ia kam tërhequr vërejtjen që 'të çoj te vendi', sepse për të hartuar kërkesa për t'u ndjekur për falsifikime. Besoj që e keni parë, edhe po qesh Artiani se e ka 'ngrenë' vetë d. Prona tjetër, janë dy-tri prona në Komoran, në rrugë kryesore. Dhjetë vjet e kanë pasur pronën në shfrytëzim dhe s'kanë mbërritur t'i nxjerrin as muret me blloka e me beton.

Prona tjetër në rrugën 'Xheladin Gashi'. Janë dy prona të cilave u ka dalë afati. Në qoftë se no nuk i fusim aty, duhet t'i mbyllim ato; e po i mbyllim, po mbyllim edhe vendet e punës. Por unë

askënd nuk mund ta mbaj pa kontratë, sepse nesër thoni. 'A e mbajti ai' edhe më paditni.

Azhurnimi i pronave - prona më e madhe, prona më e vogël - ajhurnimi i pronave, për çfarë ju thashë në fjalimin tim, unë do të kërkoj një komision prej jush. Ju keni për të ardhur e për të më thënë. Prej 27 sa kanë qenë, dy i kemi hequr. Kryetar, këto prona ne pajtohemi t'i qesim në shpallje publike. Jam duke u deklaruar shqip. Egzon, the për pronat bujqësore. Një zonje e nderuar, që nuk e kanë lënë as fshat më vete, e ka mbajtur stallën, e ka ndërtuar me duar e me thonj dhe po lyp pronë a duhet t'ia japim a s'duhet t'ia japim. Unë mund t'ia dhënë pa ju pyetur juve veç për 11 muaj, po për 11 muaj po e ndërtoi, duhet ta heqë, sepse nesër do të thoni. Jo, s'po na duhet për diçka tjetër. Prandaj, pronat bujqësore i kanë kërkuar, si dhe shumë prona të tjera që njerëzit i kanë para shtëpive të veta ose që i shfrytëzojnë ilegalisht. Sepse ju e dini që ne e kemi ajhurnuar, të gjitha hartat e tokave tona janë mbi 5,600 prona të uzurpuara prej qytetarëve dhe mbi 2,600 janë prona të uzurpuara me ndërtim. Pra, dikush e ka nxjerrë gardhin jashtë, dikush e ka bërë bashkë, dikush ka mbjellë pemë e kështu me radhë.

(Kryetari kërkon t'i vendoset sllajdi në monitor për pronën e Gllobarit).

T'i shpjegoj zonjës Tërdevci, një herë më ka akuzuar që e kam bërë parkingun për një biznes të një shoku tim, e ai është bashkëpartiak i saj- nëse e mohoni, ajo është tjetër temë. Këtu janë dy prona të cilat deri dje janë shfrytëzuar ilegalisht. Ne jemi në përfundim, nëse s'po gaboju, të parkut të pishave në Gllobar edhe komuna ka nevojë e interes t'i shfrytëzojë këto dy parcele në një pronë. T'i shfrytëzojë për investime, sepse edhe punësojnë, edhe rritin zhvillimin ekonomik, dhe nuk i shfrytëzon dikush ilegalisht. Këto i kemi sjellë, ju vendosni; nuk jam duke vendosur mbi asnjë pronë.

Kot flisni, sepse qytetari ju ka kuptuar. Z Ajazi, ty të ka provuar qytetari me një subjekt tjetër dhe ke humbur. Ta kemi dhënë mundësinë me këtë subjektin tjetër, ke humbur vetë, kështu që qytetari e vlerëson saktë. Po të më kishte rrëzuar mua, kisha thënë se kam punuar keq, por asnjëherë qytetarin s'e kam sharë as sulmuar pse më ka votuar apo s'më ka votuar. Si kryetar komune, për çdo qytetar, por edhe për juve, jam i barabartë. Prona në Arllat, diku një livadh: atëherë kur e kemi votuar buxhetin për fushë sporti, ishin dy parcele në Arllat. Kur e kemi votuar, nuk u hoqën sepse gabimet kanë ikur por gabime ka pasur. Unë asnjëherë nga këto nuk e kam bërë; i kanë bërë zyrtarët komunalë që merren me vlerësimin e pronave ku ka interes për publikun e për qytetarët tanë.

Në Komoran, të 'Kroni i Mbretit', në pronë private ka investuar një qytetar i joni, një objekt hotelier, i cili nuk ka pasur fare qasje nga autostrada. Një herë na e ka bllokuar pronën — prona është e AKP-së, ka shkresa, ka vendim të këtij Kuvendi për interes të përgjithshëm që e kemi shpallur atë pronë sepse i takon zonës së Parkut të Biznesit dy i ka mbyll. E ka bërë liqen! Inspektorët e mi kanë presion nga ministria. Ka e-mail dhe sigurisht që do të adresohet në prokurori: me qindra ari pronë publike i ka bërë pishinë (bazen), sepse e ka bllokuar rrjedhën normale të ujërave atmosferike për të mundur ta marrë prej AKP-së - 40 ari pronë për një shumë 128.50 euro vjetore në Parkun e Biznesit, duke përfshirë edhe TVSH-në.

Njëjtë e kemi pronën të stadiumit sintetik në Çikëtove, e cila është kërkuar të jetë interes publik, por i është dhënë aktivistit të Vetëvendosjes, zotit Gruda. Në vend që të na e japin neve, edhe aty kemi problem pronësor me AKP-në. I është dhënë prona për 300-400 euro vjetore, kur ajo pronë kushton miliona euro. Këto janë të papranueshme dhe ne po provojmë t'i identifikojmë se kush është uzurpatori e kush përfituesi i paligjshëm.

Egzona Tërdevci, e para, e përmenda parcelën 13/0 në Gillobar. Thuhet se shfrytëzohet ilegalisht. Nuk e di si mund të quhet 'ilegalisht' përdorimi i parkut natyror prej qytetarëve - ajo hapësirë është publike që të parkohen njerëzit që shkojnë në park. Çfarë ka këtu ilegale. Nuk po e kuptoj pse duhet t'i jepet në shfrytëzim diku tjetër. E thatë që mund t'i marrim informatat për pronat që keni dhënë më herët. Po, i kam marrë informatat dhe shqetësimi im është se është tepër shqetësuese të japësh pronë për pompë derivatesh e të figurojnë aty edhe nja gjashtë biznese të tjera. Ai zotëria t'i rritë fitimet, e komuna të përfitojë pak mijëra euro brenda katër viteve? S'po i them shifrat se mund të dënohem, por i kam dokumentet nga qasja në dokumente publike. E thatë që kanë aplikuar disa zonja për të marrë pronë, nuk kam asgjë kundër, po pse duhet secila pronë të jepet për afatgjatë. Nuk po e kuptoj arsyeshmërinë. Dhe një çështje e fundit: kur i përmendët investimet, thatë se njëri prej investitorëve ka qenë mbështetës i Vetëvendosjes. Të garantoj publikisht se asnjëri prej investitorëve që kanë pasur të investojnë në objektin afarist-banesor të komunës nuk janë mbështetës të Vetëvendosjes në nivel lokal. Kanë mundur të jenë mbështetës tuaj, por të Vetëvendosjes as nuk kanë qenë e as dyshoj që do të jenë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, Egzon, për pronën të pishat nuk fola. Tola për dy parcela që janë aty, një pjesë të parcelës e kemi bërë parking për qytetarët. Egzon, shqip kam folur në Komitetin për Politikë e Financa, shqip po flas edhe tash, një komision i juaji i bën azhurnimet e pronave. Ne kemi pronë ku kalojnë pesë rrugë. Kur ta bëjmë azhurnimin, duhet ta bëjmë siç duhet, t'ia japim mundësinë e qasjes çdo pronë, çdo shtëpi, çdo are. Pastaj, pronë që mbetet, jepet në shfrytëzim. Pra, bëhet azhurnimi i ri dhe kur bëhet ai azhurnim, aty përcaktohet se është parking publik. Nuk kam mundur ta bëj edhe më poshtë se s'kam pasur buxhet, se deri në fund do ta kisha bërë parking. Dhe ju kam deklaruar publikisht: asnjë parking në Komunën e Drenasit, sa të jem unë, nuk ka për t'u bërë me pagesë.

Kur t'i azhurnojmë parcelat, tek atëherë i ndjekim procedurat dhe themi. Kjo ka për të qenë pjesa e parcelës. Kush dëshiron të aplikojë për ta marrë, e merr ai që ofron punësim më shumë, ofron investim më shumë dhe ofron pagesë të qirasë më shumë. The për pompat e benzinës - kush më shumë se unë i ka urryjtë pompat e benzinës? Më thuaj, me cilin ligj e me cilën rregullore ia ndalon një investitori ta bëjë pompën e benzinës, kur ata sjellin draft-projektin ku janë të gjitha bizneset e tjera brenda pronës që ka. I përcaktohet koeficienti i ndërimit.

Nuk është pompa vetëm për të punësuar tre veta, por i ka punësuar njëri 120, tjetri 60, e tjetri 70 punëtorë. Ky është zhvillimi ekonomik. I kam të gjitha mediat duke e përcjellë mbledhjen, po ashtu edhe (KTV) ka ardhur. I falënderojmë për prezencën e tyre, për durimin, për gjithëkës. Dhe i lusim që të mos i shkëpusin fjalitë nga konteksti kur t'i japin në emision; nëse nuk është drejtpërdrejt, të mos i shkëpusin e t'u bëjnë dëm fjalive tona.

Arbër Halilaj, përshëndetje për ju, kolegë asambleistë! Kryesues Bujupi, Kryetar Lladrovci, të nderuar drejtorë prezentë, mysafirë dhe qytetarë të Drenasit. Sa i përket dhënies së pronave komunale në shfrytëzim deri në 99 vite në Komunën e Drenasit, që bazohet në dispozitat e Ligjit nr. 06/L-092, do të bëj një ekspozitë dhe analizë paksa më të gjatë, sepse vetë kjo çështje po zvarritet prej kohësh. Pronat komunale po i diskutojmë në një mjedis të karakterizuar nga përçarje të thella politike, veçanërisht ndërmjet PDK-së si opozitë dhe iniciativës politike të Kryetarit Lladrovci në qeverisje. Sa i përket dhënies së pronave komunale në shfrytëzim deri në 99 vite në Komunën e Drenasit, që bazohet në dispozitat e Ligjit nr. 06/L-092, do të bëj një ekspozitë dhe analizë paksa më të gjatë, sepse vetë kjo çështje po na zgjatet e zvarritet që sa kohë.

Pronat komunale po i diskutojmë si çështje në një mjedis të karakterizuar nga përçarje politike të thella, veçanërisht brenda PDK-së si opozitë dhe iniciativës politike të Kryetarit Lladrovi në qeverisje. Pas informatave që kemi marrë dhe analizuar lidhur me pronat nga lista e propozuar, është vendim i BD-së dhe qëndrim i mi personal që të shkëpusim vendimin tonë nga lufta politike e momentit dhe ta lidhim atë ekskluzivisht me një vizion zhvillimor afatgjatë të komunës. Pavarësisht kontekstit politik që theksova, ne do të mbështetemi në parimet e Ligjit nr. 06/L-092, si instrument ligjor i miratuar për të mundësuar zhvillimin ekonomik të komunave.

Dhënia në shfrytëzim afatgjatë prej 15 deri në 99 vite, e parashikuar në Nenin 6 pika 1.2 e Ligjit, është një nga elementet për të tërhequr investitor serioz që kërkojnë siguri maksimale për kthimin e kapitalit të tyre në projekte afatgjata, që tejkalon personazhet dhe ciklet katërvjeçare politike. Ky afat i dhënies në shfrytëzim është mekanizmi i vetëm ligjor për të garantuar stabilitet për investitorin, që nuk mund ta garantojnë zyrtarët politik në pushtet.

Në këtë proces, mendoj se interesimi i Asamblesë Komunale duhet të fokusohet në: Kontrollin të brendshme funksionale për menaxhimin dhe monitorimin e pronave përgjatë tërë procesit.

Mbikëqyrja e zbatimit të kërkesave ligjore nga ana e Komunës gjatë procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme.

Sigurimi i Asamblesë që ne do të jemi pjesë e një sistemi funksional të monitorimit, vlerësimit dhe mbikëqyrjes së kontratave të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.

Kësisoj, do të kemi kontroll mbi zbatimin e obligimeve kontraktuale nga operatorët ekonomik, mbi realizimin e përfitimeve të parapara nga kontratat ... që janë para publike në interes të qytetarëve, si dhe kontroll mbi shfrytëzimin e pronës komunale sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe sipas qëllimeve të investimit apo projektit. Ky duhet të jetë roli i Kuvendit Komunal në këtë çështje, sepse kemi të bëjmë me prona, me parancë publike dhe njëdhimisht me interesin e qytetarëve. Çdokush që e mbron interesin e qytetarëve duhet të jetë pjesë aktive e monitorimit dhe vlerësimit të këtyre procedurave.

Në diskutimet që kam pas me ekspert të pushtetit lokal, me njohës të ligjeve në fuqi në bazë të të cilave ne veprojmë dhe marrim vendime, me njohës të politikave ekonomike në nivelin qendror, si dhe anëtarë të kuvendeve komunale të Prishtinës, Obiliqit, Lipjanit me të cilët kam shtjelluar çështjen e pronave komunale në shfrytëzim, në asnjë rast nuk kam hasur në mbështetje nga ta për bllokimin e procesit që në fillim. Edhe si "Bashkimi Demokratik", por edhe si qëndrim personal, gjithnjë do të jemi PRO kërkesave për shpalljen e dokumentacionit teknik, detajeve të plota të kushteve kontraktuale me investitorët, planin e tyre afatgjatë të investimit, vlerësimin e pavarur të pronës dhe destinimin e saj, si dhe të vendosen në kontratë sanksione të qarta dhe të monitorueshme për moszbatimin e afateve, të cilat në fakt i kërkon edhe Ligji nr.06/L-092, ku po citoj Nenin 5 që është themelor:

Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës:

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bazohet në këto kriteret:

1.1. Prona e paluajtshme e komunës për dhënien në shfrytëzim të jetë e regjistruar në regjistrat kadastralë të pronës;

1.2. Qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës të jetë i harmonizuar me dokumentet e planifikimit hapësinor;

1.3. Të ketë arsyeshmëri të interesit publik apo përfitimit ekonomik të komunës;

1.4. Të plotësojë kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore.

Kritere këto që janë të plotësuara në Listën e veçantë të pronave të propozuar për Kuvend, ndërsa pika 1.3 mund të vlerësohet saktësisht vetëm pasi të kemi aplikime me projekt-propozime konkrete nga operatorët, e jo në këtë fazë. Prej Nenit 13 deri në Nenin 20 Ligji sqaron posaçërisht procedurën prej publikimit të listës së pronave komunale, e deri tek vlerësimi i ofertave dhe shqyrtimi i ankesave.

Partia të cilës i takoj, kryesia dhe kryetari i saj, nuk përkrahin qëndrimet bllokuese e defetiste, por përballjen dhe diskutimet aktive lidhur me problematikat që shtrohen në Kuvend. Pra, edhe si qëndrim i BD-së por edhe për të hequr dyshimet në keqpërdorime që vazhdimisht ceken dhe për të kontribuar që pronat të jipen për qëllimin e zhvillimit ekonomik dhe përfitimit financiar në të hyrat komunale, ne mendojmë se duhet së pari të jemi pjesë aktive e procesit, e komisioneve vlerësuese dhe raportimeve rreth kësaj çështjeje të politizuar pa nevojë.

Qëndrimi i kundërt, pra si një luftë grupimesh politike të dala nga e njëjta parti që ka qeverisur Drenasin mbi 2 dekada, e cila po bartet ndër vite - sidomos e riaktualizuar që nga fushata elektorale 2025 dhe që nuk po përfundon as tani, krijon një klimë mosbesimi, mosbashkëpunimi dhe konfuzioni edhe në opinionin publik, duke proklamuar një kauzë që na ndan në grupin e asambleistëve mbrojtës të pronës komunale dhe atyre që automatikisht konsiderohen shkeles të interesit qytetar. Asambleistët opozitar jemi ndërmjet kësaj lufte brenda sojit, e që e ka thjeshtuar çështjen jo në logjikën ekonomike, financiare apo edhe shoqërore, por thjeshtë a je PRO apo KUNDËR. Kjo është qasje e pasinqertë dhe pikërisht shpalos luftën për interes dhe për ego politike të një grupimi ndaj tjetrit – përndryshe, po të mos ishte kështu, sot do ta diskutonim pikën 7 të rendit të ditës si një pikë normale dhe si një obligim i rezervuar i Kuvendit Komunal, edhe me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale. Unë dua t'ua rikthej vëmendjen dhe të reflektoj edhe nga situata e bllokimit 5 mujor të Asamblesë në legjislaturën e kaluar, e nxitur po nga kjo pikë e rendit të ditës, që e pata mbështetur duke menduar që njëmend kemi një kauzë të qartë se pse jemi kundër dhe ku po synojmë të arrijmë. Me atë bllokim tonin, ne në fakt e kemi ngritë fuqinë politike të kryetarit para zgjedhjeve që po vinin, i kemi bërë shërbim disa personave në kryesinë qendrore të partisë që fërkonin duart se mos po vijnë në pushtet dhe e godisnin murin që e kishin përpara me kokat tona. Mirëpo, në periudhën që pasoi u qartësua gjithçka rreth qëllimeve të secilit dhe zhgënjimi im me grupimin që e kisha përkrahur ishte tejet i madh. Bile, e përgëzoj kolegën Egzona për nuhatjen politike që kishte gjatë bisedave të atëhershme, kur ishte pjesë e grupit. Çfarë ka gjeneruar bllokimi i kësaj procedure në Asamble atëherë ose çfarë synon sot, në rrethana dhe me një përbërje të re? Cila është ideja apo hapi vijues pas refuzimit apo më mirë të them pas ikjes nga përgjegjësia për këtë detyrim të rezervuar për Asamblenë komunale, siç janë pronat komunale? Po e bllokojmë Ramizin dhe ku të dal le të dal, apo.

Duke e bllokuar këtë proces ende pa pasë shpallje publike, oferta, konkurrim, arsyeshmëri ekonomike apo projekte investive për t'i vlerësuar një komision se a ia vlejnë të aprovohen apo jo, ne nuk realizojmë obligimin tonë si asambleist rreth implementimit të PZHK-së, shtimit të vlerës së pronave komunale, që rrjedhimisht i rritë të hyrat financiare, pra paranë publike, e këtu

pastaj vjen në shprehje interesi i qytetarëve që përfitojnë investime nga këto të hyra. Si ia mundësojmë ne qytetarëve dhe bizneseve që planifikojnë projekte investive, konkurrimin në shpalljen publike, kur jemi në pikën zero, apo po mjaftohemi me prioritizimin e inateve personale e politike? Për këto pyetje që ngrita nuk kam dëgjuar përgjigje të qarta në 5 vitet e fundit ose dëgjoj kauza që në ecencë janë false. Ne si BD nuk do të jemi pjesë e luftës së brendshme PDK-PDK, që realizohet edhe përmes këtyre pronave, e që synimin e ka të cekët dhe me bazë në politika klanore. Sot jam i bindur se interesi i qytetarit është që pronat komunale të gjenerojnë të hyra që shfrytëzohen pikërisht në të mirë të qytetarëve dhe në projekte për qytetin, ndërsa ngecja apo bllokimi që në hapin e parë tek lista e veçantë e pronave komunale, është tërheqje nga një obligim i rezervuar për Kuvendin Komunal dhe i domosdoshëm për të shkuar në hapin tjetër, ku pikërisht aty do të vlerësojmë një nga një projektet investive, arsyeshmërinë e tyre ekonomike, plotësimin ose jo të kriterëve ligjorë etj. siç bëjnë komunat tjera me klimë më normale politike. Votimi im sot nuk është një votë blanko për ekzekutivin apo qeverisjen lokale, por është një vendim politik që synon të vendosë mekanizma të fortë kontrolli kuvendar e administrativ në një proces për të mirën e përgjithshme.

Liman Krasniqi, përshëndetje për të gjithë. Sa i përket pikës së rendit të ditës numër shtatë, ku kërkohet të miratohet propozim-vendimi paraprak për dhënien e pronave të paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë personave fiziko-juridik. Bazuar në diskutimet e bëra në mbledhjen e kaluar, që është trajtuar kjo pikë e rendit të ditës, si edhe diskutimin tim dhe arsyeshmërinë nga aspekti profesional urban për pronat që gjenden në zona urbane dhe që janë të domosdoshme të destinohen për objekte me funksione publike, si: objekte me karakter arsimor, administrativ, kulturor, komunal dhe objektet që i shërbejnë nevojave të banorëve në këto vendbanime, kërkoj që këto pronat në zona urbane të mos jepen në shfrytëzim për sektorin privat, por të mbeten prona në shfrytëzim nga komuna dhe të destinohen për funksionet e lartcekura. Përndryshe, dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim do të ketë pasoja në të ardhmen në zhvillimin e funksioneve për objekte publike dhe ndikimi i tyre do të jetë i drejtpërdrejtë në plotësimin e nevojave të popullatës tash dhe në të ardhmen.

Prandaj, propozoj që të hiqen nga lista e propozuar pronat komunale që gjenden në zona urbane, dhe konkretisht këto parcela: ngastra kadastrale në Drenas, numër 758/1; ngastra kadastrale në Gillobar, numër 438/5, ngastra kadastrale numër 244/4, zona kadastrale Komoran; ngastra kadastrale numër 244/5, gjithashtu Komoran; ngastra kadastrale numër 1981/0, po ashtu Komoran, ngastrat kadastrale numër 4/180 dhe 133 (katër vizë njëqind e tetëdhjetë dhe njëqind e tridhjetë e tre), zona kadastrale Komoran. Ndërsa pronat e tjera të ofrohen për biznese të interesuara. Në fund, edhe një herë, nëse nuk hiqen nga lista parcelat e lartshënuara, që ne konsiderojmë që është e nevojshme të mbeten për objekte publike, unë e konsideroj që duhet ta presim një vendim, ose thashë, të vendoset për pronat të cilat nuk i takojnë zonat urbane dhe numrat kadastrale që i përmenda. Nëse hiqen ngastrat kadastrale, jam i gatshëm që votën time ta jap në interes të zhvillimit ekonomik dhe të avancimit të pronave. Sa i përket kësaj pike, diçka se isha zgjatur, isha dalë pak, që kryetari i preku disa çështje shumë me rëndësi që më duket e arsyeshme në aspektin profesional, të jap një vlerësim sa i përket parcelës së Kuvendit Komunal. Arsyetimi të cilin e dha kryetari i komunës më duket se aty është një e metë e Drejtorisë së Urbanizimit, se paraprakisht është dashur edhe Kuvendi i kaluar, po edhe popullata të jenë të njoftuar që ajo pjesë apo parcelë e Kuvendit Komunal do të ndahet në dy pjesë me destinime të ndryshme: pjesa e cila është e destinuar për banim, që do t'u afrohet investitorëve, edhe pjesa e

cila është e destinuar për objekte administrative, që janë të obligueshëm investitorët ta ndërtojnë me mjetet e veta për interes të komunës.

Kështu që aty bëhet një ndarje edhe nga ai aspekti funksional, edhe destinimi për dy qëllime të caktuara. Kështu që, është e arsyeshme që ne ta përkrahim. Mua më vjen keq që jemi prej kuadrove të rralla që kemi punuar në sistemin në objekte investive, ku kemi marrë në shfrytëzim tokën e komunës. Rasti konkret është Komuna e Klinës, që janë konsultuar me ne disa kuadro, konkretisht me mua, kur Komuna e Klinës e ka ndërtuar objektin e komunës, ka dhënë pronat e komunës, po jo t'i përziejë destinimet. Unë jam që edhe në Drenas t'i japim pronat në shfrytëzim, po jo t'i përziejmë destinimet e objekteve administrative edhe objekteve ndërtimore të banimit kolektiv, se janë dy funksione që pengojnë njëra-tjetrën. Ndërsa sa i përket vërejtjeve që dolën nga kolegu, që ka ngushtim të rrugëve në planin rregullues prapa Shtëpisë së Shëndetit, unë e kisha propozuar që t'u iket këtyre dilemave: formohet një komision që, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe lejet përkatëse, të verifikohet se a janë përmbajtur kushtet urbane. Planin rregullues edhe urban janë formë ligji, që është e obligueshme për çdo Drejtor të Urbanizmit t'i përmbajë, edhe Drejtoria e Inspeksionit t'i përcjellë se a po u përmbahen ato kushteve në bazë të lejes të cilën e marr.

U diskutua edhe çështja e mbindërtimit, është konkretisht te Blloku 5. Mbindërtimet të cilat janë bërë në Bllokin 5, nuk e di a kanë pëlqim apo leje prej komunës, po janë mbindërtime të cilat e kanë rrezikuar strukturën e atij objekti. Gjithashtu, lokale afariste të cilat janë dhënë dhe shfrytëzohen në katin përdhës, që më së pari nuk kanë një të drejtë (kush i ka dhënë ato pëlqime, ose janë pa pëlqime), cenohet funksioni i një objekti banimor pa pëlqimin e banorëve; e dyta, ka rrezikuar stabilitetin e objektit. Blloku i Pestë është një objekt me sistemin ndërtimor sistem i përzier: mure mbajtëse edhe sistemi skeletor. Në katin përdhës, sa e kemi parë në vizualisht që i kemi vizituar ato lokale, është rrezikuar stabiliteti i objektit, se janë hequr muret mbajtëse, ndërsa ai objekt nuk ka strukturë të sistemit skeletor në tërë sipërfaqen bazë të objektit. Prandaj, unë i kisha kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit, për hir që ajo popullatë i takon komunës sonë, që mos ta presim derisa të ndodhë një tërmet dhe t'i rrezikojmë komplet ata banorë, po të kërkohej një kompani që ta bëjë vlerësimin e aspektit statik të atij objekti: a është përforcuar ashtu qysh kërkohej, apo është objekti statikisht i paqëndrueshëm. Këtë term sigurisht që profesionalistët e kuptojnë. Po edhe një herë po e përsëris: kisha kërkuar që të mbetet obligim i Drejtorisë së Urbanizmit, së bashku me drejtoritë tjera në ekzekutiv, që të bëhet një vlerësim statik i atij objekti, që mos ta presim deri te një rrezikim i banorëve që i kemi aty. Faleminderit të gjithëve për durimin.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, kërkon nga zyrtari i urbanizmit që të vendosë në monitor dy pronat e komunës të ish-stacioni i autobusëve. Si kjo pronë, që është pronë e komunës, që i është dhënë x pronarit për lirimin e rrugës që lidh QKMT-në prej objektit të Altradës (ish-Gërmia), ky na ka uzurpuar edhe dy ari vend. Pothuajse i njëjti pronar është Komuna ia ka dhënë këtë pronë pa qasje askund në rrugë, a dëni çka domethënë me dhënë kështu pronën. Unë e kam sjellë në këtë kuvend me votuar bashkim pronash si kjo pronë, sepse këtu s'ka asgjë të ndërtuar, me ardhë pothuajse në këtë formë edhe me marrë, me bërë një vend që me mund me ia lëshuar qasjen kësaj pronës në rrugë. Dikush e ka bërë me qëllim. Ne duhet me bërë bashkim prone dhe pastaj me ia dhënë dikujt në shfrytëzim. Kemi edhe pronën te Gjykata që është e uzurpuar, ku komuna e ka lejuar me ndërtuar objektet. Ne e kemi të drejtën me ia marrë këtë pronë, me e çuar në Ministri të Financave, me bërë vlerësimin e ndërtimit të pronës (sa i ka

kushtuar për metër katror) dhe këtë institucion me e kthyer në institucion tonë, siç është për shembull QPS-ja.

Vetëm t'u tregoj asambleistëve të mi se qysh u janë dhënë pamëshirshëm në rrugën "Ilaz Kodra", nëse dikush i ka pasur katër ari, ia ka bërë gjashtë e tridhjetë e pesë, gjashtëdhjetë e njëzet e pesë, nuk janë bërë bashkim pronash dhe nuk janë azhurnuar pronat ku s'ka pasë interes. Ju duhet me më mbështet me i ndjekur keqbërësit dhe uzurpatorët e pronës publike, sepse nuk ka të drejtë askush me shfrytëzuar pronën publike për interesa personale. Në qoftë se ka të drejtë dikush, kemi të drejtë ne me e shfrytëzuar për interesa të komunës. Eksperti ka aplikuar me 15%, e ka marrë Idrizi me 25%. Çka ka bërë eksperti. E paska rritur projektin pak Idrizi, pronë publike, në qoftë se e karritur, e s'e keni ndalur me kohë, aq sa e ka arritur përqindjen, aq e merr komuna. Dhe çka ka bërë eksperti? Ia ka lënë për 40 vjet. Pronë publike e ke dhënë dhe u detyrua njeriu me i dërguar në gjykatë. Kush ka humbur. Ka humbur komuna, ai, dhe kanë humbur të gjithë që nuk ia kanë dhënë me ndërtu eksperti Idrizit pronën në fjalë. Banesat në Poplek janë ndërtuar pa asnjë kriter, as kanë marrë pranimin teknik, as asgjë. 25% a 30% zyrtarë të komunës kanë marrë banesa, po ashtu edhe përfaqësues të shoqatave të dalura nga lufta. Dhe çka bënë? I kanë shitur pesë deri në dhjetë herë më shtrenjtë qytetarëve tanë dhe janë ikur prej aty, sepse as nuk kanë ujë as kanë send. Sepse, kur nuk është pranimi teknik, as unë s'kam të drejtë me ndërhyrë.

Liman Krasniqi, sa i përket objektit të Idrizit, unë kur kam qenë drejtor i Urbanizmit, nuk i kam lëshuar leje të ndërtimit, se e ka kaluar prej 56,4% planin në detaj të asaj kohe. Shkaku që nuk ka vepruar garnitura udhëheqëse e asaj kohe - as drejtoritë, as ekzekutivi, e as kryetari i komunës nuk ka marrë iniciativë - unë e kam lëshuar vendin e punës. Kur ka ardhur koha për t'u bërë pranimi teknik, i kanë bërë legalizim pa kurrfarë baze ligjore edhe e kanë pranuar teknikisht. Unë nuk i kam pranuar objektet teknikisht që s'kanë pasur leje ndërtimi. Mos më akuzo për gjërat tuaja, për atë i kam lëshuar vendet e punës.

Sa i përket Drenasit të Ri, në Drenasin e Ri unë nuk kam lëshuar leje ndërtimi, se i kam thënë kryetarit të atëhershëm: nuk ka bazë ekonomike edhe financiare Komuna e Drenasit që me krijuar një lagje të re, po vazhdojmë ndërtimin në lagjen ekzistuese. Pasi është koha e kufizuar - unë, sa i përket atyre dy parcelave në Komoran, qysh është duke i thënë kryetari, ne duhet t'i favorizojmë personat që kanë ndërtuar në mënyrë ilegale. Deri dje e kanë shfrytëzuar ilegalisht, sot ne me ia dhënë mundësinë që me e shpallë atë pronë. Ne duhet me pasë parasysh pronat që janë zona urbane, me i ruajtur për objekte me interes publik.

Shumë mirë thotë edhe ligji: pronat publike jepen për objekte publike. Duhet me pasë një park Komorani, duhet me pasë një stacion, një çerdhe.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, asnjëherë s'ke qenë në dëgjime publike kur është bërë Plani Zhvillimor, Harta Zonale. Në Komoran, po lyp gjelbërim, jemi duke e bërë me qeverinë çerdhen e re, është vonuar pak, qysh jemi vonuar edhe për shkollë. E kam pritur gjykatën me vjet me i rrëzuar objektet ilegale në pronë publike, s'fali për pronë publike. Në vendin e çerdhes së vjetër kam bërë gjelbërim në Komoran, duke përfshirë edhe gjelbërimin të pishat e Komoranit, që është një zonë e jashtëzakonshme.

Egzona Tërdevci, tha se i kam dy çështje. E para, po thoni që disa herë e keqinterpretuat ligjin, që afatin për me e marrë pronën e përcakton investitori. Nuk e përcakton afatin investitori, afati përcaktohet në ligj. E ke Nenin 6: afati i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të

komunës, pra, si komunë përcakton afat të shkurtër qysh po do me e dhënë. I përmend pronat në Gllobar qëllimisht, e kuptoj kështu natyrën pse po e bën këtë, në funksion të asaj që përmendën "dostat e SHIK-ut". I di edhe disa veprime që i ke bërë në 2022-tën, tek kojshitë e mi ke shkuar e ke thënë që me pas votuar Egzona kishin kaluar, po s'po voton Egzona. Keni ndenjur shumë me ata "dostat e SHIK-ut", i ke marrë metodat e tyre. Unë jam kjo që jam publikisht. Lëvizja Vetëvendosje i ka parimet e veta me e ruajtur pronën publike, votoj, sillem sipas parimeve të Vetëvendosjes.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se nuk është e vërtetë që i kam thënë kojshiut tënd. Të lutem mos i dezinformo qytetarët që unë kam thënë që s'po ia voton Egzona, se unë ia kisha dhënë. Unë jam këtu me i treguar qytetarit që kryetari, ekzekutivi, e ka kryer punën e vet, ia ka dhënë mundësinë Kuvendit me votuar për ose kundër për investime dhe për zhvillim. Kjo është e imja, vota është e juaja.

Driton Ajazi, në mbledhjen e kaluar, si erdhëm të pika e pronave, u çove, ece, se e ke ditur që s'i ke votat. E në këtë mbledhje, disa këtu i kanë ndërruar qëndrimet, u pa publikisht; tash i ke siguruar votat e po bën hajgare me neve. Këto punë dhe këto prapaskena të tua janë mësuar, se po bëhet viti i dhjetë që të kemi këtu, se t'i je specialist për krejt diçka tjetër, e thua këtu para publikut dhe qytetarëve, e krejt diçka tjetër punon në prapaskena.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se e dinë asamblistët e legjislaturës së kaluar që edhe kur nuk i kam pasur votat, unë kam qëndruar në mbledhje. Arsyeja pse kam lëshuar mbledhjen ka qenë një tjetër gjë që s'ia vlen me debatuar para mikrofonit. Unë qëndroj gjithë në mbledhje sepse marr pikë për grant të performancës.

Xhavit Drenori, dëshiroj që në fillim, për procesverbal, të sqaroj që ky është qëndrim i imi, respektivisht i "GREEN për Drenas" dhe jo i koalicionit, meqë me kolegët kemi qëndrim dhe vendim të paunifikuar për këtë çështje. Sot, në këtë pikë të rendit të ditës për miratimin paraprak të listës së dhënies së pronave komunale në shfrytëzim, dua ta filloj me një rikujtim të shkurtër për rolin tonë. Fjala jonë ka peshë. Qëndrimet tona kanë peshë. Por mbi të gjitha, vota jonë ka peshë. Ajo duhet të shprehë bindjen tonë të lirë, të bazuar në argumente faktike, në analiza të dokumentuara dhe në përgjegjësi institucionale – jo në fjalë kafesh, e as në diktate të grupeve të interesit që fatkeqësisht i kemi njohur nga e kaluara e hidhur qeverisëse.

Unë vendimet e mia në këtë kuvend i marr duke u bazuar plotësisht në hulumtim të fakteve, në analiza të materialeve dhe në shqyrtim të gjendjes faktike.

Kështu kam vepruar edhe në mbledhjen e kaluar, kur votova kundër për këtë pikë.

Kërkova informacione shtesë, ngrita shqetësimin tim për kohëzgjatjen 99-vjeçare të kontratave, sepse për mua ajo ishte e pakalucshme (e gjeni në procesverbal).

E kam thënë dhe po e përsëris: ne nuk guxojmë t'i lëmë barrë gjeneratës që vjen pas nesh ndonjë biznes që nesër nuk e zhvillon veprimtarinë si duhet.

Kontratat duhet të kenë një kohë optimale, të arsyeshme dhe të kontrollueshme.

Nga ajo mbledhje e deri dje, kur u njoftuam për ndryshimet në propozim-vendim, përfshirë edhe diskutimin dhe vendimin në Komitetin për Politikë dhe Financa, për mendimin tim ka pasur ndryshime substanciale.

Tani fazat e dhënies së pronave janë të strukturuar në mënyrë që, varësisht nga veprimtaria dhe zhvillimi i saj, koha e shfrytëzimit mund të përcaktohet me maturi.

Pra, ne – si Kuvend Komunal – me votën tonë dhe me bindjen tonë, e ruajmë kontrollin përfundimtar. Në anën tjetër, kam hulumtuar praktikat e komunave të tjera dhe kam kontaktuar personalisht për t'u informuar. Çdo komunë në këtë fazë e miraton këtë listë paraprake, sepse është pjesë edhe e Grantit të Performancës, grant nga i cili komuna jonë ka përfituar miliona euro për investime kapitale.

Nuk po flasim për dhënie përfundimtare sot.

Po flasim për një listë paraprake që hap mundësi për biznese vendore dhe ndërkombëtare të investojnë në komunën tonë.

Kjo nënkupton vende punë për të rinjtë tanë, që të mos detyrohen të largohen drejt Fushë Kosovës, Prishtinës apo – më e keqja – jashtë vendit.

Kjo nënkupton më shumë të hyra për komunën përmes taksave dhe zhvillim ekonomik real. Gjatë kësaj kohe kam mbledhur informacione të hollësishme edhe për procedurat konkrete të dhënies së pronave.

Jam bindur se procedura është plotësisht e monitorueshme dhe e kontrollueshme nga asambleja nëse kemi vullnet dhe kohë për ta bërë këtë.

Dhe mos ta harrojmë: për secilën pronë që do të jepet në shfrytëzim, vendimi përfundimtar do të vijë për votim në këtë kuvend.

Aty është përgjegjësia jonë e madhe – për të parandaluar çdo favorizim të mundshëm dhe çdo devijim nga interesi i përbashkët.

Të nderuar kolegë,

Pas gjithë këtyre argumenteve, një qëndrim kategorik kundër në këtë fazë, për mua, më shumë i ngjan bllokadë dhe paragjykim sesa një argumenti të fortë që dëshmon se kjo nuk është në interes të qytetarëve.

Puna jonë nuk është vetëm vendimmarja, por edhe kontrolli.

Dhe për kontroll kemi dy rrugë: ose përfshihemi drejtpërdrejt në komisione, analizojmë dokumente dhe mbikëqyrim procedura; ose mbështetemi në fjalë kafesh dhe në diktate të grupeve që i njohim mirë si kanë qeverisur kur kanë qenë në pushtet.

Sa ti përket “shesave” apo “bosave”, dua të jem shumë i qartë: jam nga më të liruarit prej tyre.

Për vendime të caktuara konsultohem me njohës të fushës, debatoj dhe koordinohem me kolegët time Egzonën, me të cilën jemi në koalicion, dhe të cilën e falënderoj për bashkëpunimin e sinqerë dhe debatin e strukturuar e të bazuar në fakte.

Por kur vjen momenti i votimit, secili prej nesh ruan autonominë e plotë, duke e argumentuar qëndrimin e vet.

Dhe në fund, e falënderoj Artianin që përmes portalit apo sajtit të tij po mundohet t'i ndajë asamblistët në “të shitur” dhe “të mirë”, duke e vendosur natyrisht votën në krahun e të mirëve – pa i analizuar dhe prezantuar argumentet.

Unë besoj se qytetarët tanë meritojnë debat me argumente, jo etiketime. Meritojnë transparencë, jo gjykime të njëanshme.

Prandaj, sot, me përgjegjësi të plotë dhe me bindje të bazuar në fakte, unë e mbështes këtë listë paraprake – jo si akt formal, por si hap drejt zhvillimit ekonomik, punësimit dhe forcimit të rolit tonë si institucion që vendos dhe kontrollon në emër të qytetarëve. Paleminderit.

Mchedin Salihu, shyqyr që s'kemi seanca tjetër me pikë të njëjtë, se apër kishim me parë ndryshime të mendimeve. Ajo është dhe mbetet personale. Një pyetje desha për kryetarin, kur i përmendi pronat në emër të invalidëve dhe të veteranëve, ata nuk janë pajisur me leje për

shfrytëzim, e para. E dyta, ju kërkoj falje qytetarëve se i kemi lodhur që pesë vjet me këtë çështje të pronave, që katër orë jemi duke e diskutuar të njëjtën pikë.

Ne e kemi rastin hala njerëzit nuk po mundem me shkuar në Krajkovë në shtëpi të veta, e plot fshatra nuk po mundem me shkuar nëpër shtëpi. S'po merrem me ndonjë problem që mundemi me e kryer, po me këtë çështje u stërzgjat. Ose drejtoreshën atje, përpara Shtëpisë së Shëndetit e kemi situatën katrahurë të vërtetë. Pronat në emër të invalidëve dhe veteranëve janë pajisur, ata paguajnë tatim, por nuk janë pajisur me leje për shfrytëzim. Këtë e kisha pyetje. Edhe mos na ndani: jeni pro, jeni pengesë, s'jeni pengesë. Ne jemi për zhvillim prej ditës së parë. Duel fjalët e mia, kryetar, i kam kallëzuar, nuk është fer, i sjell njëzet e shtatë prona përnjëherë. Po i bini nga 2-3, i shqyrtojmë. Nuk jemi kundër askujt, po t'i shqyrtojmë, jo ashtu blanko. Plot prona janë duke vuajtur për shkak të disa pronave të tjera. Kaq kisha. Faleminderit.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha, unë jam i detyruar me i sjellë pronat, a janë 25, a kanë mund me qenë 50, 15 janë afate ligjore, se nuk ka tjera afate ligjore që është dashur me i përmbushur, për me mund me përmbushur edhe një kusht, një kusht me marrë ndonjë pikë të granti i performancës.

Zeqir Hasi, faleminderit kryesues. U diskutuan gjërë gjatë edhe u bë shumë mirë që u diskutua kaq gjatë për të gjithë qytetarët e Drenasit, sepse është krijuar një mjegull e madhe për këtë pikë nga qytetarët e Drenasit, duke thënë të gjithë se sot në këtë mbledhje po jepen të gjitha pronat e komunës. Edhe duhet sqaruar të gjithë qytetarët që sot nuk po jepet asnjë pronë, sot nuk po votohet asnjë pronë për t'iu dhënë asnjë personi juridik apo fizik. Sot e kemi një listë preliminare e cila do të jetë në dispozicion, më pastaj të shohim se çka do të rrjedhë në vitin dy mijë e njëzet e katër, unë e kam votuar këtë listë preliminare, nuk është procesuar asnjë pronë dhe nuk është dhënë asnjë pronë, nuk e di a për shkak të mungesës së ofertave apo nuk ka pasur afate ligjore. Unë mendoj që do t'i hapim rrugë listës preliminare, edhe ashtu jam interesuar diku në 10-15 komuna. Personalisht, jam interesuar, të gjitha komunat i kanë kaluar listat preliminare të pronave për shfrytëzim.

Pastaj kjo mundësia e formimit të komisionit, unë e falënderoj kryetarin që në fund e tha edhe po i heq asamblistët e mi, po i heq krejt me qëllim që të përfshihet krejt komisioni pa qenë kandidatë të asamblesë komunale apo të kryetarit, që të shqyrtojnë të gjitha ofertat. Pra është korrektësi. E tha kryesuesi që neve na takojnë dy. Unë e kam pasur edhe ashtu publikisht për të kërkuar që ne si grup parlamentar t'i kemi në atë komision dy, sepse do të jemi më korrektë për të gjitha informacionet dhe të gjitha kërkesat. U diskutua për afatet e pronave në 99 vjet. Ka prona që edhe unë e ne nuk pajtohemi që të jepen për 99 vjet, por nëse s'ka ofertë për 15 ose 20 vjet e ka ofertë për 80 vjet, atëherë duhet ta japësh atë ofertë. U diskutua edhe të qiratë e lira; pajtohem me kolegen plotësisht që në mandatin e kaluar nuk kemi dhënë asnjë pronë. Ju i keni dhënë para tetë viteve, kur i keni dhënë me qira të lirë, por të ne nuk do të thotë që do të bëjmë të njëjtin gabim edhe t'i japim me qira të lira. Ne këtu do të vijmë, do të shqyrtojmë të shohim se çka ka ofruar secila kërkesë edhe atëherë e diskutojmë në këtë kuvend se a ia vlen për atë qira të jepet ajo parcelë apo jo.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, edhe një herë po jua shpjegoj, janë edhe një varg procedurash deri të votimi përfundimtar për dhënien në shfrytëzim pra është një procedurë me ndarë listën, ose me e dërgu komplet, ose me i dërgu 5-10-12 prona, konkurron dikush, konkurron, s'konkurron, s'ka interes kurrëgjë kërkujt, kemi prona, tjera që ka interes që keni me i shqyrtu, uluni në komision, shkoni në negociatë, duhet me e bërë zyrtarisht një procesverbal mbi bazën e atyre që ju negociatë, unë e bëj procesin edhe jua sjelli po problemi

është që me lëviz, me i lanë të gjitha mundësit po ju a japi në dorë, para se me shku në votim, a po doni me bërë komision për me e filtru këtë listë prej 25, me përcaktu sa prona a s'po doni po ma leni, unë me hap e kush aplikon, aplikon, kush s'aplikon, s'aplikon.

Mërgim Pirraku, pothuajse debati u konsumua edhe shpjegimet e detajuara të kryetarit na ndihmuan shumë. Unë, për hir të transparencës, po dua para publikut me paraqitë qëndrimin tim, jo veç me votë, po edhe me një fjalim të shkurtër këtu. Sigurisht që unë jam pro zhvillimit ekonomik dhe jam për investime në komunë, mirëpo unë mendoj edhe kërkoj me ma respektu mendimin; siguroni që ua respektoj secilit. Pra, unë e respektoj secilin mendim, qoftë Drenori, ose ai tjetri që voton pro, edhe asnjëherë nuk më keni dëgjuar, edhe as nuk keni me më dëgjuar, që unë e paragjykoj në pazare ose ku ta di unë. Kështu që edhe unë kërkoj me më respektu edhe mos me më quajtë bllokues ose diçka, dhe pse mua s'më quajte, po na quajte neve, kështu që kërkoj me na respektu mendimin secili secilit këtu. Pra, unë jam pro zhvillimit ekonomik edhe jam për investime në komunë, mirëpo bindjet e mia politike më thonë që prona publike është e shenjtë, edhe unë konsideroj që është gabim i rëndë me dhanë për investime, qoftë biznesore ose diçka tjetër.

Unë e di që me këto investime ndoshta mundemi me fitu një përqindje, mirëpo unë konsideroj që është pak e padrejtë për gjeneratat e ardhshme ne me marrë vendime afatgjata. Edhe pse u sqarua prej kryetarit, unë e kuptova shumë mirë që ajo mundet me qenë prej 15 deri 99 vjet edhe mundet komisioni në vazhdim me vendos, mirëpo pronat publike – unë pajtohem njëqind për qind me Limanin – janë prona të shenjta edhe duhet me u shfrytëzuar për shkolla, çerdhe, qoftë spitale e të tjera. Edhe unë e konsideroj që është e rëndësishme ne me formu një komision me u bërë vlerësimi i secilës pronë që e kemi në emër të komunës edhe të filtrohen, të klasifikohen realisht pronat edhe të sjellen në një seancë tjetër, nëse nuk mundemi me marrë vendim këtu. Pra, unë nuk guxoj me i dhanë vetes të drejtë me çu dorën këtu pro, nëse këtu pronat janë bashkë. Kjo nuk do të thotë që unë e akuzoj kryetarin, as ndonjërin prej juve, por ky është mendimi im dhe faleminderit për mirëkuptimin.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, të gjithë e dimë që prona publike dhe private janë të shenjta, mos mbani ders. Pa asnjë fakt, pa asnjë argument, bllokuese ka qenë asambleja e kaluar, mund të rrëshqasë në atë gjë edhe kjo asamble.

Nuk mundemi edhe s'ju lë adut më me provuar me mashtruar qytetarin. Po them, edhe grupi im mos të marrë pjesë në komision, merreni listën, shqyrtojeni, thoni: "asnjë pronë nuk i plotëson kushtet, asnjë pronë". E lamë, thoni: "i plotësojnë pesë", pesë i sjellim. Po mua me ma lënë fajin, ose sherrin, nuk lejoj.

Egzona Tërdevci, veç të pjesa e komisionit, se pjesa tjetër besoj secili i bënë më të qarta qëndrimet e s'ka kuptim me u rikthyer në diskutime më. Në vendimin që e kemi marrë si Kuvend Komunal më 19 shtator të vitit 2024, kur është miratuar lista paraprake, MAPL kur e ka kthyer ligjshmërinë, e ka kthyer që për secilën pronë duhet me u bërë komision i veçantë. Pra, nisur nga ai precedent, besoj që prapë është e njëjta, për secilën pronë nga këto njëzet e pesë prona do të ketë komision të veçantë. Kështu është vendimi i MAPL-së që na ka kthyer herën e fundit në shtator 2024. Prandaj, nuk është se ju po na ofroni mundësinë me pas komision, ligji e kërkon për secilën pronë me pas komision të veçantë, e në ato pa dyshim që përfshihemi edhe ne.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, asnjë komision me ligj për dhënie të pronave, ti s'ke të drejtë kur do ti. Po flas për krejt që ta keni të qartë, është tjetër komision ai. Komisioni kur të vijë vlerësimet, kur të vijë ato, është tjetër. Unë po flas diçka tjetër, ndoshta s'po kuptohet, se njeriu kur të bllokohet s'do me kuptuar. Unë po kërkoj që atë komision me e

bërë, që s'kemi nevojë me e dërguar në MAPL. MAPL-ja thotë s'ka nevojë me bërë komision sepse e ka ligjin kryetari dhe asambleja edhe ju thonë që s'na pranoi. Ne kemi të drejtë me marrë vendime, për me rritë transparencën, bëjeni komisionin, uluni shqyrtoni secilën pronë veç e veç, sillni në kuvend edhe kaq.

Xhavit Drenori, fjalimndorit shumë kryesues. Dua veç të citoj saktësisht çka kam thënë, sepse kolegu e mori që e kam quajtur bllokues. Jo, mendësia është bllokuese nga ana ime, sepse ky fjalim është imi, për veten time e kam shkruar. Nëse në këtë fazë, duke i pasur të gjitha këto argumente, unë i them veç "jo" kësaj pune, unë nuk të quaj bllokues ty, se është e drejta jote më elementare e demokracisë në këtë kuvend ti me dhënë mendimin. E shpresoj që është mendimi yt. Bile ti ndoshta pak mendojë, por shumë fatkeqësisht nuk besoj që kanë mendim të votin, se s'guxojnë me pasë mendim të votin, kjo është fatkeqësia e parë.

E dyta, unë subjektit politik prej fillimit e dini që e kam "GREEN PËR DRENAS" në koalicion me Vetëvendosjen, për që jam shumë i lumtur sepse po funksionojmë jashtëzakonisht mirë. Ka vendime të caktuara që mund të kenë mendim ndryshe. Përndryshe, katër vjet që e bllokojmë këtë, ne po i bllokojmë qytetarët tanë. Nëse doni me bllokuar Ramiz Lladrovcin e jo qytetarët, hajde mbledhim nënshkrimet, e qesim në referendum. Komunitat e Mitrovicës së Veriut na kanë hapur mundësinë, e qesim, e rrëzojmë, dalim në zgjedhje. I thojmë qytetarëve. Këto 27 prona janë mullë shërr, a po e doni këtë kryetar, a po e rrëzojmë. Le ta rrëzojmë, votën time e ke, e ke nënshkrimin tim. Mbledhi, jo prej kafeve me ardhur, së kështu nuk shkon.

Arbër Halilaj, unë në fakt dua veç me u ndërlidhur me këtë çështjen e komisioneve. Për arsye të sqarimit, sa e kuptova, komisioni që po propozohet me qenë në përbërje të gjitha subjekteve politike është një komision më shumë rekomandues e këshillëdhënës, sepse neni 17 i ligjit që e cekëm, 06/L-092, e kërkon një komision të veçantë vlerësues, ku natyrisht edhe Kuvendi Komunal do të ketë prezencën e vet, po ai komision i ka vetëm pesë anëtarë. Gjithashtu do të duhet me u formuar edhe një komision tjetër që e përcakton neni 18, komisioni i ankesave. Mirëpo, po mendoj që për shkak të transparencës edhe bashkëpjesëmarrjes së të gjithëve, u propozua që të jetë një komision i cili do të japë rekomandime e sugjerime rreth pronave të cilat do të jenë në listë në shpallje publike. Kështu që është vetëm një komision që jep rekomandime.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovi, Arbër, saktë e ke thënë. Unë po e kërkoj për shkak të transparencës. Komisioni e vlerëson, një komision që ose doni me e vënë, komisioni për vlerësim të ofertave, është tjetër gjë. Ashtu si po thua ti, është obligim ligjor në bazë të neneve që i ceken më lart. Unë ju thërras me e votuar listën paraprake, me hap rrugë, pastaj vendosni vetë a po doni një komision me bërë me i vlerësuar, apo ia lini ligjit qysh i thotë kësaj punë.

Liman Krasniqi, a bën një kërkesë. Nëse duam komision, duhet ta formojmë tani për ta specifikuar atë listë, se cilat prona.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovi, ju po mundoheni ta keqpërdorni mirësinë ose transparencën time. Unë po them, merreni listën, ndajeni ndonjë pronë që doni me e shpallë, ose asnjë mos ma bëni.

Zeqir Hasi, veç të pjesa e komisionit që e thanë, lejohet me pas edhe një komision të tretë përveç komisionit vlerësues edhe atij të ankesave – një komision për vëzhgimin e implementimit të projekteve në fund. Për këto katër vjet sa jemi ne, ta kemi edhe një komision që të vëzhgojmë implementimin e projekteve dhe afatet ligjore që kanë për të investuar ata, nëse lejohet ligjërisht. Po, nëse po duan korrektësi edhe me shikuar se a po shkon gjithçka në rregull, nëse e lejon ligji,

thashë për shembull edhe një komision të tillë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se është zyrtari komunal për prona, i certifikuar, që i përcjell të gjitha këto. Unë edhe publikisht i kam thirrur të gjitha mediat, sa herë që kam komisione për rekrutim të stafit, me i përcjellë, sepse jam i interesuar me u bërë më c mira.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën (7): Propozim-vendim për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Gllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik-juridik (deri në 99 vite).

Për votuan 15, Kundër 12, Abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën "I të ndryshme".

Arbër Halilaj, në fakt, unë dua ta përafraoj, ashtu më shkurtimisht për shkak të kohës për mos me marrë kohë, një e-mail që më ka ardhur nga një qytetar. Natyrisht emra këtu s'do të përmend, sepse do ta përcjell (forward) edhe të drejtoria përkatëse, mirëpo më shkruan si një lloj raportimi i një rasti korrupsioni, siç e quan ky, në QKMF. Prandaj, kisha dashur që Drejtoria e Shëndetësisë të merret me këtë rast dhe të më japë sqarime. Këtu bëhet ljalë, do të thotë, për një çështje sa i përket koeficientit të pagës së punëtorëve shëndetësorë, ku qytetari thotë që është bërë në kundërshtim me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Natyrisht, nuk i përmend emrat e të punësuarve që parafrazohen këtu, mirëpo çështja është se ai pretendon që të apostrofuarit të jenë emëruar dhe ngritur në pozita pa konkurs, si dhe koeficienti i pagës nuk është në përputhje me dispozitat ligjore të këtij ligji. Vetëm për transparencë ndaj qytetarit e proklamova këtu direkt.

Luljeta Elshani, i nderuar kryesues, kryetar i komunës, të nderuar kolegë të asamblesë, të nderuar të pranishëm. Dua të ngre një shqetësim të qytetarëve të Drenasit, përkatësisht të bashkëvendësve të mi të fshatit Krajkovë, sepse dimë që, si pasojë e vërshimeve të fundit, ura që ndodhet në rrugën Drenas – Shtrubullovë – Krajkovë është e dëmtuar totalisht. Për këtë çështje, Komuna e Drenasit ka dalë me një njoftim publik se do të ndërmarë masa për rregullimin e saj, mirëpo edhe pas gati dy muajsh nuk është ndërmarë asnjë veprim konkret. Prandaj, i nderuar kryetar, duhet të keni parasysh që kjo urë kërkon intervenim emergjent, pasi që është e pakalueshme për automjete dhe paraqet rrezik serioz edhe për këmbësorët.

Në këtë rast duhet të bëni veprime emergjente, sepse edhe rrugët alternative të cilat i përdorin nuk janë aspak në gjendje të mirë. Edhe pse është bërë thirrje që të mos përdoret kjo rrugë për qarkullim, ajo rrugë përsëri përdoret nga nxënësit dhe qytetarët me këmbë, pasi që nuk kanë një opsion të dytë të kalueshëm afër saj, duke rrezikuar drejtpërdrejt jetën dhe sigurinë e tyre. Prandaj, kjo situatë është e papranueshme dhe kërkon veprim urgjent nga institucionet përgjegjëse, sepse siguria e qytetarëve dhe e nxënësve është dhe duhet të jetë prioritet. Kërkojmë që sa më parë të ndërmerren masa konkrete për rindërtimin e urës, si një nga pikat kyçe që i lidh këto fshatra me qytetin e Drenasit, pasi që urgjenca kërkon veprim dhe trajtim me prioritet.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se këtë shqetësim e kanë ngritur edhe asamblistë të tjerë edhe shumë qytetarë. Ju e dini që buxheti është votuar para katër-pesë dite dhe i cili akoma nuk e ka marrë nënshkrimin e Presidentes. Për dëmet të cilat vijnë nga natyra, ne

nuk kemi buxhet të ndarë. I kam dy rrugë, e kemi urën të Qendra Sociale atje, që është e kalucshme pavarësisht që ka vështirësi, ose me i kërkuar FSK-së dhe KFOR-it me vendosur një urë metalike. Mirëpo, në momentin që ajo vendoset, as Qeveria nuk na shih më dhe kemi me pritur me ndarë buxhet. Qeveria si në rastet për katastrofa e për vërshime, sepse vërshimet e kanë dëmtuar. Neve na duhet ose me i pasur mjetet, ose vetë Qeveria me i ndarë mjetet e me ardhur me ndërtuar urën e re. Unë buxhet as nuk kam, as nuk mund të ndaj për momentin.

Pajtime Berisha, unë këtë çështje e kam potencuar edhe një herë në Komitetin për Politikë dhe Financa, por sot dua ta drejtoj para Kuvendit Komunal për gjendjen e varrezave në fshatin Poklek dhe Vasilevë. Gjendja në këto dy lokacione është shqetësuese për qytetarët tanë. Varrezat janë pa rrethoja adekuatë, çfarë i lë të pambrojtura dhe krijon një pamje që nuk i ka hije një vendi të shenjtë. Rruga që çon të varrezat është e vështirë për t'u kaluar, sidomos gjatë stinës me reshje, familjarët përballen me baltë, vështirësi në qasje dhe kushte jo të përshtatshme sa herë që shkojnë për t'i vizituar më të dashurit e tyre. Për më tepër, përreth varrezave ka deponi ilegale të mbeturinave, gjë që e rëndon edhe më shumë situatën. Kjo është e papranueshme, nuk mund të lejojmë që një vend i shenjtë të shndërrohet në zonë të ndotur dhe pa kontroll. Prandaj, kërkoj nga ekzekutivi komunal të planifikohen dhe realizohen sa më shpejt, rrethimi i varrezave në Poklek të Ri dhe Vasilevë, të intervenohet në rregullimin e rrugëve që çojnë deri këtu, të pastrohen deponitë ilegale dhe të vendosen masa parandaluese që të mos krijohen sërisht. Kjo nuk është çështje politike, është çështje respekti ndaj qytetarëve dhe ndaj atyre që nuk janë më në mes nesh. Të nderuar kolegë, në vazhden e këtyre shqetësimeve dua të shtoj edhe një çështje tjetër të rëndësishme që lidhet me sigurinë e nxënësve, bëhet fjalë për mungesën e trotuareve. Nga fshati Poklek i Vjetër të shkolla fillore "Fazli Grajçevci" nuk ka trotuar funksional.

Nga lagjet e Vasilevës deri të kjo e njëjta shkollë, nxënësit detyrohen të ecin buzë rrugëve. Gjatë dimrit dhe reshjeve, qarkullimi bëhet edhe më i rrezikshëm. Kjo situatë i ekspozon fëmijët ndaj rrezikut të përditshëm. Nxënësit nuk duhet të shkojnë në shkollë me frikën nga automjetet apo kushtet e rrugës. Siguria e tyre është prioritet absolut për komunën, prandaj kërkoj, projektimin dhe ndërtimin urgjent të trotuareve në këto segmente, vendosjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal pranë shkollës, si dhe përfshirjen e këtyre prioritetëve në planifikimin buxhetor. Nëse flasim për zhvillim dhe mirëqenie, duhet të fillojmë nga gjërat bazike: respekti për varrezat, infrastruktura funksionale dhe siguria për fëmijët tanë. Këto nuk janë kërkesa politike, janë kërkesa legjitime të banorëve të Poklekut dhe të Vasilevës; të veprojmë me përgjegjësi dhe dinjitet.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, kur flet për dinjitet, thuhet që këtë çështje e kam ngritur edhe në Komitet për Politikë e Financa dhe kam marrë përgjigje prej kryetarit.

Thuhet të paktën, që të dëgjojë qytetari, sepse të kam dhënë përgjigje. A kanë nevojë varrezat në Poklek të Ri me u thurur. Kanë nevojë. A ka nevojë për kulturë më të lartë të qytetarëve tanë.

Pardje s'ka pasur, dhe e ke rrugën të mbushur me mbeturina.

Unë rojtar për gjithëka nuk mundem me u bërë. Pra, të kemi thënë bashkë me z. Gruda, Komuna e Drenasit i ka paraparë 20 mijë euro për rrethimin e varrezave të qytetarëve tanë në komunën tonë. Paramasa të ato varreza është shumë herë më e lartë dhe do të shohim mundësinë se çka do të bëjmë, sepse kjo nuk është veç kërkesë juaja, por ka qenë qëllim edhe ide e mendimit toni, sepse edhe unë i kam të afërmit e mi të varrosur aty. Sa i përket tabelave për shkollë e sinjalistikës, dhe për këtë temë të kam dhënë përgjigje. Të kam dhënë të drejtë dhe mirë po bëni

që po e ngritni, veç thuaj që e kemi diskutuar edhe me kryetarin në Komitet për Politikë e Financa.

Pajtime Berisha, më falni, por unë e potencova edhe në fillim që këtë çështje e kam ngritur në Komitetin për Politikë dhe Financa. Megjithatë, dua të ngris edhe një herë këtu para Kuvendit. Për këtë arsye, nuk e mohova që e keni marrë si këshillë apo që e keni pranuar, por insistova për shkak të rëndësisë që ka.

Xhavit Drenori, në fakt, pyetjen time e bëri kolegja më herët, por unë po e specifikoj sepse Kryetari dha tri alternativa për urën, por nuk dha afate kohore. Kur, qysh, sado me e pritë Qeverinë. Sepse alternativa e tretë është shumë zor, sepse duhet me pritë një vit për me u bërë buxheti, ose me e rishikuar buxhetin. Sa është koha, z. Kryetar. Jam duke e incizuar këtë pjesë me ua dërguar qytetarëve, se po mendoj që kam ndonjëfarë fuqie dhe me ju treguar që më shumë se me e ngritur nuk kam. Kam ardhur edhe lart me bisoduar me Endritin, ke qenë edhe t'i, je munduar me ma shpjeguar. Unë tash i di këto tri alternativa dhe e di që duhet me e pritë alternativën e parë. Qeverinë. Sa duhet me e pritë Qeverinë. A lëshon buxhet për atë urë, apo me shku me alternativën e dytë, që është FSK-ja dhe KFOR-i, që unë besoj që shumë shpejt e kryejnë atë punë. Ideja është ata njerëz me i pajisë me një urë në të cilën mund me qarkulluar. Këtë alternativën e tretë, ajo alternativë edhe ju e dini që shumë gjatë zgjat për me mund me buxhet tonin me e bërë atë urë. Dhe në qoftë se presin me alternativën e tretë, ata qytetarët me të vërtetë kanë mbet keq dhe kanë me mbet keq. Prandaj, afate ligjore a ke, ose afate të cilat ti mendon si ekzekutiv, si Kryetar. Me thënë. Unë e pres Qeverinë deri në këtë datë, pas kësaj date e bëj këtë, sepse qytetarët me të drejtë duan me i ditë pak ca sende, jo veç fjalët kështu në hava (në ajër).

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, Komuna s'ka buxhet për atë punë. E kemi shpjeguar, buxhetin që kemi për ura e turbina në Komunën e Drenasit është aq i vogël sa është i papërfillshëm. Ju e dini që ne duhet ta zgjidhim atë urë njëherë e përgjithmonë. E kemi rregullimin e shtratit, e kemi vendosjen e kolektorit, i cili na ka mbetur për shkak të asaj pjese që e ka bërë Qeveria e nuk e ka kryer krejt dhe e kemi edhe zgjerimin e rrugës. Qëllimi është që të paktën ta bëjmë një punë të mirë, sepse çdo variant lidhet me tjetrin. Pse është aq me ngut me thënë. Zgjidhni më shpejt, na e vendosni urën e FSK-së dhe të KFOR-it. Në rast se na e japin ata, kur të vendoset ajo urë, ne prapë nuk mundemi as ta rregullojmë shtratin e lumit, as kanalim e kolektorit, e as nuk mundemi t'i nisim bazat e urës së re. Prapë duhet me e hequr, prapë duhet prej fillimit. Kur vetëm 300 deri në 400 metra më lart e kemi urën tjetër, nuk është bllokuar askush në këtë botë. A është ruga për çdo ditë nga 600 deri në 1200 metra më e gjatë me automjet. Po, është. Por ne kemi telashe më të mëdha për të zgjidhur aty, sepse prona për ta zgjeruar urën është e paazhmuar dhe e parregulluar.

Egzona Tëredvci, unë i kam tri çështje. Nëse mundem t'i flas të trijat, e pastaj t'i marrim përgjigjet, nëse është në rregull për juve.

E para: Ka të bëjë me çështjen e çerdhes në Arllat. Kam parë që deri sot ka qenë i hapur konkursi për pranimin e fëmijëve. Është adaptimi i objektit që u mbështet nga Ministria e Arsimit. Kur ka me u hapur çerdhja. Sepse konkurs për staf nuk kam parë, përveç një mbështetësi teknik. Për këtë nuk e kam të qartë se kur ka me u hapur.

E dyta: Kryetar, në disa prej komunave është duke u bërë një iniciativë për mbështetje të njëhershme për fëmijët me Sindromën Down. Domethënë, është një mbështetje që u bëhet vetëm një herë. Më 21 mars është dita që shënohet për fëmijët me Sindromën Down. E kam të qartë që

buxheti është i kufizuar, por a kemi hapësirë si mundësi që ta bëjmë këtë mbështetje të njëhershme për muajin mars. Komunitat e tjera po e bëjnë, është shembull i mirë, pse mos ta bëjmë edhe në Drenas, gjithmonë nëse është e mundur sipas buxhetit.

E treta: Është çështja që na brenjos secilin prej nesh, u përmend edhe nga ju më herët, çështja e pastrimit. Po nisem prej fshatit tim, prej shtëpisë sime. Janë bërë më shumë se dy javë që kompania 'Pastrimi' nuk i mbledh mbeturinat dhe me të vërtetë po na shkakton problem secilit. E di që e kemi adresuar, por cilët janë hapat tash e tutje. Çka konkretisht ka me u bërë për këtë pjesë. Besoj se jeni zero-një me komunitat e tjera, por a ka ndonjë plan afatshkurtër se cila është mënyra për të dalë nga kjo situatë. Më erdhi keq edhe për videon që e pashë, por i kam parë edhe me sytë e mi duke punuar me traktor. Më vjen keq për kushtet e këqija në të cilat punojnë ata, megjithatë, secili qytetar që paguan për shërbime meriton të marrë shërbim cilësor. Nuk e di nëse lejohet ligjërisht, por a ka ndonjë hapësirë që 'EKO DRENASI' ta shtojë si përgjegjësi edhe pjesën e mbeturinave. Kështu do ta kontrollojmë dhe menaxhohim vetë, dhe besoj shumë më mirë sesa po bën kompania 'Pastrimi'."

Kryetari i Komunitës së Drenasit, Ramiz Lladrovi, tha se për çerdhen në Arllat. Neve si komunitet na e kanë zvogëluar numrin e mësimdhënësve dhe edukatorëve për shkak të numrit të banorëve dhe nxënësve, me sa jam i informuar. Konkurs për mësimdhënës nuk besoj se do të ketë, sepse vendet duhet t'u jepen mësimdhënësve që janë tashmë në proces dhe janë të pranuar si të përhershëm. Kurse për konkursin për dy pastrues dhe dy punëtorë teknikë, u ngrit në këmbë i gjithë Drenasi. Na thonë: 'Mos hapni vende pune, mos u jepni pronë', por njerëzit kanë nevojë me punuar. Për fëmijët me Sindromën Down. Lidhur me pagesën e njëhershme, nuk e di saktësisht a mundemi ta japim tani, pasi nuk është këtu Zyrtari Kryesor Financiar. Ne i kemi të parashikuara mjetet që hyjnë në tremujorin e parë dhe të dytë. Megjithatë, nëse të gjitha komunitat e Kosovës e kanë bërë dhe ne do të provojmë ta bëjmë.

Për 'Pastrimin' dhe 'Eko Drenasi'. Procedurat për krijimin e ndërmarrjes po ecin gradualisht. Ajo ndërmarrje do të ketë obligim edhe pastrimin. Ju e dini që ne gjithë infrastrukturën e tyre, kapacitetet dhe kamionët ua kemi krijuar kompanisë ('Pastrimi'), e cila financat i dërgon në nivel rajonal dhe nuk investon kurrë në Drenas. Ne jemi munduar t'u krijojmë kushte, ata i marrin pagesat, por vijnë ose s'vijnë t'i marrin mbeturinat sipas mundësive të mjeteve që kanë. Nuk do të kisha reaguar për atë traktorin, por ju nuk e kemi idenë sa qytetari më ka sharë! Më thoshin. 'Si nuk të vjen marre, traktor në kohën e 'Alibungit' (kohë e vjetër)'. Unë kam qenë me të gjithë kryetarët e komunitave, kam vizituar depo dhe institucione të pastrimit në botë, përfshirë Lubjanën e Stambollin. Çdo kompani ka edhe traktorë, ato janë për mbetjet e forta që nxjerrin njerëzit, si: kolltukë, shporetat e të tjerë, që nuk mund të futen në mullirin e kamionit. Por, punonjësit kanë bërë gabim që i kanë dhënë traktorit në rrugë me gomë të prishur e të shpërthyer, duke dëmtuar edhe bandazhin. I kanë rritur shpenzimet, kanë dhënë imazh të keq, por mbi të gjitha kanë rrezikuar komunikacionin. E kam gati kërkesën për padi në polici që të merren masa ndaj zyrtarëve, sepse zyrtari duhet të jetë aty e jo të rrezikojë jetën e askujt. Ajo ka ndodhur para dy muajsh, në nëntor, jo tash, por ata që e kanë fotografuar e nxjerrin kur duan. Besoj se me krijimin e kompanisë tonë do të kemi shërbim më të mirë dhe nuk do të jemi varur nga një qytet tjetër apo nga një kryeshef që thotë se Drenasi është 'paralagje' e një qyteti tjetër.

Edon Nishori, përshëndetje për të gjithë, të pranishmit. Dua me i ngrit disa çështje. Pika e parë: procesi i vullës apo vulosjes së regjistrimit të automjeteve kur bëhet në Drenas. Në qoftë se është

mundësia që i njëjti proces i ngarkimit të dhënave, si vendosja e vulës, me ardhur edhe në qendrat civile në Komoran, që me ia lehtësuar të gjithë asaj zone këtë pjesë, në kohë si është mundësia dhe organizimi komunal gjithmonë. Pastaj të pika e dytë: kisha shumë, jam gëzuar që u bë Eko Drenasi, për besë, edhe shpresojmë të marrë fund KRM "Pastrimi" edhe vjen dita me u pavarësuar Drenasi në këtë aspekt. Po kisha pas qejf, në qoftë se është e mundur, forca vullnetare – në mos ditoren, ndoshta javore – që nënkalimi i Komoranit me u bë në mënyrë vullnetare menaxhimi. Se, për besë, vjen prej Prishtinës, e di që nuk është faji i komunës, ose jo, është faji rajonal, nuk kemi qysh hyjmë në atë nënkalim. Faji është edhe i banorëve, po pak me menaxhuar ose me u përkujdes me forca vullnetare, se po e di që nuk është obligative, kishte qenë një ndihmesë e madhe, një pasqyrë e madhe për Komoranin, se ata po mendojnë që faji është i joni, madje edhe për ta përdorë edhe në fushatë e para fushatë. Pika e tretë: për shkollën e Kishnarekës, nëse ka mundësi renovimi i banjovë.

Edhe pika e katërt: nxënësit apo studentët e ardhshëm. Për shembull, na kemi drejtime deficitare, siç është fizika, kimia, biologjia. Tash shumicën e shkollave nuk i kemi aktualë, shkon ky zëvendësimi i pensionimeve dhe shpesh detyrohet dikush i fizikës me shkuar me dhanë kimi. A kishit mundur ne atyre studentëve që regjistrojnë universitetin e shtetit me ia mundësua një pagesë, edhe udhëtimin, edhe shujtën, si një lloj motivimi që ata me shkuar sa më shumë? Se dihet që mbas tri-katër vjetësh, ai investim ka me na kthyer produktivitet, se pastaj kanë përfitua edhe fëmijët tanë edhe të gjithë bashkëmoshatarët tjerë.

Mbledhja përfundoi në ora 14:35.

**Procesmbajtësja
Fakete Hoti**

**Lekturoi
Nikelinda Bujupi**



Kryesuesi i kuvendit komunal Drenas

Burim Bujupi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E DRENASIT
ZYRA E KRYETARIT



01 NR. 400/01 - 3122 DT. 10.10.2026

Për: Kuvendin e Komunës së Drenasit

Nga: Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit

Lënda: Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për pasqyrat financiare për vitin 2024



Në pajtim me nenin 14, të Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, si dhe duke u mbështetur në Procedurat Standarde të Trajtimit të Rekomandimeve të Zyres Kombëtare të Auditimit, po ju dërgojmë Raportin e progresit për implementimin e Rekomandimeve që dalin nga **"Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Drenasit për vitin 2024"**

Çështja	E gjetura	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete ne lidhje me zbatim te rekomandimit	Statusi i rekomandimit(I zbatuar ose I pa zbatuar)	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit
Çështja B1- Keq klasifikim i shpenzimeve	Neni 18, paragrafi 3 e Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë Janë vrejtur keq klasifikime te shpenzimeve npr kategori ekonomike ne vliere 2,488.200€. Nga Kjo vliere thesari kishte paguara sipas urdherva përbarimor per zbatimin e kontrates kolektive bga kategoria e investimeve kapitale 1,879,133€ dhe sherbimeve Komunale 27,849€ Pagesat për paga jubilare dhe shujta kanë ndodhur si rezultat I kontratës kolektive,shpenzimet e të cilave nuk kanë mundur të planifikohen me buxhet.	Kryetari duhet të siguroj që janë ndermarre të gjitha veprimet qe shpenzime te planifikohen ne ndarjet adekuate te bushetit(apo te ridestinohen mjetet kur eshte e nevojshme dhe e mundeshme)dhe qe pagesa e regjistrimi I shpenzimeve behet sipas kodeve ekonomike	Komuna ka vazhduar të kërkoj dhe insistoj tek niveli qendror qe te gjejne zgjidhje, shtrim të masës buxhetore për këtë kategori të shpenzimeve nga Ministria e Financave, meqense shpenzimet që kanë dal nga kontratat kolektive- sektoriale, me qarkore buxhetore nuk mund të buxhetohet.	I pa zbatuar	Pamundësia për të buxhetuar nga buxheti i Komunes.
Çështja A1 - Nënvlerësimi i pasurive nën 1,000€	Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.1. përcakton se, "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj.	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme lidhur me	Janë regjistruar ne sistemin e-pasuria dhe pranuar ne regjistrin kontabel ne e-pasuri.	I zbatuar	

	Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu nën 6.3. përcakton se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Në regjistrin e pasurive jo financiare nën 1,000€, kemi vërejtur pasuri të blera në vitin 2023 dhe 2024 për 117 njësi për tabela të mençura me vlerë 112,203€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e-pasuria që rezultoi në nënvlerësimin e regjistrit të pasurive jokapitale. Kjo ka ndodhur si rezultat i kontroleve të dobëta në monitorimin dhe verifikimin e regjistrave të pasurisë	regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.		
Çështja A2- Vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore.	Nëni 17(pika 1.2) Ligjit të Ndërtimit thotë:”Leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent Brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategorinë e II dhe III. Në dy (2) raste ka vonesa në lëshimin e vendimeve për lejet ndërtimore sipas afatit ligjor nga ana e Komunes pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore. Vlera totale e ketyre mostrave është 100,610€, kurse vonesat	Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen afatet ligjore për lëshimin e lejeve ndërtimore, duke forcuar kontrollin e brendshëm dhe mbikëqyrjen mbi trajtimin e kërkesave, në mënyrë që të	Komuna ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që të respektohen afatet ligjore në mënyrë që mos të ketë vonesa në lëshimin e lejeve të ndërtimit. Nëse nuk sillen me kohë dokumentacionet e nevojshme për marrjen e lejes së ndërtimit si : -pëlqimi për rregullim të dokumentacionit teknik	I Zbatuar

	ne lëshimin e lejeve ndertimore jane deri 220 ditë. Kjo ka ndodhur për arsye të mosfunksionimit efektiv të kontrolleve të brendshme dhe vonesat në pëlqimin nga KEDS-I për kompletimin me kohë të dokumentacionit.	mundësohet mbledhja me kohë e të hyrave	nga kompania e KEDS-it, -Pëlqim për kushte teknike nga Kompania Ujësjetësi Rajonal Sh.A. "Prishtina", -Pëlqim në dokumentacionin investivo-teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, -Pëlqim për kyqje në rrugë Nacionale (Magjistrale), Regjionale dhe Autoudhë, nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, Zyrtarët nga DUMM do të detyrohen të kryejnë procedurat për refuzim të lëndës sipas ligjeve në fuqi.	
Çështja A3 – Shpërblimi më kontratë në	Ligji i prokurimit publik Neni 59 paragrafi 4 parasheh: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në	Zyra e prokurimit ka ndërmarr masa dhe është shtuar kontrolli i nevojshëm për	I zbatuar

mungësë të plotësimit të kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit	fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, rregullorja 001/2022 për prokurimin publik neni 28.7 parasheh: Afati i fundit për dorëzimin e sigurimit të tenderit do të jetë i njëjti si ai për dorëzimin e tenderëve. Sigurimet e tenderëve të pranuar pas afatit për dorëzimin e tenderit do të refuzohet dhe kështu do të rezultojë në refuzimin e tenderit. OE te shperblyer me kontrate ne mungese te plotesimit te kerkeseve te njoftimit per Kontrate dhe dosje te tenderit po i parqesimi rastet si ne vijim • Te kontrate per “ndertimin ,zgerimin dhe rikonstruimin i rrugeve te asfaltuara ne Drenas-projekt dy vjeqar(Rruges tre - Kater kors(Rikonstruimi)Ruga f'ehmi dhe Xheve Lladrovci),ne vlere te tenderit ne kerkesen per pershtatshmeria profesionale pika 6 jane kerkuar raportet e auditimit per tri viter e fundit 2023,2022 dhe 2021 ndersa operatori ekonomik ne oferten e tij ka paraqitur raportet e rishikimit te pasqyrave financiare vjetore; dhe • Te kontrate per “Ndertimi i	fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë në procesin e vlerësimit të ofertave përkatëse dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e	vlerësimin e procedurave te prokurimit .	
--	---	--	---	--

	aneksit të SHFMU Rilindja”ne Dobreshcc ne vlere te kontraktuar 26,978€,operatori ekonomik fitues ne oferten e tij nuk ka dorezuar sigurin e tenderit Kjo ka ndoshur si pasojë e mungesës së funksionimit të kontrolleve të brendshme, në fushën e prokurimit.	prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.		
--	--	--	--	--

ÇËSHITJA A4 – REALIZIMI I ARTIKUJVE TË KONTRATËS ME ÇMIM PËR NJËSI, JO NË PËRPUTHJE ME PESHËN E PËRCAKTUARA NË DOSJE TË TENDERIT DHE PRANIMI I SHËRBIMEVE TË PAARSYETUARA	Bazuar në nenin 54.15 të Rregullores 001/2022 dhe interpretimit të KRPP- së të datës 09.06.2023 parasheh: "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasisë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësishë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tri dhjetë për qind (30%), në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar". Duke pasur parasysh faktin se peshimi i artikujve duhet bërë duke u bazuar në peshën dhe në rëndësinë e çdo artikulli , kjo nënkupton që vlera dhe sasia e realizuar (shpenzuar) e artikujve nuk mund të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë fillimisht në dosjen e tenderit dhe Rregulloja 01/2013/MF- Për shpenzimin e parashë publike, Neni 24, paragrafi 1.2 parasheh: të siguroj raportin e pranimit të mallit/shërbimit nga zyrtari / komisioni i autorizuar. Kontrata publike kornizë me çmim njësi "Njësitë profesionale me komponentin e mirëqenies sociale dhe shërbimit publik për qytetet e komunës së Drenasit" kornizë trevjeqare me cime për njësi për arikull e nënshkruar me datë 16.08.2022, ku në	Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i kontratës nga menaxheri i kontratës bëhet në pajtim me kërkesat ligjore, në mënyrë që kontrata publike kornizë me çmim për njësi të realizohet në pajtueshmëri të plotë me peshën e përcaktuar në dosjen e tenderit dhe pranimi, pagesa e shërbimeve të bëhet sipas shërbimeve reale të ndodhura.	Komuna ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që menaxhimi i kontratave të bëhet në pajtim me kërkesat ligjore për kontratën publike kornizë me çmimin për njësi dhe të realizohet në pajtueshmëri me peshën e përcaktuar në dosjen e tenderit.	I zbatuar
--	--	--	--	------------------

					të parashihej për artikuj ne vijim: • Artikulli (pozicioni) 3 "shërbime administrative në koordinim e punës në fushë e e ekonomisë dhe financave ,raporteve ,dokumentimin ,menagjimin si dhe evidentimin e shërbimeve të kryera sipas standarteve specifike etj" e peshuar me 5% në vitin 2020/24 bazuar në situacione/fatura të pranuar/ekzekutuara ishin realizuar shërbime në vlerën 95,985€ që ka rezultuar në tejkalim në vlerë 36,763€ dhe artikulli (pozicioni) 7 "shërbime në koordinim e punë:raporteve mujore ,dokumentimin ,menagjimit si dhe në evidentimin e shërbimeve të kryera sipas standarteve specifike,duke kontrolluar dhe monitoruar stafin etj" e peshuar me 5%,ndërsa ishin pranuar/ekzekutuara shërbime në vlerë 148,797€ që ka rezultuar në tejkalim në vlerë 89,875€ • Poashtu në testimin për artikullin (pozicioni) 7 "shërbime ne koordinimin e punës:raporteve mujore ,dokumentimit ,menagjimit si dhe ne evidentimin e shërbimeve të kryera sipas standarteve specifike,duke kontrolluar dhe monitoruar stafin etj,që nënkupton shërbimi për raportet mujore të përgatitur nga të angazhuarit e kompanisë për kryerjen e shërbimeve të kontraktuara,ku në mbështetje të listave të pagave mujore për vitin 202/24 për kryerjen e shërbimeve ndaj komunës nga të angazhuarit e kompanisë është 596 paga mujore,që rezultoi në ofrimin e shërbimit në vitin 2024 janë bërë faturime- pagesë/situacione për këtë shërbim në vitin 2024, janë bërë në vlerë 148,797€ e që rezultoi në mbi faturim/pagesë/pranim të situacioneve ne vlerë 132,705€ të paarsyetuara (fiktivee).
--	--	--	--	--	---

	Tejkalimi dhe pranimi shërbimeve të paarsyetuara ka ndodhur si rezultat i mblikëqyrjes së dobët nga ana e menaxherit të Kontratës.				
--	--	--	--	--	--

ÇËSHITJA B2 – MUNGESA E PROJEKTEVE EKZEKUTUESE	Paragrafi 19.17 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ndër tjerash parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit".	Kryetari të sigurojë forcimin e kontroleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Komuna ka marrë masat e nevojshme që për projektet që kanë vlera të larta financiare ka hartuar projektet përmesë kontratës "Hartimi I projekteve për nevojat e Komunës"	Pjesërisht i zbatuar	Sfidë është për projektet që kanë vlera të vogla financiare ku hartimi i projekteve do të merrte buxhetin e atij projekti dhe nuk mbet buxhet për ekzekutim të projektit.
Në shtatë(7) raste komuna kishte filluar proceduarat e prokurimit dhe kishte lidhur kontrata pa hartuara projekt ekzekutiv dhe atom ishin si ne vijim:	• Projekti për "Ndërtimi i aneksit të SHFMU Rilindja" në Dobroshec me vlerë të kontraktuar 26,975€. • Projekti për Asfaltimi i rrugëve në fshatin Sankoc,Fushicë e Epërme dhe e Ulët "Ilot II me vlerë të kontraktuar 101,866€ • Projekti për "Asfaltimi i rrugës Komoran I,II,III dhe IV Iloti I me vlerë të kontraktuar 111,222€. • Projekti për "Asfaltimi i rrugëve dhe Kubëzimi Drenas I,II,III dhe IV" Iloti III me vlerë të kontraktuar 173,280€. • Projekti për "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Nekoc dhe Kishnarek" me vlerë të				

	kontraktuar 139,702€.	Projekti për "Regullimi i trotuarit dhe ndriçimit publik-Drenas Komoran Aclan Terstenik Dobrosheci dhe Baicë" me vlerë të kont.221.970€ dhe, Projekti për "Ndërtimi,Zgjerimi dhe rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara në Drenas" me vlerë të kont.269,945€. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së planifikimit të duhur para fillimit të procedurave të prokurimit,duke përfshirë mungesën e hardinit të projektit ekzekutiv për projektet specifike.			
Çështja A5 – Mos raportim i rregullt për shfrytëzim të pronave komunale	Neni 22 paragrafi 2 i Ligjit nr. 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përcakton se "Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore t'i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim". Kryetari i Komunës nuk kishte paraqitur asnjë raport periodik gjashtëmujor Kuvendit Komunal lidhur më monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.	Kryetari duhet të sigurojë se raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.	Komuna ka angazhuar një zyrtar(sherbyes civil) zyrtar për menaxhimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim,po ashtu ky zyrtar ka raportuar te kryetari,ku i cili ka raportuar në kuvend, sipas raportit me nr. 07-052/01-2564.	I zbatuar	

Shkak i ndodhjes është mosrespektimi i kërkesave ligjore në lidhje me raportimin dhe mbikëqyrjen e kontratave për shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.		
--	--	--

Çështja B3 – Mangësi në databazën e tatimit në pronë	Ligjin nr. 08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin ligjit për tatimin në pronë e paluajtshme neni 3 dhe Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronë e Paluajtshme, neni 11 pika 1 definon: "Zbritja për vendbanimin parësor- Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohelet zbritja prej 30,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Po ashtu, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë ka njoftuar komunat për vendimin e marr për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, kjo me qëllim të shmangies së duplikimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni. Nga analiza e bazës së të dhënave për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se 148 persona kishin përfituar zbritje të tatimit në pronë pa numër personal. Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në departamentin e tatimit në pronë.	Kryetari duhet të marrë veprime shpesh për të siguruar se janë bërë korrigjimet e nevojshme në bazën e të dhënave të tatimit në pronë, në mënyrë që zbritja për vendbanim parësor të bëhet vetëm për personat fizik të cilët janë të regjistruar me numër personal dhe kanë deklaruar në komunë se objekti shërben si vendbanim parësor.	Kemi insistuar në përmisimin të zbritja e 30,000.00€ në vlerë, por për shkaqe teknike të sistemit të tatimit në prone migrimin e të dhënave nga sistemi 1 vjetër në të rinun nuk kemi pasur mundësi të punojmë më shumë në këtë drejtim. Poashtu edhe oër tatim me vlerën 0 kam derguar një email për ti hequr nga sistemi. Në kemi vazhduar me plotësimin e regjistrave me nr. personal duke kerkuar nga zyra e gjendjes civile me aq mundësi sa ata po na ofrojnë sepse ka probleme të ndryshme ka persona që nuk janë në regjistra, ka persona të vdekur e që figurojnë të ngarkuar me tatim, vetëm nga nëntori 2024 e deri tani janë regjistruar në sistem diku 762 numra personal	Pjesërisht i zbatuar	Sfida për mos funksionim i sistemit.
---	--	---	---	-----------------------------	---



Çështja B4 – Monitorimi i menaxhimit të kontratave jo përmes E- Prokurimit	Paragrafi 70, 24.f. i Rregullores nr.01/2022 për Prokurimin Publik parasheh se “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”. Menaxheret e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performances së kontraktueseve përmes sistemit elektronik të prokurimit publik. Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Komuna e Drenasit ka përpiluar listën për trajnimin e menaxherve të kontratave dhe ju është drejtuar Ikap. Staf i zyrtarëve të Komunes ka mbajtur trajnim për menaxhim të kontratave me 24 dhe 25 nëntor të vitit 2025 dhe janë pajisur me certifikata 49 zyrtar.	I zbatuar
---	---	---	--	------------------

Cështja A6 – Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare Gjetja	Rregulloerja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19.4.3 përcakton se: “Çdo fundviti bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistruar të pasurive jo financiare, tutje neni 21 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare”, po ashtu neni 11.3 përcakton se: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet dhe zhvlerësimi”.	Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe në pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat, si dhe zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare	Eshtë dërguar e-maili te drejtorit e caktuar te cilat kanë projekte te pa perfunduara qe kanë mbetur si investim ne vijim qe shume vite. e-mailine kam derguara me 23.07.2025 dhe e kamë perseritur edhe me datën 25.08.2025.	Pjesërisht i zbatuar	Sfidime drejtorit përkatëse sepse shumë menxher të cilët kanë qenë menaxher te kontrave janë pensionuar apo kanë ndërprerë mardhënien e punës me Komunën.dhe nuk po mundemi me i kompletuar lëndet për të bërë prejje të punimeve.
Komuna ka kryer procesin e inventarizimi të pasurive jo financiare, mirëpo nuk kishte bërë krahasimin(harmonizimin)e gjendjes së inventarizuar me gjendjejn e pasurive në regjistrat kontabël, rrjedhimisht nuk dihet diferenca në mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit.Poashtu nga raportet e vlerësimit të pasurive jo financiare kanë rezultuar në pasuri jo financiare jashtë përdorimit dhe të dëmtuara, si pasoj që akoma nuk ishte formuar komisioni për tjetërsimin e pasurive që do të rezultonte në përgaditujen e raportit për pasuritë që duhet të largohen nga përdorimi dhe në përditësimin e regjistrave					

			kontabël. Gjithashtu duhet të theksojmë se nga analiza e shpalosjes dhe të dhënave të pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€ në PFV kemi vërejtur se skoma ka të regjistruara në kategorinë investime në vijim për vitet 2014 deri në vitin 2023 në vlerë totale 4,616,410€ të cilat përkundër që mund të jenë në përdorim akoma mbahen në regjistrat si pasuri në vijim. Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme lidhur me zbatimin e kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare.	kapitale sipas klasifikimit kontabël		
--	--	--	--	--------------------------------------	--	--

Çështja A7 – Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme	Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbarese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe nën 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjohën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në inkasimin e llogarive të arkëtueshme, duke mos përfshitur edhe masat juridike.	Komuna e Drenasit përkrahësit zyra e tatimit në prone ka derguar 280 vërejtje të tatimpagueseve si e vetmja mundësi për inkasim sa me të lart, pastaj me takime të ndryshme për t'i bindur qytetarët që pagesa e tatimit në prone është në favor të qytetarëve dhe ndikon në mirëqenien e tyre dhe në investime kapitale. Jemi duke punuar me intensitet të shtuar por pasi janë hequr kushtëzimet me nxjerrjen e dokumenteve ka rënë edhe niveli i pagesave. Nga viti i ardhshëm është planifikuar që tatimpaguesve mbi 200€ t'i dergojmë me letërkujtesa , njoftimi përfundimtar, bllokimi i llogarive si dhe vendim për ekzekutimi të tatimpaguesve që nuk i ka kryer obligimet tatimore.	Heqja e kushtëzimeve për marrjen e dokumentacionit. Heqja e mundësisë për dërgim të përmbaruesi, mos funksionimi i sistemit të tatimit në prone, mos regjistrimi i pagesave.
--	---	--	---	---

veprimtarisë 1,795,263€, shfrytëzimi i dhënies së pronës publike (qiraja) 888,348€ dhe të tjerat 19,590€. Dobësitë e identifikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësisht inkasimin e tyre.		Vendimi i Kuvendit 02-400/01-4780 dt. 31.01.2025 për plotësim ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa,, ngarkesa dhe gjoba. Është ndërmarrë veprim konkret lidhur me zvoglimin e llogarive të arkëtueshme- taksat për ushtrimin e veprimtarisë me vendimin 02Nt.431/01 - 47980 te dt.30.09.2024 janë falur borxhet e bizneseve nga viti 2000 deri në vitin 2019. Sa i përket inkasimit të detyruar për vitet 2022, 2023 dhe 2024 nuk kemi mundur të iniciojm procedurë përbarimore pasi ligji 04/L-139 ka pësuar ndryshime ku aktet administrative (vendimet-aktvendimet) nuk përmbahen lidhur me këtë kemi ndërmarr veprime për ndryshimin e rregullores komunale per	Plotësim ndryshim i rregullores komunale për taksa, tarifa,ngarkesa dhe gjoba. Pjesërisht i zbatuar
---	--	--	---

Çështja B4 – Monitorimi i menaxhimit të kontratave jo përmes E- Prokurimit	Paragrafi 70,24.f.i Rregullores nr.01/2022 për Prokurimin Publik parasheh se “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulim për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”. Menaxheret e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performances së kontraktueseve përmes sistemit elektronik të prokurimit publik. Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Komuna e Drenasit ka përpiluar listen për trajnimin e menaxherve të kontratave dhe ju është drejtuar Ikap. Stafii i zyrtarëve të Komunës ka mbajtur trajnim për menaxhim të kontratave me 24 dhe 25 nëntor të vitit 2025 dhe janë pajisur me certifikata 49 zyrtar.	I zbatuar
---	---	---	--	------------------

Çështja A6 – Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare Gjetja	Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19.4.3 përcakton se: “Çdo fundvit bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistruar të pasurive jo financiare, tutje neni 21 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare”, po ashtu neni 11.3 përcakton se: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet dhe zhvlerësimi”.	Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat, si dhe zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare	Eshte derguar e-maili te drejtorit e caktuar te cilat kanë projekte te pa perfunduara qe kanë mbetur si investim ne vijim qe shume vite. e-mailine kam derguara me 23.07.2025 dhe e kam perseritur edhe me datën 25.08.2025.	Pjesërisht i zbatuar	Sfida me drejtorit përkatëse sepse shumë menxher të cilët kanë qenë menaxher te kontrave janë pensionuar apo kanë ndërprerë mardhënien e punës me Komunën dhe nuk po mundemi me i kompletuar lëndet për të bërë prejje të punimeve.
	Komuna ka kryer procesin e inventarizimi të pasurive jo financiare, mirëpo nuk kishte bërë krahasimin(harmonizimin)e gjendjes së inventarizuar me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabël, rrjedhimisht nuk dihet diferenca në mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Poashtu nga raportet e vlerësimit të pasurive jo financiare kanë rezultuar në pasuri jo financiare jashtë përdorimit dhe të dëmtuara, si pasoj që akoma nuk ishte formuar komisioni për tjetërsimin e pasurive që do të rezultonte në përgatitjen e raportit për pasuritë që duhet të largohen nga përdorimi dhe në përditësimin e regjistrave				

	kontabël. Gjithashtrë duhet të theksojmë se nga analiza e shpalosjes dhe të dhënave të pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€ në PFV kemi vërejtur se skoma ka të regjistruara në kategorinë investime në vijim për vitin 2014 deri në vitin 2023 në vlerë totale 4,616,410€ të cilat përkundër që mund të jenë në përdorim akoma mbahen në regjistrat si pasuri në vijim. Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme lidhur me zbatimin e kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare.	kapitale sipas klasifikimit kontabël		
--	---	--------------------------------------	--	--

Çështja A7 – Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme	Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe nën 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjohën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave. Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në inkasimin e Llogarive të Arkëtueshme (LIA) pasi që vazhdon mija e tyre nëpër vite. Për mostrat tona nuk kemi vërejtje që komuna ka marrë ndonjë veprim konkret për vitin 2024 për inkasimin e LIA. Pjesëmarrjen më të madhe e kanë të arketueshmet ishte nga tatimi në pronë 2,036,025€, taksat për ushtrimin e	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në inkasimin e llogarive të arkëtueshme, duke mos përjashtuar edhe masat juridike.	Komuna e Drenasit përkatësisht zyra e tatimit në prone ka dërguar 280 vërejtje të tatimpaguesve si e vetmja mundësi për inkasim sa me të lart, pastaj me takime të ndryshme për t'i bindur qytetarët që pagesa e tatimit në prone është në favor të qytetarëve dhe ndikon në mirëqenien e tyre dhe në investime kapitale. Jemi duke punuar me intensitet të shtuar por pasi janë hequr kushtëzimet me nxjerrjen e dokumenteve ka rënë edhe niveli i pagesave. Nga viti i ardhshëm është planifikuar që tatimpaguesve mbi 200€ t'i dërgojmë me letërkujtesa , njoftimi përfundimtar, bllokimi i llogarive si dhe vendim për ekzekutim të tatimpaguesve që nuk i ka kryer obligimet tatimore.	Pjesërisht i zbatuar	Heqja e kushtëzimeve për marrjen e dokumentacionit. Heqja e mundësisë për dërgim të përmbaruesi, mos funksionimi i sistemit të tatimit në prone, mos regjistrimi i pagesave.
--	---	---	--	-----------------------------	---

	veprimtarisë 1,795,263€, shfrytëzimi i dhënies së pronës publike (qiraja) 888,348€ dhe të tjerat 19,590€. Dobësitë e identifikuar lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësish inkasimin e tyre.	Vendimi i Kuvendit 02-400/01-4780 dt. 31.01.2025 për plotësim ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa,, ngarkesa dhe gjoba. Është ndërmarrë veprim konkret lidhur me zvoglimin e llogarive të arkëtueshme- taksat për ushtrimin e veprimtarisë me vendimin 02Nr.431/01- 47980 te dt.30.09.2024 janë falur borxhet e bizneseve nga viti 2000 deri në vitin 2019. Sa i përket inkasimit të detyruar për vitet 2022, 2023 dhe 2024 nuk kemi mundur të iniciojm procedurë përbarimore pasi ligji 04/L-139 ka pësuar ndryshime ku aktet administrative (vendimet-aktvendimet) nuk përmbahen lidhur me këtë kemi ndërmarr veprime për ndryshimin e rregullores komunale per	Plotësim ndryshim i rregullores komunale për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Pjesërisht i zbatuar
--	---	---	--

[illegible]

Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së, për Vitin 2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLOGOC
ZYRA E KRYETARIT
01 Dt. 03/01-8026, Nr. 03/03/2026



Në bazë të nenit 58 pika (h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 72.1 pika (h) të Statutit të Komunës së Glogocit, të datës 16.09.2008, Ligjit Nr. 08/L-111 për arkivat shtetërore, Ligji nr. 04/L-184 për Adiministrimin e Punës në Zyrë, Udhëzimi Administrativ (MAP) Nr. 01/2017 për Administrimin e punës në zyrë, evidencat themelore dhe detyrat e punës së arkivistit, Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 01/2021, për Funksionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në Komunë, në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës më 01-Nr. 020/04-4799, të datës 04/02/2026, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës, këtë:

**PROPOZIM RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E DOKUMENTEVE ZYRTARE
DHE ARKIVORE**

Neni 1
Qëllimi

Me këtë akt përcaktohen mënyrat për administrimin, menaxhimin, protokollimin dhe klasifikimin zyrtar të dokumentacionit që nga evidentimi fillestar, deri në arkivimin e tyre në formë fizike dhe elektronike.

Neni 2
Fushëveprimi

Këto rregulla zbatohen nga njësitë organizative të komunës në të cilat kryhen punët e menaxhimit dhe administrimit të dokumenteve zyrtare.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në Ligjet në fuqi kanë këtë kuptim:

- 1.1. QSHQK- Qendra për shërbim të qytetarëve në komunë;
- 1.2. SMDI - Sistemi për menaxhimin e përmbajtjes digjitale të informacionit;
- 1.3. Protokolli unik - është numër unik me të cilin evidentohet në librin e protokollit në sistemin e intranetit çdo kërkesë e qytetarit;
- 1.4. Arkivi komunal- përbën tërësinë e materialit arkivor, pa marrë parasysh formën ose bartësin e tij, të cilën e ka krijuar institucioni gjatë veprimtarisë së vet;
- 1.5. Libri Arkivor- Është evidencë e cila përmban regjistrin e tërë materialit dokumentar të krijuar me punë, si dhe atij materiali dokumentar i cili në çfarëdo baze gjendet në arkiv;

[Signature]

- 1.6. Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Agjencia) është institucion i vetëm ekzekutiv i administratës shtetërore që organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë arkivore në vend;
- 1.7. Arkivat - janë institucione shtetërore ose joshetërore të specializuara që mbledhin, përpunojnë, administrojnë, ruajnë dhe ofrojnë për shërbim pasurinë arkivore e cila mbrohet dhe sigurohet nga shteti;
- 1.8. Arkivi qendror - administron dhe menaxhon materialet arkivore të institucioneve publike të nivelit qendror;
- 1.9. Arkivi Ndërkomunal - administron dhe menaxhon materialet arkivore të institucioneve publike të nivelit lokal;
- 1.10. Arkivat speciale - janë arkivat e formuara me ligje të veçanta nga institucionet publike dhe jopublike të cilat ushtrojnë veprimtari me interes shoqëror;
- 1.11. Arkivat private - janë subjekte që administrojnë, përpunojnë, ruajnë dhe ofrojnë për shërbim dokumente me prejardhje joshetërore;
- 1.12. Fondi arkivor - përbën tërësinë e materialit arkivor, pa marrë parasysh formën ose bartësin e tij, të cilën e ka krijuar personi juridik ose fizik gjatë veprimtarisë së vet;
- 1.13. Dokumente - janë të gjitha aktet e krijuara nga autoritetet publike, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në funksione administrative si dhe aktet e krijuara nga subjektet tjera, përkatësisht personat juridikë dhe fizikë;
- 1.14. Materiali arkivor - i tërë materiali burimor dhe i reproduktuar nga institucionet publike, personat juridikë dhe fizikë gjatë veprimtarisë së tyre siç janë: dorëshkrimet, të dhënat e shtypura, vizatimet, fotografitë, materialet audio-vizuale, materialet elektronike dhe të digjitalizuara si dhe të gjitha mjetet e tjera ndihmëse, të cilat e mundësojnë kuptueshmërinë e qartë të përmbajtjes së informacioneve dhe që kanë vlerë të përhershme;
- 1.15. Materialiregjistraturik/dokumentar - tërësia e dokumenteve ose e të dhënave të krijuara gjatë veprimtarisë dhe punës së institucioneve publike, personave juridikë dhe fizikë, pa marrë parasysh formën dhe formatin e shënimit;
- 1.16. Fondkrijuesit — institucionet e përcaktuara në fushëveprimin e këtij Ligji, të cilat gjatë kryerjes së detyrave të punës krijojnë materialin arkivor i cili dërgohet për arkivim në arkivin kompetent, pas kalimit të afatit të përcaktuar me ligj;
- 1.17. Fondposeduesit — janë institucionet dhe subjektet e përcaktuara në fushëveprimin e këtij Ligji të cilat kanë në posedim material me vlera arkivore të krijuar nga të tjerët;
- 1.18. Regjistri arkivor publik — është tërësia e të dhënave për materialin arkivor që gjendet në fondkrijuesit e fondposeduesit, përfshirë dhe atë që për arsye të ndryshme gjendet te personat fizikë;
- 1.19. Materiali arkivor privat — është materiali arkivor që krijohet nga veprimtaria e personave juridikë dhe fizikë, të cilët kryejnë veprimtari ose aktivitete të interesit të përgjithshëm, por nuk është krijuar në kuadër të ushtrimit të përgjegjësiave shtetërore si dhe që nuk është në pronësi shtetërore;
- 1.20. Regjistrimi i dokumenteve — Akt, me të cilin, dokumentit gjatë regjistrimit të tij në sistem, i jepet identifikatori unik;
- 1.21. Klasifikimin e dokumenteve sipas rëndësisë dhe afateve të ruajtjes;
- 1.22. Ndarja — Veprime të ndërlidhura me zbatimin e vendimit për ndarjen e dokumenteve për ruajtje, shkatërrim ose dorëzim, të vërtetuara me vendimet përkatëse të organit komunal;
- 1.23. Migrimi — Akt me të cilin dokumentet barten nga një sistem në tjetrin, duke e ruajtur autenticitetin, integritetin, besueshmërinë dhe përdorimin;



- 1.24. Mbrojtja — Veprime dhe procedura të përfshira në sigurimin e ekzistimit teknik dhe përmbajtësor të dokumenteve autentike gjatë kohës;
- 1.25. Menaxhimi me dokumente — Lëmi e menaxhimit e cila përfshinë përgjegjësinë për kontrollin efikas dhe sistematik në krijimin, pranimin, ruajtjen, mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe publikimin e dokumenteve, duke përfshirë edhe proceset e pranimit të dokumenteve në sistemin elektronik;
- 1.26. Përcjellja — Krijimi, pranimi, ruajtja dhe mirëmbajtja e informatave për lëvizjen dhe shfrytëzimin e dokumenteve;
- 1.27. Bartja - Transferimi i dokumenteve nga një lokacion në tjetrin;
- 1.28. Asgjësimi — Veprim i largimit ose fshirjes së dokumenteve pa kurrfarë mundësie për rekonstruimin e tyre, konform akteve normative në fuqi;
- 1.29. Digjitalizimi- Është bartja e lëndës arkivore nga mediumet (format) tjera në formën elektronike, me qëllim të gjatjes më të lehtë, shfrytëzimit, publikimit, si dhe ruajtjes së tyre;

Neni 4

Administrimi i dokumenteve dhe punëve arkivore

1. Në kuadër të strukturës organizative të komunës, duke filluar nga organet e komunës, si dhe çdo njësi organizative, duhet të ketë kodin e veçantë me numrin përkatës, si vijon:
 - 1.1 Kuvendi i Komunës - 02
 - 1.2 Kryetari i Komunës - 01
 - 1.3 Drejtoria e Administratës - 02
 - 1.4 Drejtoria për Buxhet dhe Financa - 03
 - 1.5 Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë - 13
 - 1.6 Drejtoria për Infrastrukturë Lokale - 15
 - 1.7 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - 06
 - 1.8 Drejtoria për Arsim - 09
 - 1.9 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - 10
 - 1.10 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik - 05
 - 1.11 Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit - 08
 - 1.12 Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural - 04
 - 1.13 Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë - 07
 - 1.14 Drejtoria për Inspeksion - 11
2. Shenja e klasifikimit dhe numri themelor i lëndës përkatëse nuk ndryshon gjatë vitit përkatës.

Al

Neni 5
Procedurat e evidentimit

1. Të gjitha shkresat dhe dokumentet që i adresohen Komunës në formë fizike dhe elektronike, duhet të kalojnë përmes Njesisë për Administrimin e Dokumenteve — Qendrës për Shërbim të Qytetarëve në komunë (QSHQK) siç është e paraparë me nenin 2, pika 1.13 e Ligjit nr.04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë, përveç në ato raste kur një gjë e tillë është e rregulluar ndryshe me ligj të veçantë.
2. Të gjitha shkresat hyrëse dhe dalëse të të gjitha organeve dhe njësive organizative të Komunës duhet të evidentohen në protokollin unik i cili mbahet brenda institucionit të komunës në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve.
3. Pranimi i shkresave bëhet në QSHQK, e cila shkresë ka arritur drejtpërdrejtë nga pala, dorëzuesi i shkresave zyrtare, përmes shërbimit postar, faksit dhe postës elektronike.
4. Dokumentet e pranuar nëpërmjet postës zyrtare elektronike janë të të njëjtës rëndësi sikurse dokumentet në letër.
5. Dokumentet e pranuar në formë elektronike konvertohen në formën fizike dhe më pas evidentohen.
6. Zyrtari i QSHQK-së, pranon shkresën dhe bën regjistrimin në sistemin elektronik sipas shenjave të klasifikimit dhe numrave themelorë si dhe skanon të gjitha dokumentet që përmban shkresa dhe i bashkëngjitet në sistemin elektronik, e cila shkresë përcillet në formë elektronike te Drejtoria/njësia përkatëse.
7. QSHQK, pas përfundimit të vitit duhet të bëjë shtypjen e librit të protokollit unik, për kërkesat/parashtresat nga sistemi elektronik i evidencës.

Neni 6
Protokolli dhe evidentimi i akteve

1. Për menaxhimin me dokumente zyrtare, QSHQK është e pajisur me vula dhe me libra protokollarë.
2. Vulosja e akteve bëhet në bazë të listës së miratuar nga Kryetari i Komunës, që mund të vulosen me vulat e QSHQK-s.
3. Për evidentimin e të gjitha lëndëve dhe shkresave zyrtare duhet të përdoren katër (4) libra protokollarë:
 - 3.1. Libri kryesor i protokollit unik;
 - 3.2. Libri i ekspeditimit të brendshëm;
 - 3.3. Libri i dorëzim-pranimit të postës; dhe
 - 3.4. Libri arkivor.
4. Libri kryesor i Protokollit Unik është evidenca themelore e shkresave (lëndëve) në sistemin e menaxhimit zyrtar, i cili mbështetet në protokoll dhe në planin e shenjave të klasifikimit, në të cilin regjistrohen të gjitha shkresat e pranuar, hyrëse dhe dalëse.



Libri i Protokollit Unik është formë elektronike e evidencës që mbyllet në çdo fundvit kalendarik, shtypet dhe vuloset.

Në kopertina të Librit të Protokollit Unik shënohet titulli i institucionit, viti për të cilin është mbajtur.

Libri kryesor i Protokollit Unik duhet të ruhet edhe në mënyrë elektronike.

Libri i Protokollit Unik, i mbyllur, dorëzohet në Arkivin komunal.

5. Libri i Ekspeditimit të Brendshëm shërben për të mbajtur evidencën e lëndëve të shpërndara nëpër organet e Komunës dhe njësitë e tjera organizative.
6. Libri i dorëzim-pranimi të postës shërben për mbajtjen e evidencës së pranim/dorëzimit të postës.
7. Libri arkivor shërben për mbajtjen e evidencës së lëndëve të dërguara në arkivin komunal.

Neni 7

Evidentimi i komunikimit në nivelin horizontal dhe vertikal

1. Të gjitha shkresat dhe dokumentacioni që lëvizë në formën vertikale duhet të regjistrohet në protokollin unik.
2. Komunikimi horizontal, nënkupton lëvizjen e shkresave dhe dokumenteve ndërmjet njësive organizative përbrenda Drejtorisë/njësive.
3. Shkresa apo dokumenti që lëvizë në formën horizontale, regjistrohet vetëm brenda njësive përkatëse (Drejtorisë//Sektorit/Zyrës) që e krijon dokumentin.

Neni 8

Pranimi dhe hapja e postës

1. Me postë nënkuptojmë të gjitha shkresat ose lëndët të cilat janë objekt i pranimi dhe dërgimit, në formë fizike dhe elektronike.
2. Pranimi e postës sipas rregullit e bën Zyrtari për pranim dhe dorëzim të postës. Në mungesë të tij mund ta pranoi edhe ndonjë person tjetër i autorizuar.
3. Refuzimi i pranimi të postës bëhet vetëm nëse:
 - 3.1 Me të drejtë, pranuesi dyshon se përmbajtja e dërgesës mund të rrezikojë jetën dhe shëndetin e njerëzve, do të ndikoi në dëmtimin e objektit dhe të pajisjeve, ose do të pengoi kryerjen e veprimtarisë;
 - 3.2 Ka për qëllim që të pengoi punën, nëse pa kërkesën e tij është dërguar për qëllime propagandistike, reklamimi ose qëllime të ngjashme;
 - 3.3 Posta e dërguar nuk ka të bëjë me pranuesin. Në këtë rast, ai është i obliguar që t'ia kthejë shërbimit postar ose shërbimit tjetër, për dërgim të postës në adresën përkatëse.
4. Vërtetimi i pranimi të postës jepet nëse është paraparë me dispozita ligjore, ose kur atë e kërkon dërguesi, përkatësisht pranuesi.
5. Vërtetimi lëshohet me shenjën e vulës së pranimi, ku shënohen data e dorëzimit/pranimi dhe shenja evidentuese e shkresës. Vërtetimin e nënshkruan zyrtari i cili e ka pranuar shkresën.
6. Për postën e pranuar në QSHQK mbahet evidencë në Librin e dorëzim-pranimi të postës.



7. Shpërndarja e postës bëhet sipas përmbajtjes. Shpërndarjen e postës e bën personi i autorizuar për dërgimin e dërgesave.

Neni 9

Pranimi dhe vendosja lidhur me kërkesat/parashtresat nga Drejtoritë/njësitë

1. Çdo njësi organizative cakton një zyrtar/e përgjegjës/e i/e cili/a pranon të gjitha lëndët, drejtuar njësisë përkatëse.
2. Njësia, ka për obligim që lidhur me kërkesat/parashtresat e pranuar të vendosë brenda afateve ligjore dhe t'a njoftoi palën me shkrim.
3. Çdo njësi ka për obligim të mbaj regjistrin e lëndëve të pranuar me informata, lidhur me statusin e tyre.
4. Çdo akt administrativ i cili nxirret nga organet e Komunës dhe njësitë e saj duhet të protokollohet në Protokollin Unik, siç është e paraparë në Udhëzim administrativ nr.2011/03 të nxjerr nga Qeveria e Kosovës.
5. Pas përfundimit të procedurës administrative lidhur me kërkesat/parashtresat, zyrtari shqyrtues dosjen e kompletuar duhet ta kthej në shërbimin e arkivit.
6. Zyrtarët shqyrtues janë të obliguar që të gjitha lëndët t'i procesojnë në INTRANET (sistemin elektronik të lëndëve) duke i skanuar të gjitha dokumentet e lëndës dhe t'i bashkëngjesin në sistem.

10

Arkivimi i lëndëve

1. Çdo lëndë e kryer shënohet me shenjë të caktuar, në bazë të së cilës bëhet klasifikimi dhe arkivimi. Në mbështjellësin e lëndës shënohen këto të dhëna:
 - 1.1. Titulli i plotë i institucionit, në rastin tonë Komuna e Gllogocit;
 - 1.2. Drejtoria, sektori/njësia;
 - 1.3. Viti i hartimit të materialit;
 - 1.4. Lloji i materialit sipas përmbajtjes;
 - 1.5. Shenja unike — klasifikimi;
 - 1.6. Numri rendor i regjistratorit i shënuar në librin e protokollit.
2. Libri arkivor, i cili mbahet në kuadër të punëve të arkivit, përmban pasqyrën e tërësishme të arkivit të lëndëve dhe materialit të arkivuar.
3. Çdo lëndë që konsiderohet e kryer, mund të ruhet në Arkivin e Administratës deri në dy (2) vite, prej ditës së protokollimit, ndërsa pas këtij afati me procesverbal dorëzohet në Arkivin Komunal, duke e shënuar në librin arkivor.
4. Lënda e cila duhet të dërgohet në Arkiv, paraprakisht duhet të sigurohet që të jetë e kompletuar me të gjitha dokumentet që janë të shkruara në mbështjellësin e lëndës.
5. Lëndët arkivore të shënuara në librin arkivor, mund t'u jepen për shfrytëzim të përkohshëm strukturave të komunës, me fletë-kthimi/revers, i cili plotësohet në dy kopje.



6. Dokumentet sekrete dhe rreptësishtë sekrete të materialit arkivor mund të jepen në shfrytëzim dhe shikim, konform akteve normative që e rregullojnë këtë fushë.
7. Arkivisti duhet të ruajë fshehtësinë e dokumenteve zyrtare, të cilat i ka pranuar dhe mbanë përgjegjësi për tjetërsimin, humbjen dhe keqpërdorimin e tyre.

Neni 11

Mënyrat e regjistrimit në librin arkivor

1. Në rubrikën "numri rendor", shkruhet me radhë, prej numrit 1 e tutje. Numrat e materialit të njëjtë të regjistraturës së formuar gjatë një viti kalendarik, pa marrë parasysh numrin e njësive të regjistraturës. Numrat pasues, rrjeshtor përcillen në vijimësi në librin arkivor, gjatë viteve që vijojnë.
2. Në rubrikën "data e regjistrimit", shënohet data, muaji, viti i regjistrimit të materialit. Materiali i regjistraturës nga viti i mëparshëm regjistrohet në librin arkivor, më së voni deri në muajin prill të vitit vijues. Njësitë e regjistraturës shënohen me numër rendor, me të cilin janë regjistruar në librin arkivor.
3. Në rubrikën "viti i krijimit", shënohet viti, përkatësisht periudha e krijimit të materialit të regjistraturës.
4. Në rubrikën "përmbajtja", shënohet shkurtimisht përmbajtja e materialit të regjistraturës dhe shenja e klasifikimit.
5. Në rubrikën "giithscj", shënohet numri i përgjithshëm i njësive të regjistraturës së materialit të së njëjtës periudhë të regjistraturës.
6. Në rubrikën "lokalet dhe raftet", shënohen të dhënat se në cilat raftet, dollapë apo pjesë të lokalit është vendosur, lidhur me vendosjen e materialit.

12

Klasifikim i materialit pavlerë

1. Përzgjedhja e lëndës arkivore dhe ndarja e materialit të pavlerë bëhet me komision të veçantë. Komisioni e ndan materialin e regjistraturës sipas lëndëve dhe kategorive, duke u bazuar në afatin e ruajtjes.
2. Lista e kategorive është pjesë përbërëse e këtyre rregullave që zbatohen në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2007 për Përzgjedhjen e Lëndës Arkivore dhe Regjistrimin e Materialit të Pavlershëm Regjistruar.
3. Komuna apo arkivi i komunës është i obliguar që ta bëjë zgjedhjen e lëndës arkivore dhe ndarjen e materialit të pavlerë të regjistraturës në prezencë të personit profesional dhe kompetent për këto çështje.



Neni 13
Arkivi komunal

Detyrat dhe përgjegjësitë e fond-krijuesit (arkivi i komunës)

1. Çdo fond-krijues është i obliguar ta ketë njësinë përgjegjëse për Arkivin që njihet si arkivi i fond-krijuesit, i cili funksionon në kuadër të rrjetit arkivor të ASHAK-ut (Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës).
2. Fond-krijuesi obligohet që materialin të cilin e posedon dhe e krijon t'a mirëmbajë sipas kriterëve të parapara në bazë të Ligjit nr. 08/1-111 për Arkivat dhe akteve tjera juridike, deri në dorëzimin në Arkivin kompetent, për ruajtje të përhershme.
3. Fond-krijuesi — Arkivi komunal, është i obliguar të përzgjedhë materialin me vlerë të përhershme dhe të bëjë asgjësimin e materialit të pavlefshëm, (me komision prej tre antarëve) për asgjësimin e materialit, por me miratimin e ASHAK.
4. Fond-krijuesi — Arkivi komunal, materialin arkivor duhet ta dorëzojë në Arkivin kompetent brenda afatit ligjor të përcaktuar me ligj.
5. Fond-krijuesi - Arkivi komunal, e informon agjencinë për regjistrin e materialit arkivor, ruajtjen dhe çdo ndryshim tjetër në lidhje me materialin arkivor në tërësi.
6. Mbikëqyrjen dhe inspektimin e materialit arkivor, është përgjegjës ASHAK-u, përveç rasteve kur përcaktohen ndryshe me ligj.
7. Administrimi dhe mbrojtja e materialit arkivor duhet të ruhet si tërësi dhe nuk mund të tjetërsohet, dëmtohet apo asgjësohet.
8. Shfrytëzimi i materialit arkivor ruhet dhe shfrytëzohet për nevoja arsimore, shkencore, kulturore, hulumtuese, informative, për punë profesionale dhe nevojave të qytetarëve.
9. Afatet kohore për shfrytëzimin e materialit arkivor janë të përcaktuara në bazë të ligjit dhe akteve tjera nënligjore.
10. Lëvizja dhe transporti i materialeve arkivore mund të bëhet duke u bazuar në ligjin për arkivin dhe lëndët arkivore.
11. Arkivi komunal bën pranimin, evidentimin, ruajtjen e materialit arkivor nga shërbimi i arkivit të administratës.
12. Materiali i pranuar arkivor regjistrohët në Librin e Arkivit komunal, sipas shenjave të klasifikimit.
13. Arkivi komunal mundëson shfrytëzimin e materialit arkivor për hulumtime shkencore, për punë profesionale si dhe nevoja tjera të cilat janë në interes të institucionit.
14. Arkivi komunal ushtron veprimtarinë e vet në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi dhe aktet e tjera të mbështetura në të si dhe standardet arkivore ndërkombëtare.



Neni 14
Dispozitat përfundimtare

1. Struktura organizative në Komunë, është e obliguar që me kujdes të veçantë ta ruajnë lëndën arkivore dhe materialin e regjistratorit, në përputhje me dispozitat e këtij akti dhe të Ligjit Nr. 08/1—111 për Arkivat.
2. Nëse nëpunësi civil, i cili është i ngarkuar për mbajtjen e arkivit dhe lëndën arkivore të komunës, në rastet kur shëput marrëdhënien e punës me komunën, dorëzim-pranimi i arkivit dhe lëndës arkivore bëhet me procesverbal nga komisioni të cilin e formon Kryetari i Komunës.

A r s y e t i m

Hartimi i Rregullores për Menaxhimin e Dokumenteve Zyrtare dhe Arkivore është bërë në zbatim të ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të Statutit të Komunës së Glllogocit, si dhe në përputhje me Ligji Nr. 08/L-111 për Arkivat Shtetërore dhe Rregullorja (MPB) Nr. 05/2020 për shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është krijimi i një sistemi të unifikuar, të standardizuar dhe të kontrollueshëm për administrimin, evidentimin, klasifikimin, ruajtjen, arkivimin dhe asgjësimin e dokumenteve zyrtare dhe arkivore në Komunë.

Përmes kësaj rregulloreje sigurohet bëhet, rritja e efikasitetit dhe transparencës në administratën komunale, sigurimi i gjurmueshmërisë së çdo dokumenti zyrtar, mbrojtja e dokumenteve me vlerë të përherëshme arkivore, parandalimi i humbjes, dëmtimit apo keqpërdorimit të dokumenteve, harmonizimi i praktikave komunale me legjislacionin në fuqi.

Nevoja për rregullim të brendshëm duke marrë parasysh rritjen e volumit të dokumentacionit, përdorimin e sistemeve elektronike, si dhe detyrimet ligjore për ruajtjen dhe administrimin e materialit arkivor, është e domosdoshme që Komuna të ketë një akt të brendshëm normativ që të përcakton qartë përgjegjësitë e njësive organizative, rregullon mënyrën e protokollimit dhe evidentimit të shkresave hyrëse dhe dalëse, përcakton procedurat e arkivimit dhe afatet e ruajtjes, rregullon procesin e përzgjedhjes dhe asgjësimit të materialit të pavlerë, siguron mbrojtjen e dokumenteve konfidenciale dhe sekrete.

Rregullorja është në përputhje të plotë me parimet e vetëqeverisjes lokale, legjislacionin për arkivat shtetërore, aktet nënligjore për klasifikimin dhe afatet e ruajtjes së dokumenteve, standardet e menaxhimit modern të dokumenteve dhe arkivave.

Ajo nuk bie ndesh me asnjë dispozitë ligjore në fuqi dhe shërben si akt zbatues për nivelin lokal.



Zbatimi i kësaj rregulloreje nuk krijon obligime shtesë të konsiderueshme buxhetore, pasi menaxhimi i dokumenteve realizohet brenda strukturave ekzistuese organizative. Eventualisht, mund të kërkojnë përmirësime teknike në sistemin elektronik dhe pajisje për ruajtje arkivore, të cilat planifikohen në kuadër të buxhetit të rregullt komunal.

Miratimi i kësaj rregulloreje do të forcojë disiplinën administrative, rrisë sigurinë juridike të akteve komunale, përmirësojë shërbimet ndaj qytetarëve, sigurojë ruajtjen afatgjatë të trashëgimisë dokumentare të komunës, mundësojë inspektim dhe mbikëqyrje më efikase nga organet kompetente.

Duke marrë parasysh rëndësinë e administrimit të rregullt dhe ligjor të dokumenteve zyrtare dhe arkivore, si dhe domosdoshmërinë për harmonizim me legjislacionin në fuqi, propozohet që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë dhe ta miratojë Rregulloren për Menaxhimin e Dokumenteve Zyrtare dhe Arkivore.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky propozim për Rregulloren për menaxhimin e dokumenteve zyrtare dhe arkivore hynë në fuqi pasi të procedohet, të miratohet nga Kuvendi i Komunës dhe MAPL.

Drenas,
Mars 2026

Kryetar i Komunës
Ramiz Lladrovci





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Glllogoc)
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 400/01-9166, dt. 10/03/2026

Në bazë të nenit 58, pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenit 72, pika h, të Statutit të Komunës së Glllogocit, të datës 16.09.2008, në përputhje me nenin 5.2, të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, si dhe në zbatim të pikës 3 të Vendimit të Qeverisë për themelimin e ndërmarrjes publike NPL "EKO Drenasi", me nr. 10/02, të datës 20.02.2026, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

PROPOZIM – VENDIM

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL "EKO – Drenasi" Sh. A - Glllogoc

- I. Me këtë propozim-vendim formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "EKO Drenasi" Sh. A në Drenas, në përbërje:
- I.I Kuvendi i Komunës dy anëtarë: 1. _____
2. _____
- I.II Ekzekutivi i Komunës një anëtar: 1. _____
- II. Komisioni Komunal i Aksionarëve nga pika I e këtij vendimi obligohet të ushtroj të drejtat e aksionarit në përputhje me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrje publike, Ligjin nr. 04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrje publike, Ligjin nr. 03/L-87 dhe Ligjin nr. 06/L-16 për shoqëritë tregtare.
- III. Mandati i anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL-së përfundon me përfundimin e mandatit aktual të anëtarëve të Kuvendit të Komunës apo me ndonjë vendim tjetër të Kuvendit të Komunës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPI.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		18/03/2026	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	020/04	10090	



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government



Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën paragrafi h të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1, 12.2 pika d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, Kuvendit të Komunës së Drenasit në mbledhjen e ardhshme të aprovoi këtë:

PROPOZIM - VENDIM

Për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike

Neni 1

Me këtë propozim vendim Kryetari i Komunës duke u bazuar në legjisllacionin në fuqi i propozon Kuvendit të Komunës themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike në përbërje prej 9 anëtarësh të subjekteve të përfaqësuara në kuvendin e komunës së Drenasit, duke përfshirë kryesuesin:

1. _____-Kryesues;
2. _____-Anëtarë;
3. _____-Anëtarë;
4. _____-Anëtarë;
5. _____-Anëtarë;
6. _____-Anëtarë;
7. _____-Anëtarë;
8. _____-Anëtarë;
9. _____-Anëtarë;

Neni 2

Detyrë e këtij komisioni është të shqyrtojë listën e veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe njëherësh duke paraqitur arsyet dhe interesin publik të rekomandojë kryetarit të komunës në lidhje me pronat për të cilat sipas tyre mendohet se mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurave të ankandit publik, shpalljes publike apo negociatave të kryetarit të Komunës.

Neni 3

Përbërja e këtij komisioni përfshinë anëtarë nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në kuvend dhe i njëjti pas shqyrtimit të listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale harton raportin me rekomandimet e veta dhe të njëjtin i dorëzon zyrës së Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Në përputhje me Ligjin Nr.08/L-0284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr.03/2026 për procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave vendimi në fjalë nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

Neni 5

Mandati i komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave duhet të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike është katër (4) vjeçar ashtu sikurse anëtarët e Kuvendit si dhe përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi janë përgjegjëse Kuvendi Komunal, Zyra e Kryetarit dhe Drejtoritë përkatëse.

Neni 7

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Komuna e Drenasit në harmoni me legjislacionin në fuqi i cili e rregullon këtë fushë ka autorizime ndër të tjera edhe dhënien e pronës komunale në shfrytëzim ku si rrjedhojë e të cilit proces dhe me qëllim që procesi të shkojë sa më mirë dhe me rritje të transparencës dhe llogaridhënies në vendimmarrje konsideron të nevojshme edhe themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike. Andaj, duke marrë parasysh këtë, Kryetari i Komunës përmes këtij propozim-vendimi i propozon Kuvendit të Komunës që të themelojë komisioni në fjalë që për qëllim ka adresimin dhe zgjedhjen e problemeve të kësaj natyre në nivel lokal dhe fton që të votohet ky propozim vendim.